



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti, gjykatës raportues

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 6 prill 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Korrigjuar i Versionit Publik të Redaktuar të Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafësme 4 Shtojca Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*

T'u njoftohet:

Mbrojtëses së Viktimave

Ani Pues

Mbrojtjes së Salih Mustafës

Julius von Bone

Kryetares

Ekaterina Trendafilova

Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar

Aleks Uajting

Administratores

Fidelma Donlon

Qeverisë së Kosovës

Kryeministrit

Ministres së Drejtësisë

Përmbajtja

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	3
II.	KUADRI I ÇËSHTJES GJYQËSORE.....	19
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE DHE PARIMET PËR ZHDËMTIMET	21
A.	Tekstet dhe instrumentet ligjore përkatëse	21
B.	Parimet për zhdëmtimet: pasqyrë e përgjithshme	24
C.	Përfituesit e zhdëmtimeve	28
D.	Dëmi	31
1.	Koncepti dhe llojet e dëmit	31
2.	Shkakësia.....	33
3.	Detyrimi dhe standardi i vërtetimit.....	35
E.	Llojet dhe modalitetet e zhdëmtimeve	37
F.	Përgjegjësia për zhdëmtim e personit të shpallur fajtor.....	40
IV.	PROVAT PARA TRUPIT GJYKUES DHE METODOLOGJIA E TRUPIT GJYKUES PËR VLERËSIMIN E KËRKESËS PËR ZHDËMTIME.....	41
V.	SHKALLA DHE MASA E DËMIT	44
A.	Parashtrimet	44
B.	Identiteti si person fizik	45
C.	Dëmi i pësuar nga viktimat.....	46
1.	Dëmi i pësuar nga viktimat e drejtpërdrejta.....	46
2.	Dëmi i pësuar nga viktimat e tërthorta	60
VI.	URDHËR PËR ZHDËMTIM KUNDËR Z. MUSTAFA.....	65
A.	Përfituesit e zhdëmtimeve dhe dëmi i pësuar	65
B.	Llojet dhe modalitetet e zhdëmtimeve	66
1.	Parashtrimet.....	66
2.	Vendimi i Trupit Gjykes	67
C.	Shkalla e përgjegjesisë së z. Mustafa për zhdëmtimet.....	69
1.	Parashtrimet.....	69
2.	Vendimi i Trupit Gjykes	71
VII.	VËNIA NË JETË DHE ZBATIMI I URDHRIT PËR ZHDËMTIM.....	89
A.	Monitorimi dhe mbikëqyrja	89
B.	Financimi	91
1.	Nga personi i shpallur fajtor.....	91

2.	Nga Kosova.....	93
3.	Nga fondi i ri për viktimat që do të krijohet me nismën e DHSK-së	102
VIII.	VENDIM	103

TRUPI GJYKUES I ("Trupi Gjykues") lëshon këtë Urdhër për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës ("z. Mustafa").

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") parashtroi aktakuzën kundër z. Mustafa konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ("Aktakuza e Konfirmuar").¹
2. Më 7 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjykues.²
3. Më 20 maj 2021, Trupi Gjykues nxori Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve) ("Vendimi i Caktimit të Ekspertëve"), me të cilin urdhëroi Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave ("ZPV") që deri më 4 qershor 2021 të dorëzonte një listë me tre ekspertë që do të ishin në dispozicion brenda një kohe të shkurtër për përpilimin e aktekspertizave për të sqaruar nëse gjykatat e Kosovës ofronin mundësi reale që viktimat e krimeve në këtë çështje gjyqësore të kërkonin zhdëmtim dhe, në rast se zhdëmtimet do të miratoheshin me aktvendime të këtyre gjykatave, a do të

¹ KSC-BC-2020-05, F00011/A01, Prokurori i Specializuar *Aktakuzë*, 19 qershor 2020, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 28 shtator 2020, [F00019/A01](#); F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës* ("Vendimi i Konfirmimit"), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u dorëzuan më 5 tetor 2020, përkatësisht F00008/CONF/RED dhe [F00008/RED](#).

² KSC-BC-2020-05, F00119, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kalimin e Dosjes Gjyqësore Trupit Gjykues I*, 7 maj 2021, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

zbatoheshin këto aktvendime.³ Trupi Gjykues gjithashtu urdhëroi Mbrojtjen e z. Mustafa ("Mbrojtja") dhe Mbrojtësen e Viktimave të dorëzonin parashtrime, nëse kishin, brenda dhjetë ditësh nga njoftimi i parashtrimit të ZPV-së.⁴

4. Më 4 qershor 2021, Administratorja dorëzoi Parashtrimin e Zyrës Administrative në Përputhje me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve), në të cilin ZPV-ja identifikoi tre ekspertë të cilët "i plotësojnë mjaftueshëm kushtet" e përcaktuara në Vendimin e Caktimit të Ekspertëve.⁵

5. Më 14 qershor 2021, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve), ku përfshiu disa pyetje që duhej të trajtoheshin nga eksperti (ekspertët) e caktuar.⁶ Mbrojtja nuk dorëzoi asnjë parashtrim.

6. Më 25 qershor 2021, Trupi Gjykues lëshoi Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve), me të cilin urdhëroi ZPV-në që deri më 21 korrik 2021 të dorëzonte një listë me ekspertë shtesë nga jashtë Kosovës që do të ishin në dispozicion brenda një kohe të shkurtër për përpilimin e aktekspertizës së përmendur në

³ KSC-BC-2020-05, F00124, Trupi Gjykues I, [Decision on the appointment of expert\(s\)](#) (Vendim mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)) 20 maj 2021, publik, para. 20, 22 dhe 24(a). Parashtrimi i protokolluar u njoftua më 21 maj 2021.

⁴ [Appointment of Experts Decision](#) (Vendimi i Caktimit të Ekspertëve), para. 24(b).

⁵ KSC-BC-2020-05, F00132, Administratorja, *Parashtrim i Zyrës Administrative në përputhje me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 4 qershor 2021, publik, me Shtojcat 1-3, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00134, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel Submission on the Decision on the appointment of expert\(s\)](#) (Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)), 14 qershor 2021, publik.

Vendimin e Caktimit të Ekspertëve.⁷ Trupi Gjykses gjithashtu urdhëroi Mbrojtjen dhe Mbrojtësen e Viktimave të dorëzonin parashtrime, nëse kishin, në lidhje me parashtrimet e ZPV-së deri më 20 gusht 2021.⁸

7. Më 12 korrik 2021, Trupi Gjykses nxori Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit.⁹

8. Më 21 korrik 2021, Administratorja dorëzoi Parashtrimin e Zyrës Administrative në Përputhje me Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve), në të cilin ZPV-ja identifikoi tre ekspertë shtesë për shqyrtim nga Trupi Gjykses.¹⁰

9. Më 19 gusht 2021, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve),¹¹ duke përfshirë një listë me pyetje për shqyrtim nga eksperti (ekspertët).¹² Mbrojtja nuk dorëzoi asnjë parashtrim.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00140, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)* ("Vendimi i Dytë i Caktimit të Ekspertëve"), 25 qershor 2021, publik, para. 9-10, 12(a). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00140/RED](#).

⁸ [Second Appointment of Experts Decision](#) (Vendimi i Dytë i Caktimit të Ekspertëve), para. 12(b).

⁹ KSC-BC-2020-05, F00152, Trupi Gjykses I, [Decision on victims' procedural rights during trial](#) (Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit) ("Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave"), 12 korrik 2021, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-05, F00157, Administratorja, *Parashtrim i Zyrës Administrative në Përputhje me Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 21 korrik 2021, konfidencial, me Shtojcat 1-4, konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i dosjes bazë u dorëzua më 10 shtator 2021, [F00157/RED](#).

¹¹ KSC-BC-2020-05, F00166, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel Submission on the Second Decision on the appointment of expert\(s\)](#) (Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)) ("Parashtrimi i Dytë i Viktimave"), 19 gusht 2021, publik, me Shtojcën 1, publike ([Annex 1](#)).

¹² Shtojca 1 ([Annex 1](#)) e Parashtrimit të Dytë të Viktimave.

10. Më 3 shtator 2021, Trupi Gjykses nxori Vendimin e Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve (“Vendimi i Tretë i Caktimit të Ekspertëve”), me të cilin caktoi tre persona si ekspertë në çështjen aktuale dhe i udhëzoi ata që “të përpiqen të dorëzojnë aktekspertizë të përbashkët” për tema të caktuara të identifikuara nga Trupi Gjykses deri më 22 nëntor 2021.¹³

11. Më 15 shtator 2021, filloi gjykimi me deklaratat hyrëse të ZPS-së dhe Mbrojtëses së Viktimave.¹⁴

12. Nëntë (9) viktima u pranuan të merrnin pjesë në proces. Pesë (5) viktima u pranuan nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 30 prill 2020 dhe katër (4) viktima nga Trupi Gjykses më 21 maj 2021.¹⁵ Pas kësaj, Trupi Gjykses [REDAKTUAR] vendosi përfundimin e statusit të tij si viktimë pjesëmarrëse në proces.¹⁶

13. Më 15 shtator 2021, ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave bënë deklaratat hyrëse.¹⁷ Në deklaratën e saj hyrëse, Mbrojtësja e Viktimave, midis të tjerash, i kërkoi Trupit

¹³ KSC-BC-2020-05, F00184, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Tretë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 3 shtator 2021, publik. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00184/RED](#).

¹⁴ KSC-BC-2020-05, F00138, Trupi Gjykses I, *Decision setting the date for the commencement of the trial and related matter* (Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjykimit dhe Pika të Tjera që lidhen me Të) 18 qershor 2021, publik; [T. 15 September 2021](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2021), publik.

¹⁵ KSC-BC-2020-05, F00105, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (“Vendimi i Dytë i Pjesëmarrjes së Viktimave”), 30 prill 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00105/RED](#). F00126, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (“Vendimi i Tretë i Pjesëmarrjes së Viktimave”), 21 maj 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00126/RED](#).

¹⁶ [REDAKTUAR].

¹⁷ [T. 15 September 2021](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2021), publik.

Gjykues që të mos i referonte viktimat e përfaqësuara prej saj për padi civile në gjykatat e Kosovës.¹⁸

14. Nga 20 shtatori 2021 deri më 4 shkurt 2022, ZPS-ja paraqiti provat e veta.¹⁹

15. Më 20 shtator 2021, Trupi Gjykues refuzoi kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për rishikim²⁰ të Vendimit të Tretë të Caktimit të Ekspertëve.²¹

16. Më 18 tetor 2021, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet, ku përsëriti kërkesën e saj që Trupi Gjykues të mos i referonte viktimat për padi civile në gjykatat e Kosovës, por të përfshinte në Aktgjykim vendimin për dëme, humbje dhe lëndime.²²

¹⁸ [T. 15 September 2021](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2021), publik, f. 345, rreshti 5 deri f. 373, rreshti 19.

¹⁹ [T. 20 September 2021](#) (Transkripti i 20 shtatorit 2021), publik; KSC-BC-2020-05, F00308, Prokurori i Specializuar [Prosecution Notice of the Closing of its Case pursuant to Rule 129](#) (Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 129 për Mbylljen e Paraqitjes së Provave të Saj) 4 shkurt 2022, publik.

²⁰ KSC-BC-2020-05, F00190, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel motion for reconsideration of the Third decision on the appointment of expert\(s\)](#) (Mocion i Mbrojtëses së Viktimave për Rishqyrtimin e Vendimit të Tretë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)) ("Kërkesa për Rishqyrtim"), 7 shtator 2021, publik. Mbrojtja nuk iu përgjigj Kërkesës për Rishqyrtim.

²¹ KSC-BC-2020-05, F00209, Trupi Gjykues I, [Decision on Victims' Counsel request for reconsideration of the third decision on the appointment of expert\(s\)](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Rishqyrtimin e Vendimit të Tretë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)) 20 shtator 2021, publik.

²² KSC-BC-2020-05, F00239, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel Submission on Reparations](#) (Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet) ("Parashtrimet e Para të Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet"), 18 tetor 2021, publik.

17. Më 17 dhjetor 2021, pas zgjatjes së afatit,²³ Administratorja ia kaloi²⁴ Trupit Gjykses aktekspertizat e Ekspertëve të Caktuar (përkatësisht, “Aktekspertiza e Parë”,²⁵ “Aktekspertiza e Dytë”,²⁶ dhe “Aktekspertiza e Tretë”,²⁷ bashkërisht “Aktekspertizat”).

18. Më 20 janar 2022, me kërkesë të Mbrojtëses së Viktimave,²⁸ Trupi Gjykses e zgjati afatin për parashtrime nga Mbrojtja dhe Mbrojtësja e Viktimave në lidhje me Aktekspertizat deri më 25 janar 2022.²⁹

19. Më 21 janar 2022, Trupi Gjykses nxori Vendimin e Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit, ku ndër të tjera urdhëroi Mbrojtësen e Viktimave që deri më 11 shkurt 2022 të dorëzonte një listë me dëshmitarë (ekspertë) të propozuar për t’u thirrur nga Trupi

²³ KSC-BC-2020-05, F00260, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesat për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Aktekspertizës (Aktekspertizave) dhe Parashtrime në lidhje me To*, 19 nëntor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00260/RED](#); F00252, Zyra Administrative, *Kërkesë për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Aktekspertizës (Aktekspertizave)*, 15 nëntor 2021, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 17 nëntor 2021, [F00252/RED](#); F00259, Mbrojtësja e Viktimave, *Victims’ Counsel response to Request for Extension of Time Limit to Submit Expert Report(s) dated 15 November 2021 (F00252)* (Përgjigje e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Kërkesës për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Aktekspertizës (Aktekspertizave) të datës 15 nëntor 2021 (F00252)), 18 nëntor 2021, publike.

²⁴ KSC-BC-2020-05, F00287, Administratorja, *Transmission of Expert Reports with four confidential and two public Annexes*, (Dërgimi i Aktekspertizave me Katër Shtojca Konfidenciale dhe dy Shtojca Publike) 17 dhjetor 2021, publik, me Shtojcat 1, 3, 5-6, konfidenciale. Versionet e redaktuara publike të Shtojcave 1 (shih [Annex 2](#)) (Shtojca 2)) dhe 3 (shih [Annex 4](#)) (Shtojca 4)) u dorëzuan më të njëjtën ditë. Versioni i redaktuar publik i Shtojcës 6 ([Annex 6](#)) u dorëzua më 14 janar 2022.

²⁵ [REDAKTUAR].

²⁶ [REDAKTUAR].

²⁷ [REDAKTUAR].

²⁸ KSC-BC-2020-05, F00291, Mbrojtësja e Viktimave, *Victims’ Counsel motion for extension of time limit to file her submissions on the experts reports* (Mocion i Mbrojtëses së Viktimave për Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Parashtrimeve të Saj në lidhje me Aktekspertizat), 20 janar 2022, publik.

²⁹ KSC-BC-2020-05, F00292, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionin për Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Parashtrimeve në lidhje me Aktekspertizat*, 20 janar 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00292/RED](#).

Gjykues, si dhe materialin jogojor përkatës për të cilin kërkonte që Trupi Gjykues të jepte urdhër të dorëzohej për përcaktimin e së vërtetës.³⁰

20. Më 24 janar 2022, Mbrojtësja e Viktimave, midis të tjerash, i kërkoi Trupit Gjykues që të caktonte një ekspert për të bërë vlerësimin mjekësor të dëmeve fizike dhe psikologjike të pësura nga tri viktimat të drejtpërdrejta në çështjen aktuale (“Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Caktimin e Ekspertit Mjekësor”).³¹

21. Gjithashtu më 24 janar 2022, Mbrojtësja e Viktimave³² dhe Mbrojtja³³ dorëzuan parashtrimet përkatëse në lidhje me Aktekspertizat.

22. Më 4 shkurt 2022, Trupi Gjykues lëshoi Vendimin mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në këtë Çështje dhe ku Kërkohej Informacion (“Vendimi sipas Nenit 22(9)”) në të cilin vendosi se, në rast të shpalljes fajtor, nuk do t’i referonte viktimat për padi civile në gjykatat e Kosovës në përputhje me nenin 22(9) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 167 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), por do të

³⁰ KSC-BC-2020-05, F00296, Trupi Gjykues I, [Second decision on the conduct of the proceedings](#) (Vendimi i Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit), 21 janar 2022, publik, para. 21(g).

³¹ KSC-BC-2020-05, F00297, Mbrojtësja e Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtëses së Viktimave në pajtim me Vendimin e Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit të datës 21 janar 2022*, 24 janar 2022, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00297/RED](#).

³² KSC-BC-2020-05, F00298, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtëses së Viktimave mbi Aktekspertizat në lidhje me Referimin e Proceseve për Zhdëmtim në Gjykatat Shtetërore në Kosovë*, 24 janar 2022, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00298/RED](#).

³³ KSC-BC-2020-05, F00299, Mbrojtja, [Defence submission regarding Reports of Appointed Experts](#) (Parashtrim i Mbrojtjes në lidhje me Aktekspertizat e Ekspertëve të Caktuar), 24 janar 2022, publik.

lëshonte Urdhër për Zhdëmtim në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.³⁴ Trupi Gjykses gjithashtu i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës që deri të mërkurën, 16 mars 2022, të jepte informacion në lidhje me mundësinë që viktimat e krimeve nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHSK”) të paraqisnin kërkesë për kompensim përmes mekanizmave zhdëmtues ekzistues ose që do të krijoheshin në Kosovë, në rast të shpalljes fajtor të z. Mustafa dhe të lëshimit të Urdhrit për Zhdëmtim nga Trupi Gjykses, dhe në rast se z. Mustafa nuk do të ishte në gjendje të paguante zhdëmtimin që do të urdhëronte Trupi Gjykses.³⁵

23. Më 1 mars 2022, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi parashtrime në pajtim me Vendimin e Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit.³⁶

³⁴ KSC-BC-2020-05, F00310, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në këtë Çështje dhe ku Kërkohet Informacion*, 4 shkurt 2022, konfidencial, para. 50(b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00310/RED](#).

³⁵ [Article 22\(9\) Decision](#) (Vendimi sipas Nenit 22(9)) para. 47, 50(f).

³⁶ KSC-BC-2020-05, F00334, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel submissions pursuant to the Third decision on the conduct of the proceedings](#) (Parashtrime të Mbrojtëses së Viktimave në pajtim me Vendimin e Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit) 1 mars 2022, publike (riklasifikuar si publike në përputhje me CRSPD96 të datës 3 shkurt 2023), me Shtojcat 1 dhe 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Më 18 mars 2022, në bazë të Urdhrit Gojor të 9 Marsit 2022, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi versionin e redaktuar rreptësisht konfidencial të Shtojcës 1 të Parashtrimeve të Mbrojtëses së Viktimave në pajtim me Vendimin e Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit ([Victims' Counsel submissions pursuant to the Third decision on the conduct of the proceedings](#)) (shih F00349, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel's Submission of a strictly confidential, redacted version of Annex 1 to Filing 334 \(F334_01\) pursuant to the Trial Panel's Oral Order of 9 March 2022](#) (Parashtrim prej Mbrojtëses së Viktimave i Versionit të Redaktuar Rreptësisht Konfidencial të Shtojcës 1 të Parashtrimit të Protokolluar 334 (F334_01) në përputhje me Urdhrin Gojor të Trupit Gjykses të 9 Marsit 2022), 18 mars 2022 (riklasifikuar si publik në përputhje me CRSPD96 të datës 3 shkurt 2023), publik, me Shtojcën 1 (Shtojca 1 e Parashtrimit të Mbrojtëses së Viktimave të 18 marsit 2022), rreptësisht konfidenciale).

24. Më 8 dhe 9 mars 2022, u mbajt konferenca përgatitore e Mbrojtjes dhe konferenca për ecurinë e çështjes për viktimat.³⁷

25. Më 9 mars 2022, pas Kërkesës së Mbrojtëses së Viktimave për Caktimin e Ekspertit Mjekësor, Trupi Gjykes caktoi, me urdhër gojor, ekspertin mjekësor për të ekzaminuar V08/05-ën, V09/05-ën, dhe V10/05-ën (“Urdhri Gojor i 9 Marsit 2022”).³⁸

26. Më 14 mars 2022, në pajtim me Vendimin sipas Nenit 22(9), Ministria e Drejtësisë e Kosovës dorëzoi parashtrime në lidhje me mekanizmat ekzistues ose që do të krijohen, për zhdëmtim, në Kosovë.³⁹

27. Më 21 mars 2022, Mbrojtësja e Viktimave paraqiti provat e veta.⁴⁰

28. Më të njëjtën ditë, me urdhër gojor, Trupi Gjykes miratoi kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për rishikim të Urdhrit Gojor të 9 Marsit 2022,⁴¹ dhe caktoi Institutin për Të Drejtat e Njeriut dhe Vlerësim Mjekësor (Instituut voor Mensenrechten en Medisch Onderzoek - iMMO), për të bërë vlerësimin e dëmit fizik dhe psikologjik dhe lëndimeve të pësura nga V08/05, V09/05, dhe V10/05 si rezultat i torturës, trajtimit mizor dhe ndalimit arbitrar që pretendohet se pësuan dhe për të përgatitur një

³⁷ KSC-BC-2020-05, F00318, Trupi Gjykes I, [Third decision on the conduct of the proceedings, 9 shkurt 2022](#) (Vendimi i Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit), publik, para. 14, 16(c); [T. 8 March 2022](#) (Transkripti i 8 marsit 2022), publik; [T. 9 March 2022](#) (Transkripti i 9 marsit 2022), publik.

³⁸ [T. 9 March 2022](#) (Transkripti i 9 marsit 2022), publik, f. 2520, rreshti 21 deri f. 2521, rreshti 1.

³⁹ KSC-BC-2020-05, F00344, Ministria e Drejtësisë e Kosovës, [Response to your document KSC-BC-2020-05](#) (Përgjigje në lidhje me Shkresën KSC-BC-2020-05) (“Përgjigja e Parë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës”), 14 mars 2022, publik.

⁴⁰ [T. 21 March 2022](#) (Transkripti i 21 marsit 2022), publik.

⁴¹ KSC-BC-2020-05, F00346, Mbrojtësja e Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtëses së Viktimave për Sqarim dhe Rishqyrtim në Lidhje me Urdhrin Gojor të 9 Marsit 2022 për Caktimin e Ekspertit për të Ekzaminuar Viktimat 08/05, 09/05 dhe 10/05 dhe Parashtrime*, 18 mars 2022, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 27 janar 2023, [F00346/RED](#).

aktekspertizë mjekësore mbi atë bazë deri më 13 maj 2022 (“Urdhri Gojor i 21 Marsit 2022”).⁴²

29. Nga 22 marsi deri më 26 maj 2022, Mbrojtja paraqiti provat e veta.⁴³

30. Më 23 mars 2022, Trupi Gjykues i kërkoi, me urdhër gojor, Mbrojtëses së Viktimave që deri më 22 prill 2022 të propozonte një apo më shumë ekspertë që ta ndihmonin në vlerësimin e dëmshpërblimit financiar për dëmet materiale që pretendohet se kanë pësuar viktimat e drejtpërdrejta.⁴⁴

31. Më 25 mars 2022, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës lidhur me Kompensim dhe Kërkesë për Qartësim të Mëtejshëm.⁴⁵

32. Më 31 mars 2022, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Raportin e Mbrojtëses së Viktimave në Pajtim me Urdhrin Gojor të 21 Marsit 2022, në të cilin informoi Trupin Gjykues, midis të tjerash, se immo-ja kishte caktuar ekzaminimin e V08/05-ës dhe V09/05-ës për në prill 2022 dhe se ekzaminimi i V10/05-ës nuk ishte i mundshëm të kryhej për shkak të shëndetit të dobët fizik të tij.⁴⁶

⁴² [T. 21 March 2022](#) (Transkripti i 21 marsit 2022), publik, f. 2533, rreshti 12 deri f. 2534, rreshti 4.

⁴³ [T. 22 March 2022](#) (Transkripti i 22 marsit 2022), publik; KSC-BC-2020-05, F00421, Mbrojtësi i Specializuar, [Defence Rule 131 Notice to close the Defence case](#) (Njoftim i Mbrojtjes sipas Rregullës 131 për Mbylljen e Paraqitjes së Provave të Mbrojtjes), 26 maj 2022, publik.

⁴⁴ [T. 23 March 2022](#) (Transkripti i 23 marsit 2022), publik, f. 2601, rreshti 20 deri f. 2602, rreshti 7.

⁴⁵ KSC-BC-2020-05, F00365, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel Submission pursuant to the Response of the Ministry of Justice of Kosovo on compensation and Request to seek further clarification](#) (Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave ndaj Përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës lidhur me Kompensimin dhe Kërkesë për Qartësim të Mëtejshëm), 25 mars 2022, publik.

⁴⁶ KSC-BC-2020-05, F00370, Mbrojtësja e Viktimave, *Raport i Mbrojtëses së Viktimave në pajtim me Urdhrin Gojor të 21 Marsit 2022* (“Raporti i Mbrojtëses së Viktimave i 31 Marsit 2022”), 31 mars 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 3, 6, 7-9.

33. Më 11 prill 2022, Trupi Gjykses i kërkoi, me urdhër gojor, Mbrojtëses së Viktimave të bënte të ditur se si parashihte të vepronte në qoftë se nuk do të ishte e mundshme që iMMO-ja t'i ekzaminonte të tre dëshmitarët në kohë për aktekspertizën që duhej dorëzuar më 13 maj 2022 ("Urdhri Gojor i 11 Prillit 2022").⁴⁷

34. Më 21 prill 2022, pas urdhrin të Trupit Gjykses,⁴⁸ Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave në Lidhje me Ekspertin për Llogaritjen e Dëmit Material.⁴⁹

35. Më 25 prill 2022, Trupi Gjykses lëshoi Urdhrin drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për Parashtrime të Mëtejshme në lidhje me mekanizmat zhdëmtues ekzistues, ose që do të krijohen në Kosovë.⁵⁰

36. Më 25 prill 2022, pas urdhrin të Trupit Gjykses,⁵¹ Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi jetëshkrimin e ekspertit të propozuar për llogaritjen e dëmit material.⁵²

⁴⁷ Transkripti i 11 prillit 2022, konfidencial, f. 3405, rreshtat 3-9.

⁴⁸ [T. 23 March 2022](#) (Transkripti i 23 marsit 2022), publik, f. 2601, rreshti 20 deri f. 2602, rreshti 7.

⁴⁹ KSC-BC-2020-05, F00392, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel Submission on an Expert for the Calculation of Material Damage](#) (Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave në Lidhje me Ekspertin për Llogaritjen e Dëmit Material) 21 prill 2022, publik.

⁵⁰ KSC-BC-2020-05, F00396, Trupi Gjykses I, [Order requesting the Ministry of Justice of Kosovo to provide further submissions](#) (Urdhër drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për Parashtrime të Mëtejshme) ("Urdhri i Mëtejshëm drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës"), 25 prill 2022, publik.

⁵¹ [T. 22 April 2022](#) (Transkripti i 22 prillit 2022), publik, f. 4010, rreshtat 11-16.

⁵² KSC-BC-2020, F00397, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel submission of the CV of the proposed expert, pursuant to the Trial Panel's Order of 22 April 2022](#) (Parashtrim prej Mbrojtëses së Viktimave i Jetëshkrimit të Ekspertit të Propozuar, në pajtim me Urdhrin e Trupit Gjykses të 22 Prillit 2022), 25 prill 2022, publik, me Shtojcën 1, publike ([Annex 1](#)).

37. Më 28 prill 2022, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Raportin e Dytë të Mbrojtëses së Viktimave në pajtim me Urdhrin Gojor të 21 Marsit 2022 dhe Përgjigjen ndaj Urdhrit Gojor të 11 Prillit 2022.⁵³

38. Më 6 maj 2022, Trupi Gjykses nxori Vendimin mbi Zgjatjen e Afatit për Parashtrimin e Aktekspertizave Mjekësore dhe për Parashtrime të Mëtejshme (“Vendimi i 6 Majit 2022”).⁵⁴

39. Më 12 maj 2022, Ministria e Drejtësisë e Kosovës dorëzoi parashtrime të mëtejshme në lidhje me mekanizmat zhdëmtues ekzistues, ose që do të krijohen, në Kosovë.⁵⁵

40. Më 23 maj 2022, në përputhje me Vendimin e 6 Majit 2022 dhe me urdhër të Trupit Gjykses,⁵⁶ Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Parashtrimet e Mëtejshme të Mbrojtëses së Viktimave në lidhje me Zhdëmtimet.⁵⁷

⁵³ KSC-BC-2020-05, F00398, Mbrojtësja e Viktimave, *Raporti i Dytë i Mbrojtëses së Viktimave në pajtim me Urdhrin Gojor të 21 Marsit 2022 dhe Përgjigje ndaj Urdhrit Gojor të 11 Prillit 2022* (“Raporti i Mbrojtëses së Viktimave i 28 Prillit 2022”), 28 prill 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 21 maj 2022, [F00398/RED](#).

⁵⁴ KSC-BC-2020-05, F00403, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Zgjatjen e Afatit për Parashtrimin e Aktekspertizave Mjekësore dhe për Parashtrime të Mëtejshme*, 6 maj 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00403/RED](#).

⁵⁵ KSC-BC-2020-05, F00407, Ministria e Drejtësisë e Kosovës, *Përgjigje në lidhje me Shkresën KSC-BC-2020-05*, 12 maj 2022, publik. Përkthimi në anglishte u dorëzua më 13 maj 2022, [F00407/eng](#) (“Përgjigja e Dytë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës”).

⁵⁶ [T. 22 April 2022](#) (Transkripti i 22 prillit 2022), publik, f. 4010, rreshtat 11-16.

⁵⁷ KSC-BC-2020-05, F00415, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrime të Mëtejshme të Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet* (“Parashtrimet e Dyta të Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet”), 23 maj 2022, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 27 janar 2023, [F00415/RED](#).

41. Më 24 maj 2022, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Parashtrimin prej Mbrojtëses së Viktimave të Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05⁵⁸ (“Aktekspertiza e iMMO-së për V08/05-ën”⁵⁹ dhe “Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën”, dhe së bashku, “Aktekspertizat e iMMO-së”).⁶⁰

42. Më 1 qershor 2022, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin për Caktimin e Ekspertit Financiar dhe Përcaktimin e Hapave Proceduralë të Mëtejshëm në lidhje me Procedurën e Zhdëmtimit (“Vendimi i Caktimit të Ekspertit Financiar”).⁶¹ Trupi Gjykses e urdhëroi Mbrojtësen e Viktimave: (i) të dorëzonte parashtrime për aktekspertizën që duhej të përgatitej nga eksperti financiar; dhe (ii) të formulonte kërkesat për zhdëmtim në emër të viktimave pjesëmarrëse, jo më vonë se shtatë ditë pas dorëzimit të aktekspertizës në fjalë.⁶² Trupi Gjykses gjithashtu ftoi Mbrojtjen që, nëse dëshironte, t’u përgjigjej parashtrimeve dhe kërkesave për zhdëmtim të viktimave brenda shtatë ditësh.⁶³

⁵⁸ KSC-BC-2020-05, F00417, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrim prej Mbrojtëses së Viktimave i Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05*, 24 maj 2022, publik, me dy shtojca, rreptësisht konfidenciale.

⁵⁹ F00417/A01, Mbrojtësja e Viktimave, Shtojca 1 e *Parashtrimit prej Mbrojtëses së Viktimave të Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05*, 24 maj 2022, rreptësisht konfidenciale (përmban aktekspertizën mjekësore në lidhje me V08/05).

⁶⁰ F00417/A02, Mbrojtësja e Viktimave, Shtojca 2 e *Parashtrimit prej Mbrojtëses së Viktimave të Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05*, 24 maj 2022, rreptësisht konfidenciale (përmban aktekspertizën mjekësore në lidhje me V09/05).

⁶¹ KSC-BC-2020-05, F00425, Trupi Gjykses I, [Decision appointing a financial expert and setting out further procedural steps with regard to reparation proceedings](#) (Vendim për Caktimin e Ekspertit Financiar dhe Përcaktimin e Hapave Proceduralë të Mëtejshëm në lidhje me Procedurën e Zhdëmtimit), 1 qershor 2022, publik.

⁶² [Decision appointing a financial expert](#) (Vendimi i Caktimit të Ekspertit Financiar), para. 11 dhe 13(e).

⁶³ [Decision appointing a financial expert](#) (Vendimi i Caktimit të Ekspertit Financiar), para. 11 dhe 13(f).

43. Më 20 qershor 2022, Trupi Gjykses mbylli procedurën e paraqitjes së provave në përputhje me rregullën 134(a) të Rregullores dhe urdhëroi palët dhe Mbrojtësen e Viktimave që të dorëzonin dosjet gjyqësore përfundimtare dhe deklaratën në lidhje me pasojat e krimeve mbi viktimat pjesëmarrëse deri më 21 korrik 2022.⁶⁴

44. Më 23 qershor 2022, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Parashtrimin prej Mbrojtëses së Viktimave të Raportit lidhur me Humbjet Ekonomike,⁶⁵ në pajtim me Vendimin e Caktimit të Ekspertit Financiar, i cili përmban aktekspertizën e përgatitur nga eksperti financiar i caktuar nga Trupi Gjykses për llogaritjen e dëmeve materiale dhe humbjeve ekonomike të pësuar nga viktimat 08/05, 09/05, dhe 10/05 (“Aktekspertiza Lerc”).⁶⁶

45. Më 30 qershor 2022, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Versionin e Korrigjuar të Kërkesës së Specifikuar dhe Përmbledhëse të Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim (“Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim”).⁶⁷

⁶⁴ KSC-BC-2020-05, F00439, Trupi Gjykses I, [Decision on the closing of the evidentiary proceedings and related matters](#) (Vendim për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe Çështje në lidhje me To (“Vendimi për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave”), 20 qershor 2022, publik, para. 25(a), (c).

⁶⁵ KSC-BC-2020-05, F00440, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims’ Counsel’s Submission of report pertaining to economic loss](#) (Parashtrim prej Mbrojtëses së Viktimave i Raportit lidhur me Humbjet Ekonomike), 23 qershor 2022, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁶⁶ KSC-BC-2020-05, F00440/A01, Shtojca 1 e *Parashtrimit prej Mbrojtëses së Viktimave të Raportit lidhur me Humbjet Ekonomike*, 23 qershor 2022, konfidenciale. Versioni publik u dorëzua më 30 janar 2023, [F00503/A01](#). Versioni publik me më pak redakte u dorëzua më 20 mars 2023, [F00513/A01](#).

⁶⁷ KSC-BC-2020-05, F00444, Mbrojtësja e Viktimave, *Kërkesë e Specifikuar dhe Përmbledhëse e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim*, 30 qershor 2022, rreptësisht konfidenciale. Versioni i korrigjuar konfidencial u dorëzua më 4 korrik 2022, F00444/COR. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 27 janar 2023, [F00444/COR/RED](#). Versioni publik me më pak redakte u dorëzua më 20 mars 2023, [F00444/COR/RED2](#).

46. Më 20 korrik 2022, Mbrojtësja e Viktimave parashtrori Deklaratën e Mbrojtëses së Viktimave në lidhje me Pasojat e Krimeve mbi Viktimat Pjesëmarrëse (“Deklarata e Pasojave”).⁶⁸

47. Më 21 korrik 2022, palët dorëzuan Dosjet Gjyqësore Përfundimtare.⁶⁹

48. Më 13 shtator 2022, Mbrojtësja e Viktimave parashtrori përgjigjet për pyetjet e Trupit Gjykues⁷⁰ në lidhje me përcaktimin e zhdëmtimeve.⁷¹

49. Më 13, 14 dhe 15 shtator 2022, u mbajt seanca e deklaratave përmbyllëse,⁷² pas së cilave Kryegjykatësja e mbylli çështjen më 15 shtator 2022.⁷³

⁶⁸ KSC-BC-2020-05, F00456, Mbrojtësja e Viktimave, *Deklaratë e Mbrojtëses së Viktimave në lidhje me Pasojat e Krimeve mbi Viktimat Pjesëmarrëse*, 20 korrik 2022, rreptësisht konfidenciale. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 26 janar 2023, F00456/COR. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 27 janar 2023, [F00456/COR/RED](#). Versioni publik me më pak redaktime u dorëzua më 20 mars 2023, [F00456/COR/RED2](#).

⁶⁹ KSC-BC-2020-05, F00457/COR, Mbrojtësi i Specializuar, *Version i Korrigjuar i Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Mbrojtjes*, 21 korrik 2022, publik, me Shtojcën 1, ([Annex 1](#)) publike (riklasifikuar si publike në përputhje me CRSPD96 të datës 3 shkurt 2023); F00459/COR, Prokurori i Specializuar *Version i Korrigjuar i Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Prokurorisë sipas Rregullës 134(b)*, 21 korrik 2022 (versioni i korrigjuar u dorëzua më 22 korrik 2022), publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike.

⁷⁰ KSC-BC-2020-05, F00468, Trupi Gjykues, *Vendim për Caktimin e Rendit të Ditës të Seancës mbi Deklaratat Përmbyllëse dhe Çështje në lidhje me To*, 31 gusht 2022, konfidencial, para. 15-20, 21(b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00468/RED](#) (“Rendi i Ditës i Seancave të Deklaratave Përmbyllëse”).

⁷¹ KSC-BC-2020-05, F00475, Mbrojtësja e Viktimave, *Përgjigje e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Vendimit të Datës 31 Gusht 2022* (“Informacioni i Mëtejshëm i Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet”), 13 shtator 2022, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 27 janar 2023, [F00475/RED](#). Versioni publik me më pak redaktime u dorëzua më 20 mars 2023, [F00475/RED2](#).

⁷² [T. 13 September 2022](#) (Transkripti i 13 shtatorit 2022), publik; [T. 14 September 2022](#) (Transkripti i 14 shtatorit 2022), publik; [T. 15 September 2022](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2022), publik. *Shih gjithashtu Vendimin e Procedurës së Paraqitjes së Provave* ([Evidentiary Proceedings Decision](#)) para. 22; [Closing Statements Hearings Agenda](#) (Rendi i Ditës i Seancave të Deklaratave Përmbyllëse), para. 7.

⁷³ [T. 15 September 2022](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2022), publik, f. 4859, rreshti 15.

50. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses shqiptoi në seancë të hapur aktgjykimin kundër z. Mustafa,⁷⁴ duke e shpallur fajtor për krime lufte dhe duke e dënuar me 26 vjet burgim (“Aktgjykimi”).⁷⁵ Trupi Gjykses bëri të ditur se më vonë do të lëshonte Urdhrin për Zhdëmtim në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit, dhe se kishte juridiksionin e nevojshëm për këtë qëllim.⁷⁶

51. Përkatësisht më 27 janar dhe 20 mars 2023, në përputhje me urdhrat e Trupit Gjykses,⁷⁷ Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi parashtrime në lidhje me: (i) riklasifikimin e disa parashtrimeve të protokolluara dhe/ose dorëzimin e versioneve të redaktuara publike të disa parashtrimeve të protokolluara;⁷⁸ dhe (ii) zbatimin e redaktimeve në disa parashtrime të protokolluara.⁷⁹

⁷⁴ [T. 16 December 2022](#) (Transkripti i 16 dhjetorit 2022), publik.

⁷⁵ KSC-BC-2020-05, F00494, Trupi Gjykses I, *Aktgjykim*, 16 dhjetor 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 19 janar 2023, [F00494/RED](#), dhe versioni i redaktuar publik, i korrigjuar, u dorëzua më 24 janar 2023, [F00494/RED/COR](#).

⁷⁶ [Trial Judgment](#) (Aktgjykimi), para. 762, 831.

⁷⁷ KSC-BC-2020-05, F00492, Trupi Gjykses I, [Order for submissions on the reclassification of filings and/or submission of public and/or confidential redacted versions of filings](#) (Urdhër për Parashtrime mbi Riklasifikimin e Parashtrimeve dhe/ose për Dorëzimin e Versioneve të Redaktuara Publike dhe/ose Konfidenciale të Parashtrimeve), 15 dhjetor 2022, publik; F00512, Trupi Gjykses I, [Order for submissions on the application of redactions in filings F00444/COR/RED, F00456/COR/RED, F00475/RED and F00503/A01](#) (Urdhër për Parashtrime mbi Zbatimin e Redaktimeve në Parashtrimet F00444/COR/RED, F00456/COR/RED, F00475/RED dhe F00503/A01), 14 mars 2023, publik.

⁷⁸ KSC-BC-2020-05, F00502, Mbrojtësja e Viktimave, [Victims' Counsel submissions on the reclassification of certain filings and/or submissions of public redacted versions of filings, pursuant to the Trial Panel's order dated 15 dhjetor 2022 \(F00492\)](#) (Parashtrime të Mbrojtëses së Viktimave mbi Riklasifikimin e disa Parashtrimeve dhe/ose Dorëzimin e Versioneve të Redaktuara Publike të Parashtrimeve, në Përputhje me Urdhrin e Trupit Gjykses të Datës 15 Dhjetor 2022 (F00492), 27 janar 2023, publike (riklasifikuar si publike në përputhje me CRSPD96 të datës 3 shkurt 2023).

⁷⁹ KSC-BC-2020-05, F00514, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtëses së Viktimave mbi Zbatimin e Redaktimeve në Parashtrimet F00444-CORRED, F00456-CORRED, F00475-RED dhe F00503-A01, në Përputhje me Urdhrin e Trupit Gjykses të Datës 14 Mars 2023 (F00512)*, 20 mars 2023, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00514/RED](#).

II. KUADRI I ÇËSHTJES GJYQËSORE

52. Trupi Gjykses kujton se, siç përcaktohet në Aktgjykim, krimet në këtë çështje gjyqësore u kryen afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, në kontekstin dhe në lidhje me konfliktin e armatosur jondërkombëtar midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në një të anë, të njohur në anglishte si *Kosovo Liberation Army* (KLA), dhe, në anën tjetër, forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si edhe grupe të tjera që luftonin në emër të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë, që ndodhi në periudhën 1998-1999.⁸⁰

53. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses konstatoi se, si komandant i njësitit gueril BIA ("BIA"), njësit në Zonën Operative të Llapit të UÇK-së, z. Mustafa, shtetas i Kosovës, i lindur më 1 janar 1972 në Prishtinë, Kosovë, luajti rol qendror në sistemin e ndalimeve të paligjshme dhe torturave në një kompleks në Zllash, Kosovë. Ky kompleks është quajtur kompleksi i ndalimit në Zllash dhe u përdor nga BIA si vend ndalimi dhe për marrje në pyetje.⁸¹

54. Z. Mustafa, së bashku me vartësit e tij në BIA, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët (forma bazë), u hoqën lirinë së paku gjashtë personave pa u dhënë garanci bazë dhe i mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi. Për më tepër, z. Mustafa, së bashku me vartësit e tij në BIA, i keqtrajtoi rregullisht psikologjikisht

⁸⁰ Aktgjykimi, para. 700 e në vijim.

⁸¹ Aktgjykimi, para. 22, 334-345, 378, 729-732, 742-757, 814, 821.

dhe fizikisht të ndaluarit. Z. Mustafa gjithashtu urdhëroi vartësit e tij në BIA të torturonin të ndaluarit dhe u refuzoi ndihmë mjekësore me gjithë keqtrajtimin dhe lëndimet që kishin pësuar. Z. Mustafa gjithashtu personalisht torturoi dy të ndaluar, duke u dhënë kështu shembull dhe nxitje vartësve të tij në BIA që të kryenin veprime të ngjashme kundër të ndaluarve të tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash.⁸²

55. Gjatë tërë kohës të mbajtjes në ndalim, të ndaluarit u morën në pyetje, u akuzuan si spiunë, tradhtarë, hajdutë dhe gënjeshtarë, ose se bashkëpunonin me serbët. Ata u frikësuan dhe u detyruan të shprehnin përkrahje për UÇK-në. Qëllimi i këtyre keqtrajtimitve brutale ishte që prej tyre të merrej informacion ose pranim, dhe/ose që të ndëshkoheshin, frikësoheshin, dhe të detyroheshin dhe/ose të diskriminoheshin për arsye politike.⁸³

56. Ndonëse të ndaluarit u liruan më në fund më 19 prill 1999, ose rreth asaj date, për shkak të afrimit të ofensivës serbe, z. Mustafa nuk i liroi e as nuk i evakuo i dy të ndaluar, konkretisht [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR] ose “viktima e vrasjes së paligjshme”) dhe [REDAKTUAR], mbetën të ndaluar ndërsa z. Mustafa dhe vartësit e tij në BIA u larguan nga kompleksi i ndalimit në Zllash.⁸⁴

57. Viktima e vrasjes së paligjshme u vra midis datës 19 prill 1999 ose rreth saj dhe fundit të prillit 1999, si rezultat i kombinimit të keqtrajtimin të rëndë të shkaktuar nga vartësit e z. Mustafa në BIA, të cilët e mbajtën të ndaluar për gati tri javë, duke i

⁸² Aktgjykimi, para. 495-588, 584-588, 652-653, 674-679, 729-732, 742-752.

⁸³ Aktgjykimi, para. 587, 684-685.

⁸⁴ Aktgjykimi, para. 750.

shkaktuar dëmtime të rënda fizike, refuzimit të ndihmës mjekësore nga ana e vartësve të z. Mustafa në BIA, dhe plagëve me armë zjarri të shkaktuara nga plumbat.⁸⁵

58. Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa drejtpërdrejt dhe personalisht keqtrajtoi dy të ndaluar. Sa u përket krimeve të tjera, z. Mustafa së bashku me vartësit e tij në BIA dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, kishin qëllimin e përbashkët t'i mbanin të ndaluar dhe keqtrajtonin të ndaluarit që u mbajtën nga BIA në kompleksin e ndalimit në Zllash, dhe të ndalonin, keqtrajtonin dhe në fund ta vrisnin viktimën e vrasjes së paligjshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e shpalli fajtor z. Mustafa për tri akuza për krime lufte, konkretisht ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme, dhe e dënoi me njëzet e gjashtë (26) vjet burgim, duke iu llogaritur koha e mbajtjes në paraburgim në objektin e paraburgimit të DHSK-së që nga data 24 shtator 2020.⁸⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE DHE PARIMET PËR ZHDËMTIMET

A. TEKSTET DHE INSTRUMENTET LIGJORE PËRKATËSE

59. Trupi Gjykses u referohet neneve 6(1) dhe 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("KEDNJ"),⁸⁷ neneve 2(3) dhe

⁸⁵ Aktgjykimi, para. 754.

⁸⁶ Aktgjykimi, para. 830-831.

⁸⁷ [European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms](#) (Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut), ndryshuar me Protokollet nr. 11, 14, dhe 15, plotësuar me Protokollet nr. 1, 4, 6, 7, 12, 13 dhe 16, 4 nëntor 1950, ETS 5.

14(1) të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (“MNDCP”),⁸⁸ nenit 14 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Poshtëruese (“KKT”),⁸⁹ neneve 22 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (përkatësisht “Kushtetuta” dhe “Kosova”), neneve 3, 22, 23, 34(1), 43, 44(6) dhe 53 të Ligjit dhe rregullave 80, 159(5) dhe 168 të Rregullores.

60. Trupi Gjykses thekson në veçanti se në fjalinë e parë të nenit 22(3) të Ligjit, përcaktohet se “interesi personal i viktimës dhe të drejtat e viktimës në procedurën penale para Dhomave të Specializuara janë njoftimi, pranimi dhe *zhdëmtimi*” [theksimi i shtuar].

61. Në përputhje me nenin 22(8) të Ligjit, “kur trupi gjykses ose paneli i Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara e gjykon të akuzuarin si fajtor për ndonjë krim, ai mund të nxjerrë urdhër drejtpërdrejt kundër personit të akuzuar, ku e specifikon zhdëmtimin e duhur ndaj viktimave, kolektivisht apo individualisht, ose në lidhje me ato viktima”.

62. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se mund të lëshojë urdhër për zhdëmtim kundër personit të shpallur fajtor, në përputhje me nenin 22(8) të Ligjit, vetëm pasi të ketë përcaktuar shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat në çështjen gjyqësore në fjalë, në përputhje me nenin 22(7) të Ligjit dhe rregullën 168 të Rregullores. Po ashtu, siç kërkohet në fjalinë e parë të nenit 22(7) të Ligjit, vendimi në lidhje me shkallën dhe masën e dëmit presupozon se Trupi Gjykses “[...] i deklaroi

⁸⁸ [International Covenant on Civil and Political Rights](#) (Marrëveshja Ndërkombëtare për Të Drejtat Civile dhe Politike), 16 December 1966, United Nations, Treaty Series, vol. 999, p. 171.

⁸⁹ [Convention Against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment](#) (Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Poshtëruese), 10 December 1984, United Nations, Treaty Series, vol. 1465, p. 85.

parimet sipas të cilave vepron". Rrjedhimisht, para se të lëshojë urdhër për zhdëmtim kundër personit të shpallur fajtor, Trupi Gjykses duhet të shtjellojë parimet në lidhje me zhdëmtimet dhe të përcaktojë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat në çështjen që gjykohet.

63. Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje se në DHSK, sikurse në Gjykatën Penale Ndërkombëtare ("GJPN"), parashihet një sistem zhdëmtimesh në kontekst të proceseve penale.⁹⁰ Trupi Gjykses vë në dukje në këtë aspekt se neni 22 i Ligjit dhe rregulla 168 e Rregullores pasqyrojnë në njëfarë mase formulimet e dispozitave përkatëse për zhdëmtim në tekstet juridike të GJPN-së.⁹¹ Për këtë arsye, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme të orientohet nga jurisprudenca e GJPN-së, ndër të tjera edhe për formulimin e parimeve lidhur me zhdëmtimet.

64. Instrumentet e tjera ndërkombëtare, si Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit⁹² ("Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë") dhe Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën për Mjet Juridik dhe Zhdëmtim për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve

⁹⁰ Në fakt, GJPN-ja ishte juridiksioni i parë ndërkombëtar që miratoi sistemin e zhdëmtimeve sipas të cilit viktimat e krimeve brenda juridiksionit të GJPN-së mund të kërkojnë zhdëmtim nga personat e shpallur fajtorë nga GJPN-ja.

⁹¹ *Krahaso* nenin 22(7) dhe (8) të Ligjit dhe rregullën 168 të Rregullores me nenin 75(1) dhe (2) të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare ([Rome Statute of the International Criminal Court](#), 17 July 1998 (ndryshuar për herë të fundit në vitin 2010), United Nations, Treaty Series, vol. 2187, No. 38544) dhe rregullën 97 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Gjykatës Penale Ndërkombëtare ([Rules of Procedure and Evidence of the International Criminal Court](#)).

⁹² United Nations General Assembly, A/RES/40/34, [Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power](#) (Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe të Keqpërdorimit të Pushtetit), 29 nëntor 1985.

të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare⁹³ (“Parimet Themelore të OKB-së për Zhdëmtimet”) dhe raporte të rëndësishme lidhur me të drejtat e njeriut, gjithashtu ofrojnë orientim për Trupin Gjykes për përcaktimin e parimeve në lidhje me zhdëmtimet.

65. Së fundi, Trupi Gjykes do të orientohet nga jurisprudenca e gjykatave rajonale të të drejtave të njeriut – si Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“GJEDNJ”) dhe Gjykata Ndëramerikane e të Drejtave të Njeriut (“GJNDNJ”), duke vënë në dukje dallimet midis këtyre gjykatave dhe sistemit të zhdëmtimeve të DHSK-së dhe duke marrë parasysh kontributin e tyre të konsiderueshëm në avancimin e të drejtave të individëve për mjet juridik efektiv dhe për zhdëmtim.

B. PARIMET PËR ZHDËMTIMET: PASQYRË E PËRGJITHSHME

66. Fillimisht, Trupi Gjykes dëshiron të theksojë se mjetet juridike dhe zhdëmtimet për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare janë kusht i domosdoshëm i drejtësisë. Trupi Gjykes gjithashtu dëshiron të theksojë se, sipas mendimit të tij, qëllimi i zhdëmtimeve në DHSK nuk është vetëm të ndëshkojë personat e shpallur fajtorë siç parashihet në nenin 44(6) të

⁹³ United Nations General Assembly, A/RES/40/34, [United Nations Basic Principles on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law](#) (Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën për Mjet Juridik dhe Zhdëmtim për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare), 16 dhjetor 2005.

Ligjit; por shërben për të pranuar dhe për të ndrequr, aq sa është e mundshme, dëmin e shkaktuar viktimës.⁹⁴

67. Parimet për zhdëmtimet janë koncepte të përgjithshme që së bashku përbëjnë kornizën ligjore që e orienton Trupin Gjykes gjatë përcaktimit të shkallës dhe masës së dëmit të pësuar nga viktimat në çështjen që gjykohet, të kuadrit të përgjegjësisë së personit të shpallur fajtor për zhdëmtime, dhe të zhdëmtimeve që duhet t'u akordohen viktimave.⁹⁵

68. Si parim i përgjithshëm, zhdëmtimet në DHSK duhet të përqendrohen te viktimat.⁹⁶ Kjo do të thotë se interesat, nevojat, pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimave duhet të jenë forca shtytëse e procesit të vendimmarrjes për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zhdëmtimet.

69. Në këtë aspekt, DHSK-ja u kushton vëmendjen e duhur viktimave dhe i përfshin në mënyrën e duhur në procese në pajtim me nenin 22(11) të Ligjit, për të garantuar respektimin dhe realizimin e të drejtës së tyre për të vërtetën, drejtësi dhe zhdëmtim.⁹⁷

70. Viktimat duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë gjatë të gjithë procesit të zhdëmtimit dhe të marrin mbështetje të mjaftueshme që pjesëmarrja e tyre të jetë

⁹⁴ *Shih gjithashtu* nenin 38(1)(1.3) të Kodit Penal të Kosovës, 14 janar 2019, Kodi Nr. 06/L-074 ku thuhet se një nga qëllimet e dënimit është "të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale".

⁹⁵ *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v Lubanga*, ICC-01/04-01/06-3129-AnxA, Appeals Chamber, [Order for Reparations \(amended\)](#) (Lubanga AC Amended Reparations Order), 3 mars 2015, publik, para. 5.

⁹⁶ *Ngjashëm*, ICC, *Prosecutor v Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-2659, Trial Chamber VI, [Reparations Order](#) (Ntaganda TC Reparations Order), 8 mars 2021, publik, para. 45.

⁹⁷ *Ngjashëm*, ICC, [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 45 dhe referencat aty.

thelbësore dhe efektive.⁹⁸ Në këtë kontekst, është me shumë rëndësi komunikimi në kohë dhe efektiv që synon informimin e viktimave për zhdëmtimet.⁹⁹

71. Të gjitha viktimat duhet të kenë trajtim të drejtë dhe të barabartë sa u përket zhdëmtimeve. Viktimat duhet të kenë qasje të barabartë në informacion lidhur me të drejtën për zhdëmtim dhe për ndihmë nga DHSK-ja.¹⁰⁰ Megjithatë, gjatë vënies në jetë dhe zbatimit të dëmshpërblimeve të akorduara nga Trupi Gjykses, mund të nevojitet t'u jepet përparësi viktimave që janë në gjendje veçanërisht të cenueshme ose të cilëve u nevojitet ndihmë urgjente.¹⁰¹

72. DHSK-ja i trajton viktimat në mënyrë njerëzore, dhe dinjiteti dhe të drejtat njerëzore të tyre duhet të respektohen.¹⁰² Për këtë qëllim, DHSK-ja zbaton masa mbrojtëse të përshtatshme për të garantuar sigurinë e viktimave si dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre,¹⁰³ edhe gjatë vënies në jetë dhe zbatimit të urdhrave për zhdëmtim.

73. Komunikimet me viktimat duhet të kryhen me kujdes, duke parandaluar traumatizim të sërishëm dhe duke i menaxhuar me takt pritshmëritë e tyre.¹⁰⁴

⁹⁸ Shih KSC-BC-2020-05, F00055, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Victims' Participation](#) (Vendimi Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), 27 nëntor 2020, publik, para. 16.

⁹⁹ Shih Vendimin Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Victims' Participation Framework Decision](#)), para. 16.

¹⁰⁰ Shih Vendimin Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Victims' Participation Framework Decision](#)), para. 16. Shih nenin 22(3) të Ligjit (interesi personal dhe të drejtat e viktimave në procedura penale para DHSK-së përfshijnë njoftimin).

¹⁰¹ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 19.

¹⁰² [UN Basic Principles on Reparations](#) (Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet), para. 10.

¹⁰³ Neni 23 i Ligjit dhe rregulla 80 e Rregullores. Shih gjithashtu Vendimin Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Victims' Participation Framework Decision](#)) para. 44-45.

¹⁰⁴ Ngjashëm, ICC, [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 49.

74. Viktimat duhet të marrin zhdëmtime të arsyeshme, të përshtatshme dhe të shpejta.¹⁰⁵ Procesi i zhdëmtimit, përfshirë vënien në jetë dhe zbatimin e urdhrin për zhdëmtim, duhet të jetë sa më i shpejtë që të jetë e mundshme dhe duhet të shmangen paditë e zgjatura pa nevojë, komplekse dhe të kushtueshme.¹⁰⁶

75. Zhdëmtimi duhet të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar, në rrethanat konkrete të çështjes.¹⁰⁷

76. Zhdëmtimi u akordohet viktimave pa dallim seksi, gjinie, moshe, race, ngjyre, gjuhe, feje apo besimi, mendimeve politike apo të tjera, orientimi seksual, origjine kombëtare, etnike apo shoqërore, statusi pasuror, të lindjes, martesor ose tjetër.¹⁰⁸

77. Për më tepër, në lidhje me zhdëmtimet nuk duhet të përsëriten praktikrat apo strukturat diskriminuese që ekzistonin para kryerjes së krimeve, dhe të cilat pengonin mundësi të barabarta për viktimat.¹⁰⁹ DHSK-ja duhet t'i shmangët stigmatizimit të mëtejshëm të viktimave dhe përforcimit të diskriminimit nga familjet dhe komunitetet e tyre.¹¹⁰ Në veçanti, zhdëmtimet duhet të shmangin krijimin e tensioneve, xhelozisë apo armiqësisë midis komuniteteve të prekura dhe midis grupeve bashkëjetuese.¹¹¹

¹⁰⁵ Neni 22(3) dhe (8) i Ligjit; [UN Basic Principles on Reparations](#) (Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet), para. 2, 11, 14-15.

¹⁰⁶ Ngjashëm, ICC, [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 89.

¹⁰⁷ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 45.

¹⁰⁸ Neni 24 i Kushtetutës; [UN Basic Principles on Reparations](#) (Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet), para. 25.

¹⁰⁹ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 17; [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 44.

¹¹⁰ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 17; [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 44.

¹¹¹ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 17; [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 44.

78. Zhdëmtimet janë vullnetare dhe përpara akordimit të zhdëmtimit nevojitet pëlqimi i vetëdijshëm i përfituesit të tij.¹¹²

79. Asnjë nga këto parime nuk duhet të cenojë apo të jetë në mospajtim me të drejtat e personit të akuzuar ose të shpallur fajtor për procedim të drejtë dhe të shpejtë.¹¹³ Për më tepër, personit të akuzuar ose të shpallur fajtor, sipas rastit, duhet t'i jepet kohë dhe mundësi të përgjigjet dhe/ose të bëjë parashtrime në lidhje me zhdëmtimet.

80. Gjatë të gjithë fazave të zhdëmtimit dhe veçanërisht gjatë vënies në jetë dhe zbatimit të urdhrave për zhdëmtim, të gjithë subjektet dhe personat në Kosovë janë të detyruar të bashkëpunojnë plotësisht me DHSK-në.¹¹⁴

81. Së fundi, zhdëmtimet e akorduara në përputhje me urdhrin për zhdëmtim nuk e lirojnë Kosovën nga detyrimet e saj, sipas legjislacionit vendor ose traktateve ndërkombëtare, që t'i dëmshpërblejë qytetarët e vet.¹¹⁵

C. PËRFITUESIT E ZHDËMTIMEVE

82. Trupi Gjykues vë në dukje se Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë që viktimat të pranohen në procese në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit.¹¹⁶ Trupi Gjykues nuk sheh arsye për të devijuar nga kjo

¹¹² Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 30.

¹¹³ Shih nenet 21 dhe 22(7) të Ligjit.

¹¹⁴ Neni 53(1) dhe (2) i Ligjit, lexo së bashku me nenin 44(6) të Ligjit.

¹¹⁵ Shih nenin 54 të Kushtetutës. Shih gjithashtu nenin 22(2) të Ligjit.

¹¹⁶ [Victims' Participation Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 27, 29, 31-38. [Second Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 32. Shih Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Third Victims Participation Decision](#)), para. 18 dhe referencat aty.

jurisprudencë në kontekstin e zhdëmtimit, duke vënë në dukje, sidoqoftë, standardin e ndryshëm të vërtetimit në lidhje me zhdëmtimin që duhet të përmbushet nga viktimat.¹¹⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i përfshin dispozitat ligjore përkatëse dhe kriteret e përcaktuara më parë përmes referimit dhe do t'i diskutojë vetëm shkurtimisht këtu.

83. Që të kenë të drejtë për zhdëmtim, viktimat duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- i. viktima është person fizik;
- ii. krimi që ka shkaktuar dëmin duhet të jetë krim për të cilin personi është shpallur fajtor;
- iii. viktima ka pësuar dëm personalisht; dhe
- iv. dëmi ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i krimit për të cilin personi është shpallur fajtor.¹¹⁸

84. Rrjedhimisht, viktimat duhet të plotësojnë të njëjtat kritere si ato për t'u pranuar në proces gjyqësor, por vetëm se dëmi i pësuar është rezultat i "i krimit për të cilin personi është shpallur fajtor" në vend të "krimit në aktakuzë".¹¹⁹

85. Sa i përket aspektit që dëmi duhet të jetë pësuar personalisht nga viktima, Trupi Gjykses rikujton se kjo nënkupton kushtin që dëmi të jetë pësuar *nga* viktima, d.m.th

¹¹⁷ *Shih* para. 100 e në vijim.

¹¹⁸ Në kontekstin e Urdhrit për Zhdëmtim, do të merren parasysh vetëm viktimat e pranuar të marrin pjesë në këtë proces gjyqësor.

¹¹⁹ *Shih* Vendimin Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Victims' Participation Framework Decision](#)), para. 27(b) dhe (c).

është dëmtuar mirëqenia fizike apo mendore ose gjendja ekonomike e tij ose e saj.¹²⁰
Kjo mund të përfshijë dëmin e pësuar nga viktimat që ishin objekt i veprimeve të kryesit (kryesve) (viktimat e drejtpërdrejta).¹²¹

86. Dëmi i pësuar nga një viktimë si rezultat i një apo më shumë krimeve për të cilat personi është shpallur fajtor mund t'u shkaktojë dëm viktimave të tjera. Këtu mund të përfshihet dëmi i pësuar nga persona në marrëdhënie të ngushtë personale me viktimën e drejtpërdrejtë të vrarë apo të lënduar nga kryesit (viktimat e tërthorta).¹²²
Anëtarët e familjes së ngushtë (bashkëshortja, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat) konsiderohet se janë në marrëdhënie të ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë.¹²³

87. Trupi Gjykses dëshiron të theksojë se vërtetimi i "marrëdhënies së ngushtë personale" me viktimën e drejtpërdrejtë është një mënyrë se si viktimat e tërthorta mund të provojnë se kanë pësuar dëm personal dhe se dëmi është rezultat i krimeve për të cilat personi është shpallur fajtor. Trupi Gjykses gjithashtu vlerëson se ndër viktimat e tërthorta mund të përfshihen ata që kanë pësuar dëm kur kanë ndërhyrë për të ndihmuar viktimat në fatkeqësi ose për të parandaluar viktimizimin.¹²⁴

¹²⁰ *Shih* Vendimin Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Victims' Participation Framework Decision](#)), para. 33 dhe referencat aty.

¹²¹ *Shih* Vendimin Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Victims' Participation Framework Decision](#)), para. 33 dhe referencat aty.

¹²² *Shih* Vendimin Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Victims' Participation Framework Decision](#)), para. 33 dhe referencat aty.

¹²³ *Shih* Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Second Victims Participation Decision](#)), para. 32 dhe referencat aty.

¹²⁴ [Declaration of Basic Principles of Justice](#) (Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë) para. 2: "Shprehja 'viktimë' përfshin gjithashtu [...] personat që kanë pësuar dëm kur kanë ndërhyrë për t'i ndihmuar viktimat në fatkeqësi apo të për të parandaluar viktimizimin".

88. Në rast se viktimat për të cilën është konstatuar se gëzon të drejtën për zhdëmtim vdes para se t'i akordohet zhdëmtimi, pasardhësit ose trashëguesit e viktimës kanë të njëjtën të drejtë për zhdëmtimin e akorduar.¹²⁵

D. DËMI

1. Koncepti dhe llojet e dëmit

89. Koncepti i dëmit përfshin “çdo dëmtim, humbje dhe lëndim”.¹²⁶

90. Ligji dhe Rregullorja identifikojnë tri lloje të dëmit: fizik, mendor dhe material.¹²⁷ Sa u përket llojeve të dëmit, Trupi Gjykes përfshin përmes referimit përkufizimet e përcaktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake¹²⁸ dhe do t'i zgjerojë ato vetëm nëse vlerësohet se është e nevojshme.

91. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykes dëshiron të theksojë se viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare, si tortura, shpesh vuajnë pasoja afatgjata përtej dëmit të atypëratyshëm fizik, mendor ose material. Kjo shfaqet me mundësi të humbura, përfshirë në lidhje me punësimin, arsimimin, dhe përfitimet shoqërore.¹²⁹ Gjykatat ndërkombëtare gjithashtu

¹²⁵ Ngjashëm, ICC, [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 40 dhe referencat aty.

¹²⁶ *Shih* nenin 22(7) të Ligjit.

¹²⁷ Neni 22(1) i Ligjit; rregulla 2 e Rregullores; [Third Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 19; [Second Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 33.

¹²⁸ [Victims' Participation Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 32-36.

¹²⁹ *Shih* ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 40(d) dhe poshtëshënimin numër 23 dhe referencat aty.

përmendin konceptin e dëmit ndaj planeve ose projekteve për jetën.¹³⁰ Përgjithësisht, dëmi i shkaktuar ndaj planeve ose projekteve për jetën nënkupton faktin se jeta e viktimës dhe/ose e anëtarëve të familjes ndërpritet ose çrregullohet si rezultat i krimeve të kryera kundër tyre.¹³¹ Më konkretisht, kjo ka të bëjë me mungesën e vetërealizimit të plotë të një personi, i cili, duke pasur parasysh profesionin, aftësitë, rrethanat, potencialin dhe aspiratat, logjikisht mund të priste të arrinte gjëra të caktuara në jetë.¹³² Kjo shprehet përmes pritshmërive për zhvillim personal, profesional dhe familjar që janë të mundshme në rrethana normale.¹³³ Ky dëm nënkupton humbje ose pakësim të madh të mundësive për zhvillim, në mënyrë të riparueshme, ose të riparueshme me shumë vështirësi.¹³⁴

¹³⁰ *Shih ICC, Prosecutor v Lubanga, ICC-01/04-01/06-3466-Red, Appeals Chamber, [Public Redacted version of Judgment on the appeals against Trial Chamber II's 'Decision Setting the Size of the Reparations Award for which Thomas Lubanga Dyilo is Liable'](#) (Lubanga AC Judgment on Decision setting Liability), 18 korrik 2019, para. 38 dhe referencat aty; [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 71-72.*

¹³¹ *Shih IACtHR, Case of Tibi v Ecuador, [Judgment](#) (Preliminary objections, merits, reparations and costs) (Case of Tibi v Ecuador), 7 September 2004, Series C No. 114, para. 245-248.*

¹³² *IACtHR, Case of Álvarez Ramos v Venezuela, [Judgment](#) (Preliminary Objection, Merits, Reparations, and Costs) 30 August 2019, Series C No. 380, para. 225 dhe referencat aty.*

¹³³ *IACtHR, [Case of Tibi v Ecuador](#), para. 245.*

¹³⁴ *IACtHR, Case of Loayza-Tamayo v. Peru, [Judgment](#) (Reparations and Costs) (Case of Loayza-Tamayo v. Peru), 27 November 1998, Series C No. 42, para. 150. Edhe pse GJNANJ-ja refuzoi të vlerësonte këtë lloj dëmi në [Case of Loayza-Tamayo v Peru](#), ajo e ka vlerësuar në çështje të mëvonshme dhe e ka korrigjuar atë përmes kompensimit (*Case of the Dos Erres Massacre v Guatemala, [Judgment](#) (Preliminary Objection, Merits, Reparations and Costs), 24 November 2009, Series C No. 211, para. 284, 293, dhe Case of Mejía Idrovo v Ecuador, [Judgment](#) (Preliminary Objections, Merits, Reparations, and Costs), 5 July 2011, Serie C No. 228, para. 134) ose modalitetet e tjera të zhdëmtimeve (IACtHR, *Case of Cantoral Benavides v Peru, [Judgment](#) (Reparations and Costs), 3 December 2001, Series C No. 88, para. 80).***

92. Trupi Gjykues gjithashtu mendon se dëmi mund të shtrihet mbi disa breza, *d.m.th.* kur dhuna shoqërore përcillet nga paraardhësit te pasardhësit me pasoja traumatike për të dytët.¹³⁵

2. Shkakësia

93. Trupi Gjykues kujton se, në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullën 2 të Rregullores, “viktima është person fizik që personalisht ka pësuar dëm, përfshirë dëm fizik, mendor ose material, si *rezultat i drejtpërdrejtë* i krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara” [theksimi i shtuar]. Trupi Gjykues vë në dukje se as Ligji e as Rregullorja nuk i përkufizojnë kushtet e sakta të lidhjes shkakësore midis krimit dhe dëmit përkatës në kontekstin e zhdëmtimit.

94. Sipas mendimit të Trupit Gjykues, lidhja shkakësore midis krimit dhe dëmit në kontekstin e zhdëmtimit duhet të përcaktohet duke marrë parasysh rrethanat konkrete të çështjes.¹³⁶

95. Sa i përket shkakësisë faktike, në përcaktimin e lidhjes midis krimit dhe dëmit Trupi Gjykues zbaton standardin “sikur të mos ishte”, që do të thotë se, sikur të mos

¹³⁵ Shih ICC, *Prosecutor v Katanga*, ICC-01/04-01/07-3728-tENG, Trial Chamber II, [Order for Reparations pursuant to Article 75 of the Statute](#) (Katanga TC Reparations Order), 24 March 2017 (English translation filed on 17 August 2017), public, para. 323-324 with one public annex and one confidential annex, para. 132; *Prosecutor v Katanga*, ICC-01/04-01/07-3804-Red-tENG, Trial Chamber II, [Decision on the Matter of the Transgenerational Harm Alleged by Some Applicants for Reparations Remanded by the Appeals Chamber in its Judgment of 8 March 2018](#), 19 July 2018, para. 10; *Ntaganda TC Reparations Order*, para. 73.

¹³⁶ Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v Lubanga*, ICC-01/04-01/06-3129, Appeals Chamber, [Judgment on the appeals against the “Decision establishing the principles and procedures to be applied to reparations” of 7 gusht 2012](#), (Lubanga AC Judgment on Principles of Reparations), 3 March 2015, public, with two public annexes, para. 80.

ishte kryer krimi (krimet) nga personi i shpallur fajtor, dëmi nuk do të kishte ndodhur.¹³⁷

96. Sa i përket shkakut parësor ose shkakut juridik, Trupi Gjykses mbështet përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në kontekstin e pjesëmarrjes së viktimave, konkretisht se dëmi është rezultat i drejtpërdrejtë i krimit:

kur, në rrethanat që kanë ekzistuar në vendin dhe kohën përkatëse dhe duke marrë parasysh gjendjen personale të viktimës, kishte shumë të ngjarë që veprimet ose mosveprimet e kryesit ose kryesve ta shkaktonin atë dëm, nga këndvështrimi i një vëzhguesi objektiv.¹³⁸

97. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se nuk është kusht që krimi të jetë i vetmi shkak i dëmit të pësuar, por duhet të ketë kontribuar në të.¹³⁹

98. Sa u përket viktimave të tërthorta, parashtruesit e kërkesave duhet të tregojnë se dëmi i pësuar prej tyre ishte rezultat i dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë.¹⁴⁰ Megjithatë, për dëmin mendor, prezumohet vuajtja shpirtërore (si dhimbja, hidhërimi, pikëllimi i thellë, ose shqetësimi) e viktimës së tërthortë si rezultat i vdekjes ose

¹³⁷ Ngjashëm, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 59.

¹³⁸ [Victims' Participation Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 38.

¹³⁹ Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v Bemba*, ICC-01/05-01/08-320, Pre-Trial Chamber III, [Fourth Decision on Victims' Participation](#), 12 December 2008, publik, para. 77: "[...] nuk është e domosdoshme që incidentet që përbëjnë bazën faktike të krimit ose krimeve të pretenduara të kenë luajtur rol të konsiderueshëm ose të kenë qenë shkak kryesor, në qoftë se prej këndvështrimit *ex post* të një vëzhguesi objektiv ato kanë kontribuar, së paku pjesërisht, në dëmin që pretendohet se është pësuar". Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk pajtohet me përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se krimi duhet të ketë kontribuar në masë të konsiderueshme për dëmin, *shih* Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Second Victims Participation Decision](#)), para. 37.

¹⁴⁰ [Second Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 37 dhe referencat aty. *Shih* para. 86-87 më lart.

lëndimit të rëndë të viktimës së drejtpërdrejtë, me kusht që të vërtetohet mjaftueshëm marrëdhënia e ngushtë midis tyre.¹⁴¹

3. Detyrimi dhe standardi i vërtetimit

99. Viktimat që kërkojnë zhdëmtim duhet të paraqesin prova të mjaftueshme për: identitetin e tyre si persona fizikë; shkallën dhe masën e dëmit të pësuar; dhe për lidhjen shkakësore midis krimit për të cilin është dhënë vendim fajësie dhe dëmit të pësuar.

100. Ndryshe nga kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e viktimave në procese gjyqësore,¹⁴² Ligji dhe Rregullorja nuk saktësojnë standardin e vërtetimit në lidhje me zhdëmtimet. Sipas mendimit të Trupit Gjyqësor, përcaktimi i standardit të “përshtatshëm”, dhe se çfarë është “e mjaftueshme” për përmbushjen e detyrimit të vërtetimit, do të varet nga rrethanat konkrete të çështjes.

101. Në lidhje me këtë, duke marrë parasysh se zhdëmtimet janë themelësisht të ndryshme nga gjykimet ku fajësia e të akuzuarit duhet të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm, për to duhet të zbatohet një standard vërtetimi më pak rigoroz se ai që zbatohet gjatë gjyqësorit.¹⁴³ Për analogji, Trupi Gjyqësor është i mendimit se standardi i vërtetimit “*prima facie*”¹⁴⁴ i zbatuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjyqësor, sipas rastit, për vlerësimin e informacionit dhe materialit mbështetës të

¹⁴¹ [Second Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 35. Që ka të bëjë me “marrëdhënien e ngushtë personale”, shih para. 86 më lart.

¹⁴² Shih rregullën 113(4) të Rregullores.

¹⁴³ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Judgment on Principles of Reparations](#), para. 81.

¹⁴⁴ Shih rregullën 113(4) të Rregullores. “*Prima facie*” do të thotë “në shikim të parë; në dukje; siç duket në shikim të parë pa hetime” ([Victims’ Participation Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 28 dhe poshtëshënimi 28).

paraqitur nga individët për qëllimin e pjesëmarrjes në procese gjyqësore, nuk është i përshtatshëm, duke pasur parasysh detyrimet e personit të shpallur fajtor që burojnë nga urdhri për zhdëmtim.

102. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh praktikën e GJPN-së, Trupi Gjykses përdor kriterin e “tërësisë së gjasave” si standard të përshtatshëm të vërtetimit në kontekstin e zhdëmtimeve. Ky standard i vërtetimit do të thotë se viktima duhet të provojë se ka më shumë të ngjarë se jo që ai ose ajo të ketë pësuar dëm si pasojë e njërit prej krimeve për të cilat z. Mustafa është shpallur fajtor.¹⁴⁵

103. Për më tepër, në pajtim me praktikën e GJPN-së,¹⁴⁶ Trupi Gjykses është i mendimit se dëme të caktuara mund të prezumohen kur viktima ka provuar, bazuar në tërësinë e gjasave, se është viktimë e krimeve për të cilat personi është shpallur fajtor, dhe se mund të mbështetet në prova rrethanore kur viktima nuk ka prova të drejtpërdrejta.¹⁴⁷ Sidoqoftë, kur mbështetet në prezumime, Trupi Gjykses duhet të respektojë si të drejtat e viktimave, ashtu edhe ato të personit të shpallur fajtor.¹⁴⁸

¹⁴⁵ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 65; [Katanga TC Reparations Order](#), para. 46-51 dhe referencat aty.

¹⁴⁶ Ngjashëm, ICC, [Katanga TC Reparations Order](#), para. 57-61 dhe referencat aty. Shih gjithashtu, ICC, *Prosecutor v Lubanga*, ICC-01/04-01/06-3379-Red-Corr-tENG, Trial Chamber II, [Corrected version of the “Decision Setting the Size of the Reparations Award for which Thomas Lubanga Dyilo is Liable”](#) (Lubanga TC Decision setting Liability), 21 December 2017 (English translation filed on 5 July 2018), public, paras 180, 185, with two public annexes and one confidential annex.

¹⁴⁷ Ngjashëm, ICC, [Katanga TC Reparations Order](#), para. 57-61 dhe referencat aty.

¹⁴⁸ Shih gjithashtu, ICC, *Prosecutor v Katanga*, ICC-01/04-01/07-3778-Red, Appeals Chamber, [Public redacted version of Judgment on the appeals against the order of Trial Chamber II of 24 March 2017 entitled “Order for Reparations pursuant to Article 75 of the Statute”](#) (Katanga AC Judgment on Reparations Order), 8 March 2018, public, para. 4, 75.

E. LLOJET DHE MODALITETET E ZHDËMTIMEVE¹⁴⁹

104. Në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit dhe rregullën 168(1) të Rregullores, viktimave mund t'u akordohen zhdëmtime "kolektivisht ose individualisht". Sipas mendimit të Trupit Gjykses, këto dy lloje zhdëmtimesh nuk përjashtojnë njëri-tjetrin dhe mund të akordohen njëkohësisht.¹⁵⁰

105. Zhdëmtimet mund të përshkruhen si individuale kur dëmshpërblimi rezultues i jepet drejtpërdrejt viktimës për të ndrequr dëmin e pësuar si pasojë e krimeve për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari; ato i japin viktimës një përfitim për të cilin ai ose ajo ka të drejtë ekskluzive.¹⁵¹ Zhdëmtimet individuale duhet të akordohen në mënyrë të tillë që të shmangin krijimin ose shtimin e tensioneve dhe ndasive në komunitetet përkatëse.¹⁵²

106. Termi *zhdëmtime kolektive* mund t'u referohet karakterit të tyre (llojit të mallrave ose shërbimeve që shpërndahen ose mënyrës së shpërndarjes), ose përfituesve të tyre (komuniteteve ose grupeve).¹⁵³ Ato dallojnë nga zhdëmtimet individuale për faktin se përfitues të tyre janë grupi ose kategoria e personave që kanë pësuar dëm

¹⁴⁹ Sa i përket dallimit midis 'llojeve' dhe 'modaliteteve' të zhdëmtimeve, shih ICC, [Katanga TC Reparations Order](#), para. 265-295 (për llojet), 296-305 (për modalitetet).

¹⁵⁰ Ngjashëm, ICC, [Katanga TC Reparations Order](#), para. 256, 283.

¹⁵¹ Ngjashëm, ICC, [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 79 dhe referencat aty.

¹⁵² Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 33.

¹⁵³ Ngjashëm, ICC, [Katanga TC Reparations Order](#), para. 273 dhe referencat aty.

bashkërisht.¹⁵⁴ Zhdëmtimet kolektive mund të mbulojnë dëmin e pësuar nga viktimat qoftë individualisht apo kolektivisht.¹⁵⁵

107. Neni 44(6) i Ligjit përcakton vetëm dy modalitete të zhdëmtimeve, atë të dëmshpërblimit dhe të kompensimit. Trupi Gjykes vë në dukje se Parimet Themelore të OKB-së për Zhdëmtimet parashohin këto modalitete shtesë për zhdëmtimet, të cilat janë mbështetur nga GJPN-ja në kontekstin e përgjegjësisë për zhdëmtim që ka personi i shpallur fajtor: rehabilitimi dhe njohja.¹⁵⁶ Trupi Gjykes është i mendimit se këto modalitete të zhdëmtimit janë të zbatueshme edhe në DHSK.¹⁵⁷

108. Zhdëmtimet mund të kenë gjithashtu vlerë simbolike, parandaluese dhe transformuese,¹⁵⁸ dhe mund të ndihmojnë në promovimin e pajtimit midis viktimave të krimeve, komuniteteve të prekura dhe personit të shpallur fajtor.¹⁵⁹

109. Kthimi i të drejtave përkufizohet si masa që synojnë ta rikthejnë, aq sa është e mundshme, jetën e viktimës ashtu si ka qenë para shkeljeve, përfshirë kthimin në familje, në shtëpi, në punën e mëparshme, vazhdimin e arsimit, ose kthimin e

¹⁵⁴ Ngjashëm, ICC, [Katanga TC Reparations Order](#), para. 275; shih gjithashtu, ICC, *Prosecutor v Al Mahdi*, ICC-01/12-01/15-236, Trial Chamber VIII, [Reparations Order](#) (*Al Mahdi* Reparations Order), 17 August 2017, publik, para. 59, 67.

¹⁵⁵ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 33.

¹⁵⁶ Shih Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet ([UN Basic Principles on Reparations](#)), para. 18-22. Shih gjithashtu ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 34-42. Shih më tej nenin 14 të KKT-së, që i referohet të drejtës për "rehabilitim të plotë" të viktimave të torturës.

¹⁵⁷ Trupi Gjykes rikujton se Parimet Themelore të OKB-së për Zhdëmtimet pasqyrojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare, dhe rrjedhimisht janë të zbatueshme në DHSK në pajtim me nenin 3(2)(d) të Ligjit.

¹⁵⁸ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 34; [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 82.

¹⁵⁹ Ngjashëm, ICC, [Al Mahdi TC Reparations Order](#), para. 28; [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 71.

pasurisë së humbur apo të vjedhur.¹⁶⁰ Ky modalitet i zhdëmtimeve mund të mos jetë gjithmonë i mjaftueshëm ose i përshtatshëm.¹⁶¹

110. Kompensimi zakonisht është akordim i fondeve monetare si pagesë për dëmet e pësuar.¹⁶² Në raste të caktuara, ai merr formën e “masës ndreqëse zëvendësuese” pasi nuk mund të kthejë anëtarin e familjes që është vrarë ose t’i rikthejë aftësitë fizike personit që është lënduar.¹⁶³ Kjo vlen si për dëmet monetare ashtu edhe për ato jomonetare.

111. Masat e rehabilitimit mund të përfshijnë kujdesin mjekësor, zhvillimin ekonomik, ndihmën sociale apo shërbimet juridike.¹⁶⁴

112. Njohja mund të përfshijë masa të cilat njohin shkeljet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ose shkeljet e rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Ajo mund të përfshijë, për shembull, kërkimin publikisht të faljes nga kryesit e dhunës, së bashku me pranimin e fakteve dhe pranimin e përgjegjësisë, zbulimin e plotë dhe publik të së vërtetës, me kusht që të mos shkaktojë sërish dëm për viktimat

¹⁶⁰ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 35 i referohet Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Zhdëmtimet ([UN Basic Principles on Reparations](#)), para. 19.

¹⁶¹ Shih IACtHR, *Case of Aloeboetoe et al. v Suriname*, [Judgment](#) (Reparations and Costs), 10 September 1993, Series C Nr. 15, para. 49. Shih gjithashtu, IACtHR, *Case of Atala Riffo and daughters v Chile*, [Judgment](#) (Merits, Reparations, and Costs), 24 February 2012, Series C No. 239, para. 241; Chambre africaine extraordinaire d’assises d’appel, Situation en République du Tchad, *Le Procureur Général c Hissein Habré*, [Arrêt](#), 27 April 2017, para. 842.

¹⁶² Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 40; [Al Mahdi TC Reparations Order](#), para. 47.

¹⁶³ African Court on Human and Peoples’ Rights, [Comparative Study on the Law and Practice of Reparations for Human Rights Violations](#), September 2019, f. 51 (është hapur për herë të fundit më 10 janar 2023).

¹⁶⁴ Shih Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet ([UN Basic Principles on Reparations](#)), para. 21. Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 42; [Al Mahdi TC Reparations Order](#), para. 48; [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 87.

dhe familjet e tyre, të mos kërcënojë sigurinë e dëshmitarëve dhe viktimave ose përkujtimin dhe respektin për viktimat.¹⁶⁵

F. PËRGJEGJËSIA PËR ZHDËMTIM E PERSONIT TË SHPALLUR FAJTOR

113. Zhdëmtimet në DHSK duhet të pasqyrojnë kontekstin prej të cilit burojnë, domethënë sistemin juridik sipas të cilit është vërtetuar përgjegjësia penale individuale për krime sipas Ligjit.¹⁶⁶ Rrjedhimisht, urdhri për zhdëmtim duhet të jepet vetëm në lidhje me krimet për të cilat është vendosur se ka përgjegjësi personi i shpallur fajtor, dhe duhet të lëshohet në të gjitha rrethanat kundër personit të shpallur fajtor.¹⁶⁷

114. Përgjegjësia për zhdëmtim e personit të shpallur fajtor duhet të jetë proporcionale me dëmin e shkaktuar, në rrethanat konkrete të çështjes.¹⁶⁸

115. Në përcaktimin e shumës së zhdëmtimit për të cilën është përgjegjës personi i shpallur fajtor, faktori kryesor duhet të jetë shkalla dhe masa e dëmit të pësuar nga viktimat.¹⁶⁹

¹⁶⁵ *Shih* Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet ([UN Basic Principles on Reparations](#)), para. 22. *Ngjashëm*, ICC, [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 88, 210.

¹⁶⁶ *Ngjashëm*, ICC, [Katanga TC Reparations Order](#), para. 17.

¹⁶⁷ Neni 22(8) i Ligjit përcakton se: “Kur trupi gjykues ose paneli i Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara e gjykon të akuzuarin si fajtor për ndonjë krim, ai mund të nxjerrë urdhër drejtpërdrejt kundër personit të akuzuar” [theksimi i shtuar]. *Shih gjithashtu* rregullën 168 të Rregullores, me titull “Urdhër për zhdëmtim kundër personit të shpallur fajtor”.

¹⁶⁸ *Ngjashëm*, ICC, [Lubanga AC Amended Reparations Order](#), para. 21.

¹⁶⁹ *Ngjashëm*, ICC, [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 98.

116. Përgjegjësia e personave, organizatave të tjera, ose e shtetit, nuk është relevante për përcaktimin e përgjegjësisë për zhdëmtim që ka personi i shpallur fajtor.¹⁷⁰

117. Gjithashtu, mungesa e mjeteve financiare e personit të shpallur fajtor nuk është relevante për përcaktimin e lartpërmendur.¹⁷¹ Faktikisht, mungesa e mjeteve financiare e personit të shpallur fajtor në kohën e lëshimit të urdhrit për zhdëmtim nuk është pengesë për përcaktimin e përgjegjësisë për zhdëmtim,¹⁷² e as nuk i jep personit të shpallur fajtor të drejtën për zvogëlim të kësaj përgjegjësie.¹⁷³ Në fakt, urdhri për zhdëmtim mund të zbatohet kundër personit të shpallur fajtor kur monitorimi i gjendjes financiare tregon se personi i ka mjetet për përmbushjen e urdhrit.¹⁷⁴ Megjithëse rrethanat financiare të personit të shpallur fajtor mund të ndikojnë në mënyrën në të cilën vihen në jetë dhe zbatohen zhdëmtimet, zbatimi përmbën aspekt më vete që shkon përtej përcaktimit të përgjegjësisë për zhdëmtime të personit të shpallur fajtor.

IV. PROVAT PARA TRUPIT GJYKUES DHE METODOLOGJIA E TRUPIT GJYKUES PËR VLERËSIMIN E KËRKESËS PËR ZHDËMTIME

118. Gjatë vlerësimit nëse viktimat kanë vërtetuar se ekziston dëmi i pretenduar dhe lidhja shkakësore midis dëmit dhe krimeve për të cilat z. Mustafa është shpallur fajtor,

¹⁷⁰ Ngjashëm, ICC, [Katanga AC Judgment on Reparations Order](#), para. 6, 178.

¹⁷¹ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Judgment on Principles of Reparations](#), para. 70.

¹⁷² Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Judgment on Principles of Reparations](#), para. 103-104; [Katanga AC Judgment on Reparations Order](#), para. 189.

¹⁷³ Ngjashëm, [Katanga AC Judgment on Reparations Order](#), para. 190.

¹⁷⁴ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Judgment on Principles of Reparations](#), para. 104; [Katanga AC Judgment on Reparations Order](#), para. 189.

Trupi Gjykses do të shqyrtojë: (i) Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim në emër të parashtruesve të kërkesave; (ii) vendimet me të cilat parashtruesit u pranuan si viktima pjesëmarrëse;¹⁷⁵ (iii) [REDAKTUAR];¹⁷⁶ (iv) [REDAKTUAR];¹⁷⁷ (v) Deklaratën e Pasojave; (vi) Aktekspertizat e iMMO-së të paraqitura si prova me kërkesë të Trupit Gjykses;¹⁷⁸ dhe (vii) Aktekspertizën *Lerc* të dorëzuar nga Mbrojtësja e Viktimave gjatë procesit gjyqësor.¹⁷⁹

119. Trupi Gjykses dëshiron të theksojë se konstatimet faktike dhe ligjore të bëra në Aktgjykim të cilat çuan në shpalljen fajtor dhe dënimin e z. Mustafa, janë detyruese për të. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të bazohet në çdo konstatim relevant në Aktgjykim, [REDAKTUAR].

120. Trupi Gjykses nuk do të bazohet në informacion apo material mbështetës që qartësisht nuk është autentik.¹⁸⁰ Në lidhje me aktekspertizat, Trupi Gjykses merr parasysh faktorë si kompetenca e ekspertëve në fushën e tyre të ekspertizës, metodologjitë e përdorura, sa përputhen konstatimet me provat e tjera, dhe mbështetshmërinë e përgjithshme në dëshmitë e ekspertëve.¹⁸¹

¹⁷⁵ [Second Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave); [Third Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave).

¹⁷⁶ [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

¹⁷⁷ *Shih* [REDAKTUAR].

¹⁷⁸ Aktgjykimi, para. 30 që i referohet KSC-BC-2020-05, F00430, Trupi Gjykses I, *Vendim në bazë të Rregullave 132 dhe 149 të Rregullores së Procedurës dhe të Proovave para Dhomave të Specializuara të Kosovës në lidhje me Prova të Kërkuara nga Trupi Gjykses*, 3 qershor 2022, konfidencial, para. 8-9, 13(a). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00430/RED](#). Mbrojtja nuk kundërshtoi kualifikimet e ekspertëve apo Aktekspertizat e iMMO-së.

¹⁷⁹ Mbrojtja nuk kundërshtoi kualifikimet e ekspertit apo Aktekspertizën *Lerc*.

¹⁸⁰ *Ngjashëm*, [Third Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 14 dhe referencat aty.

¹⁸¹ Aktgjykimi, para. 41.

121. Vlerësimi prej Trupit Gjykses i kërkesës për zhdëmtim sipas këtyre kritereve kryhet duke u bazuar në tërësinë e gjasave, duke pasur parasysh koherencën e brendshme të kërkesës në tërësi, përfshirë dokumentacionin mbështetës, konstatimet relevante në Aktgjykim dhe të gjitha rrethanat përkatëse.¹⁸²

122. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses do të marrë parasysh çdo vështirësi me të cilën mund të jenë ballafaquar viktimat gjatë mbledhjes dhe dorëzimit të informacionit – si të të dhënave mjekësore, financiare dhe të punësimit – ndër të tjera edhe për shkak të kalimit të kohës që nga kryerja e krimeve.¹⁸³ Trupi Gjykses gjithashtu do të marrë parasysh faktin që viktimat mund të mos u kenë treguar të tjerëve çfarë përjetuan në kompleksin e ndalimit në Zllash, ndër të tjera edhe për shkak të atmosferës së frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër personave që japin dëshmi në hetimet ose ndjekjet penale të krimeve që pretendohet se janë kryer nga anëtarë të UÇK-së.¹⁸⁴ Në mungesë të dokumentacionit, rrëfimi koherent dhe i besueshëm i viktimës mund të pranohet si provë e mjaftueshme në mbështetje të kërkesës për zhdëmtim, në bazë të tërësisë së gjasave.¹⁸⁵

123. Gjithashtu, kur ta gjykojë të përshtatshme, Trupi Gjykses do të mbështetet në prezumime, kur viktima të ketë provuar, në bazë të tërësisë së gjasave, se është

¹⁸² Ngjashëm, [Third Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 14 dhe referencat.

¹⁸³ Shih para. 100 më lart. Ngjashëm, ICC, [Katanga TC Reparations Order](#), para. 60; [Lubanga TC Decision setting Liability](#), para. 61.

¹⁸⁴ Shih Aktgjykimin, para. 50-57 dhe referencat aty.

¹⁸⁵ Ngjashëm, Aktgjykimi, para. 43 (“Në përputhje me rregullën 139(3) të Rregullores, Trupi Gjykses ka kompetencë diskreionale të vlerësojë nëse një provë e vetme, apo disa prova të marra së bashku, mjaftojnë për vërtetimin e një fakti specifik”). Ngjashëm, ICC, [Ntaganda TC Reparations Order](#), para. 139.

viktimë e krimeve për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor, ose do të mbështetet në provat rrethanore.¹⁸⁶

124. Së fundi, Trupi Gjykues vë në dukje se, ndonëse iu dha mundësia gjatë gjithë procesit, Mbrojtja nuk bëri asnjë parashtrim në lidhje me komentet dhe parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave për zhdëmtimet, Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, apo Aktekspertizën *Lerc* dhe Aktekspertizat e iMMO-së.¹⁸⁷ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues vë në dukje se qëndrimi i vazhdueshëm i Mbrojtjes në këtë çështje gjyqësore ka qenë se, për shkak të mohimit të çfarëdo krimi nga z. Mustafa, ai nuk ka detyrim t'i zhdëmtojë viktimat.¹⁸⁸

V. SHKALLA DHE MASA E DËMIT

A. PARASHTRIMET

125. Mbrojtësja e Viktimave parashtrroi kërkesë për zhdëmtim në emër të tetë (8) viktimave pjesëmarrëse (së bashku, "viktimat").¹⁸⁹

126. Mbrojtësja e Viktimave parashtron se V08/05, V09/05 dhe V10/05 (së bashku, "viktimat e drejtpërdrejta") pësuan dëme fizike, mendore dhe materiale si pasojë e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës të kryera nga z. Mustafa kundër

¹⁸⁶ *Shih* para. 103 më lart.

¹⁸⁷ Mbrojtja dorëzoi parashtrime në lidhje me Aktekspertizat vetëm lidhur me argumentin nëse, në rast të një vendimi fajësie, do të ishte e përshtatshme që viktimat të referohen te gjykatat e Kosovës për padi civile në përputhje me nenin (9) të Ligjit dhe rregullën 167 të Rregullores (*shih* para. 21 më lart).

¹⁸⁸ [T. 15 September 2022](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2022), publik, f. 4856, rreshtat 11-19.

¹⁸⁹ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 8, 49.

tyre.¹⁹⁰ Gjithashtu, Mbrojtësja e Viktimave parashtron se, në lidhje me viktimat e drejtpërdrejta, duhet të merret parasysh edhe dëmi që u është shkaktuar planeve ose projekteve të tyre për jetën, duke qenë se të gjithë përjetuan dëme që u kanë ndryshuar jetën.¹⁹¹

127. Mbrojtësja e Viktimave më tej argumenton se V05/05, V06/05, V11/05, V12/05 dhe V13/05 (së bashku, “viktimat e tërthorta”) kanë pësuar dëm mendor afatgjatë si pasojë e krimeve të luftës të arrestimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme të kryera nga z. Mustafa kundër anëtarit të familjes së tyre, me të cilin të gjithë kishin marrëdhënie të ngushtë.¹⁹²

128. Mbrojtja nuk dorëzoi asnjë parashtrim në përgjigje të Kërkesës së Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim.

129. Në këtë pjesë, Trupi Gjyqës do të analizojë Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim për të përcaktuar shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat.

B. IDENTITETI SI PERSON FIZIK

130. Trupi Gjyqës vë në dukje se viktimat u pranuan në procesin gjyqësor si viktima pjesëmarrëse dhe, në këtë kontekst, dorëzuan dokumentacion zyrtar mbështetës

¹⁹⁰ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 9, 36-48; Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR]; [Victims' Counsel Further Information on Reparations](#) (Informacioni i Mëtejshëm i Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 2-6.

¹⁹¹ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 13, 58. Në lidhje me pasojat e krimeve për jetën e viktimave të drejtpërdrejta, *shih gjithashtu* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

¹⁹² [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 49-50, 55, 57; Deklarata e Pasojave, - [REDAKTUAR]; [Victims' Counsel Further Information on Reparations](#) (Informacioni i Mëtejshëm i Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 3.

lidhur me identitetin e tyre si persona fizikë.¹⁹³ Pas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës, të paraqitur në kërkesën për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces, sipas standardit të kërkuar në këtë fazë të procesit, Trupi Gjykses konstaton se çdo viktimë ka vërtetuar në bazë të tërësisë së gjasave se është person fizik.¹⁹⁴

C. DËMI I PËSUAR NGA VIKTIMAT

1. Dëmi i pësuar nga viktimat e drejtpërdrejta

a) V09/05

131. Së pari, Trupi Gjykses bazohet në konstatimet e bëra në Aktgjykim, sipas të cilave është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se V09/05 u mbajt i ndaluar arbitrarisht dhe u torturua në kompleksin e ndalimit në Zllash nga z. Mustafa dhe vartësit e tij në BIA dhe si pasojë pësoi dëm fizik dhe mendor.¹⁹⁵ Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se [REDAKTUAR].¹⁹⁶

¹⁹³ [Second Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 26, 29, 39 (për V05/05-ën, V06/05-ën, V08/05-ën, dhe V09/05-ën); [Third Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave) para. 12, 15, 26 (për V10/05-ën, V11/05-ën, V12/05-ën, dhe V13/05-ën).

¹⁹⁴ Trupi Gjykses vë në dukje se kjo u vendos që në Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Second Victims Participation Decision](#)) dhe Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Third Victims Participation Decision](#)), edhe pse bazuar në një standard më pak rigoroz. ([Second Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 26; [Third Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 12. Trupi Gjykses rikujton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykses, sipas rastit, vlerëson *prima facie* informacionin dhe materialin mbështetës të dorëzuar nga persona që synojnë të marrin pjesë në proces (*shih* rregullën 113(4)), që do të thotë “në shikim të parë; në dukje; siç duket në shikim të parë pa hetime” ([Victims’ Participation Framework Decision](#) (Vendimi Kornizë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 28 dhe poshtëshënimi 14).

¹⁹⁵ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

¹⁹⁶ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

132. Për dëmin fizik dhe mendor, Trupi Gjykues mbështetet në konstatimet e bëra në Aktgjykim, [REDAKTUAR],¹⁹⁷ dokumentacionin mbështetës të dorëzuar, dhe përfundimet e Aktekspertizës së iMMO-së për V09/05-ën.

133. **Dëmi fizik.** [REDAKTUAR], V09/05 u shkelmua, u grushtua, u godit [REDAKTUAR] deri sa humbi vetëdijen.¹⁹⁸ Ai u mbajt në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese,¹⁹⁹ në një vend të izoluar.²⁰⁰ Ai u keqtrajtua pothuaj çdo ditë gjatë tërë kohës sa ishte i ndaluar:²⁰¹ u godit [REDAKTUAR]; u dogj me hekur të nxehtë [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR].²⁰²

134. Si pasojë e mbajtjes si i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, V09/05 pësoi lëndime të shumta [REDAKTUAR], djegie, prerje [REDAKTUAR].²⁰³ Ai pësoi infektim [REDAKTUAR].²⁰⁴ Edhe tani, ai vuan nga dhimbje koke dhe dhimbje [REDAKTUAR], [REDAKTUAR]²⁰⁵ [REDAKTUAR]²⁰⁶ [REDAKTUAR] si rezultat i keqtrajtimit që kishte përjetuar.²⁰⁷ [REDAKTUAR].²⁰⁸ [REDAKTUAR].²⁰⁹

¹⁹⁷ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR].

¹⁹⁸ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

¹⁹⁹ Aktgjykimi, para. 501-525. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁰⁰ Aktgjykimi, para. 810-811.

²⁰¹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁰² Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁰³ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁰⁴ [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁰⁵ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁰⁶ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁰⁷ [REDAKTUAR]; Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁰⁸ Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, f. 12, 22-25.

²⁰⁹ [REDAKTUAR].

135. **Dëmi mendor.** [REDAKTUAR].²¹⁰ V09/05 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë,²¹¹ nuk e dinte se sa do të zgjaste ndalimi, dhe nuk kishte mundësi të kontaktonte ose të komunikonte me botën e jashtme, përfshirë familjen e tij.²¹²

136. Gjatë mbajtjes si i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, V09/05 dëgjo i keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë dhe pa lëndimet që kishin pësuar, si dhe gjendjen në të cilën ishin kur u sollën në ahur: të mavijosur, të gjakosur, ose pa vetëdije.²¹³ [REDAKTUAR].²¹⁴ Si rezultat, ai nuk mund të flinte dhe gjatë tërë kohës kishte frikë se mund t'i vinte radha për keqtrajtim.²¹⁵ Kjo i shkaktoi tension të tmerrshëm psikologjik.²¹⁶ [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].²¹⁷ [REDAKTUAR].²¹⁸

137. V09/05 vuan nga depresioni, ka vështirësi të flejë dhe përjeton makthe, fanitje të këtyre ngjarjeve dhe kujtime tronditëse të pavullnetshme të torturës.²¹⁹ Këto simptoma të çrregullimit të stresit pastraumatik (makthet dhe kujtimet tronditëse të pavullnetshme) janë pasojë e dhunës që pësoi kur ishte i ndaluar.²²⁰ Atij i kujtohen ngjarjet e pretenduara sa herë dëgjon dikë që bërtet, dhe gjithashtu tmerrohet kur sheh njerëz që u ngjasojnë atyre që e torturuan, ose njerëz me uniforma të zeza. Ai është tërë kohën vigjilent.²²¹ V09/05 ende dëgjon kërcënimet dhe britmat e anëtarëve të BIA-

²¹⁰ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²¹¹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR], 532.

²¹² Aktgjykimi, para. 810.

²¹³ Aktgjykimi, para. 530-531.

²¹⁴ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²¹⁵ Aktgjykimi, para. 530-531.

²¹⁶ Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR]. Aktgjykimi, para. 530.

²¹⁷ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²¹⁸ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²¹⁹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²²⁰ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²²¹ Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR].

s, [REDAKTUAR].²²² [REDAKTUAR],²²³ [REDAKTUAR].²²⁴ [REDAKTUAR].²²⁵ Vuajtjet e pësuar në Zllash patën pasoja edhe në jetën e tij familjare [REDAKTUAR].²²⁶ [REDAKTUAR].²²⁷ Në lidhje me këtë, V09/05 pësoi dëme të planeve për jetën, sepse krimet për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor patën pasoja në zhvillimin e tij personal dhe familjar.

138. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se V09/05 nuk mundi të fliste me asnjë prej viktimave të tjera për mbajtjen e tij në kompleksin e ndalimit në Zllash, sepse ata refuzonin të bisedonin me të për shkak se, sipas tij, kishin frikë. Ai nuk mundi t'i tregonte as mjekut shkakun e vërtetë të lëndimeve të tij.²²⁸ Sipas mendimit të Trupit Gjykues, kjo është pasojë e stigmatizimit shoqëror që – në rastin e viktimave të drejtpërdrejta dhe të ndaluarve të tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash – e kishte zanafillën nga kompleksi i ndalimit në Zllash, kur z. Mustafa dhe vartësit e tij në BIA i etiketuan viktimat e drejtpërdrejta dhe të ndaluarit e tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash si “bashkëpunëtorë” dhe “tradhtarë”. Trupi Gjykues kujton më konkretisht se, kur u mbajtën të ndaluar në mënyrë arbitrare dhe u torturuan në kompleksin e ndalimit në Zllash, viktimat e drejtpërdrejta dhe të ndaluarit e tjerë u akuzuan nga z. Mustafa dhe vartësit e tij në BIA se ishin spiunë, tradhtarë, hajdutë dhe gënjeshtarë,

²²² Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR].

²²³ [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²²⁴ [REDAKTUAR]. Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²²⁵ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²²⁶ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²²⁷ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²²⁸ *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

ose se bashkëpunonin me serbët.²²⁹ Trupi Gjykses gjithashtu kujton se tortura e ushtruar ndaj tyre ishte e motivuar politikisht.²³⁰ [REDAKTUAR].²³¹ [REDAKTUAR].²³²

139. Për sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se në rastin konkret të V09/05-ës, duke e ndaluar në mënyrë arbitrare dhe duke e etiketuar si “bashkëpunëtor”, z. Mustafa, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët me anëtarë të tjerë të BIA-s, e veçoi atë nga komuniteti dhe në këtë mënyrë kontribuoi në ndjenjën e izolimit, stigmatizimin shoqëror, dhe ndjenjën e pasigurisë që ai përjeton edhe sot, si rezultat i të cilave nuk pati mundësi që ta trajtonte traumën, ose të mësonte aftësi më të mira për t’i përballuar situatat²³³ ose që vuajtja e tij të pranohet nga rrethi ku jeton.

140. **Dëmi material.** Mbrojtësja e Viktimave argumenton se V09/05 pësoi dëm të planeve për jetën²³⁴ për shkak se përjetimet në kompleksin e ndalimit në Zllash ia kanë ndryshuar krejtësisht jetën dhe, në masë të madhe, kanë shkatërruar çdo perspektivë pozitive në jetën e tij.²³⁵ Ajo parashtron se, po të mos kishin ndodhur krimet, “ekziston pritshmëri e mirëbazuar se [V09/05] do të kishte qenë i aftë për një karrierë normale”.²³⁶ [REDAKTUAR] pas lirimit nga kompleksi i ndalimit në Zllash, edhe pse

²²⁹ Aktgjykimi, para. 579 [REDAKTUAR].

²³⁰ Aktgjykimi, para. 580 [REDAKTUAR].

²³¹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²³² Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR].

²³³ *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²³⁴ *Shih* Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim ([Victims' Counsel Reparations Request](#)), para. 13, [REDAKTUAR] dhe 58.

²³⁵ *Shih* Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, [REDAKTUAR].

²³⁶ Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

shëndeti filloi t'i përmirësohej, dhimbja dhe ankthi që përjetonte ia bënë të vështirë funksionimin [REDAKTUAR].²³⁷

141. Trupi Gjykes gjykon se trauma e rëndë psikologjike, ankthi dhe dhimbjet, si ato që vuajti V09/05, jo vetëm që mund të rezultojnë në sëmundje fizike dhe mendore, por edhe mund të kenë/kanë pasoja në aftësinë e personit që të funksionojë në shoqëri. Për shembull, ato kanë pasoja në aftësinë e viktimës për të gjetur punë dhe për të fituar të ardhura të rregullta. Gjithashtu, ato ndryshojnë planet e personit për jetën, duke ndërprerë zhvillimin personal, familjar dhe profesional.²³⁸

142. Në rastin konkret, Trupi Gjykes është i mendimit se, sikur të mos kishin ndodhur ndalimi arbitrar dhe tortura, [REDAKTUAR], ka shumë të ngjarë që V09/05 do të kishte mundur të bënte "karrierë normale" [REDAKTUAR].²³⁹ Trupi Gjykes gjithashtu është bindur se krimet për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor, megjithëse nuk ishin shkak i vetëm, kontribuan në pamundësinë e V09/05-ës për të bërë karrierë [REDAKTUAR].²⁴⁰

143. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes konstaton se V09/05 pësoi humbje në të ardhura dhe iu dëmtuan planet për jetën, në atë masë që ai u privua nga mundësia për "karrierë normale".

²³⁷ Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* Aktekspertizën e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR].

²³⁸ *Shih* para. 91 më lart. *Ngjashëm*, IACtHR, [Case of Tibi v Ecuador](#), para. 244-246.

²³⁹ *Shih* para. 95 më lart sa i përket shkakësisë faktike.

²⁴⁰ *Shih* para. 96 më lart sa i përket shkakësisë juridike.

144. **Përfundim.** Sipas mendimit të Trupit Gjykses, V09/05 ka vërtetuar, sipas standardit të kërkuar, dëmet e përshkruara më lart si edhe lidhjen shkakësore midis këtyre dëmeve dhe krimeve për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

145. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se V09/05 përjetoi dëme fizike dhe mendore me pasoja afatgjata, si dhe dëm material, si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

b) V08/05

146. Fillimisht, Trupi Gjykses bazohet në konstatimet e bëra në Aktgjykim, sipas të cilave është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se V08/05 u ndalua në mënyrë arbitrare dhe u torturua në kompleksin e ndalimit në Zllash nga z. Mustafa dhe anëtarë të tjerë të BIA-së dhe përjetoi dëme fizike dhe mendore si pasojë e tyre.²⁴¹ Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se [REDAKTUAR].²⁴²

147. Për dëmin fizik dhe mendor, Trupi Gjykses bazohet në konstatimet e bëra në Aktgjykim, [REDAKTUAR],²⁴³ dokumentacionin mbështetës të dorëzuar, dhe përfundimet e Aktekspertizës së iMMO-së për V08/05-ën.

148. **Dëmi fizik.** V08/05 u mbajt në kompleksin e ndalimit në Zllash në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese.²⁴⁴ [REDAKTUAR], ai u mor në pyetje nga dy ushtarë të BIA-s. Më tej, [REDAKTUAR] V08/05-ën [REDAKTUAR] e goditën [REDAKTUAR] duke i shkaktuar dhimbje dhe mavijosje [REDAKTUAR].²⁴⁵ Pas lirimit,

²⁴¹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁴² Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁴³ Aktgjykimi, para. 84; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR].

²⁴⁴ Aktgjykimi, para. 501-525.

²⁴⁵ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR], V08/05 i pa mavijosjet [REDAKTUAR].²⁴⁶ Ai nuk kërkoi ndihmë mjekësore.²⁴⁷

149. V08/05 [REDAKTUAR] nuk ka simptoma fizike apo blana nga keqtrajtimi që kishte përjetuar gjatë mbajtjes në ndalim.²⁴⁸

150. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se V08/05 pësoi dëm fizik, por jo me pasoja afatgjata.

151. **Dëmi mendor.** V08/05 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë,²⁴⁹ nuk e dinte se sa do të zgjaste ndalimi, dhe nuk kishte mundësi të kontaktonte ose të komunikonte me botën e jashtme, përfshirë familjen e tij.²⁵⁰

152. Sikurse V09/05, edhe V08/05 ishte dëshmitar i keqtrajtimit brutal që pësuan të ndaluarit e tjerë. [REDAKTUAR].²⁵¹ V08/05 e ka këtë frikë edhe sot.²⁵² Ai kishte të vështirë të flinte [REDAKTUAR].²⁵³ Frika e vazhdueshme iu shtua edhe më shumë nga fakti që nuk ishte informuar për arsyet e heqjes së lirisë: [REDAKTUAR].²⁵⁴

153. V08/05 ka simptoma të çrregullimit të stresit pastraumatik si, fanitje [REDAKTUAR] makthe [REDAKTUAR], si dhe ikja prej njerëzve të tjerë dhe

²⁴⁶ [REDAKTUAR].

²⁴⁷ [REDAKTUAR].

²⁴⁸ *Shih* Aktekspertizën e iMMO-së për V08/05-ën, [REDAKTUAR]; *shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

²⁴⁹ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR], 532.

²⁵⁰ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR], 810.

²⁵¹ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR] 530-531. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁵² [REDAKTUAR].

²⁵³ Aktekspertiza e iMMO-së për V09/05-ën, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁵⁴ [REDAKTUAR]. Aktgjykimi, para. 532. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

mosbesimi ndaj tyre.²⁵⁵ V08/05 ende bëhet nervoz, lodhet, dhe moliset si pasojë e mbajtjes në kompleksin e ndalimit në Zllash.²⁵⁶ Simptomat e çrregullimit të stresit pastraumatik filluan pas lirimimit nga kompleksi i ndalimit në Zllash. Aktualisht, V08/05 nuk vuan më nga makthet.²⁵⁷

154. V08/05 gjithashtu përjetoi çrregullime në marrëdhëniet personale dhe jetën familjare: [REDAKTUAR].²⁵⁸ Sikurse V09/05, edhe V08/05-ës iu dëmtuan planet për jetën, meqenëse krimet për të cilat u z. Mustafa u shpall fajtor patën pasoja në zhvillimin e tij personal dhe familjar.

155. Gjithashtu, Trupi Gjykes vëren se, ashtu si të ndaluarit e tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash,²⁵⁹ V08/05 u akuzua si spiun, gënjeshtar dhe se bashkëpunonte me serbët.²⁶⁰ [REDAKTUAR].²⁶¹ [REDAKTUAR].²⁶² Trupi Gjykes është i mendimit se, duke e ndaluar në mënyrë arbitrare dhe duke e etiketuar V08/05-ën “bashkëpunëtor”, z. Mustafa, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët me anëtarë të tjerë të BIA-s, e veçoi atë nga komuniteti dhe, në këtë mënyrë, kontribuoi në ndjenjën e pasigurisë të V08/05-ës, që vazhdon edhe sot, dhe, veçanërisht frikën për të folur hapur për çfarë i ndodhi në kompleksin e ndalimit në Zllash apo për të kërkuar përgjegjësit për ato

²⁵⁵ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR]. Aktekspertiza e iMMO-së për V08/05-ën, [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* Aktekspertizën e iMMO-së për V08/05-ën [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

²⁵⁶ Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

²⁵⁷ Aktekspertiza e iMMO-së për V08/05-ën, [REDAKTUAR].

²⁵⁸ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR] 801. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁵⁹ *Shih* para. 138 më lart.

²⁶⁰ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁶¹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁶² Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

ngjarje.²⁶³ Gjithashtu, V08/05-ës asnjëherë nuk iu dha mundësia të trajtonte traumën e shkaktuar nga koha kur ishte në kompleksin e ndalimit në Zllash.

156. **Dëmi material.** Megjithëse V08/05 mundi të gjente punë [REDAKTUAR],²⁶⁴ Trupi Gjykses gjykon se, sikur të mos ishte ndaluar dhe torturuar në kompleksin e ndalimit në Zllash, dhe duke marrë parasysh traumën e rëndë mendore që iu shkaktua V08/05-ës si pasojë²⁶⁵ [REDAKTUAR],²⁶⁶ ai do të kishte mundur të zhvillonte karrierën e vet dhe të arrinte pozitë më të lartë për arsye se do të kishte kryer punë më të mirë se sa ka mundur të kryejë si pasojë e krimeve.²⁶⁷ Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se krimet për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor, megjithëse nuk ishin shkaku i vetëm, kontribuan në zhvillimin e kufizuar profesional të V08/05-ës, apo mungesën e këtij zhvillimi.²⁶⁸ Rrjedhimisht, siç argumentohet nga Mbrojtësja e Viktimave,²⁶⁹ Trupi Gjykses konstaton se, në kuptimin e dëmit material, V08/05 ka pësuar humbje në të ardhura si dhe i janë dëmtuar planet për jetën, duke qenë se iu pengua aftësia për të zhvilluar karrierën.

157. **Përfundim.** Sipas mendimit të Trupit Gjykses, V08/05 ka vërtetuar, sipas standardit të kërkuar, dëmet e përshkruara më lart si edhe lidhjen shkakësore midis këtyre dëmeve dhe krimeve për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

²⁶³ [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* Deklaratën e Psojave, [REDAKTUAR].

²⁶⁴ Kërkesa e Mbrojtësës së Viktimave për Zhdëmtim, [REDAKTUAR].

²⁶⁵ *Shih gjithashtu* para. 141 më lart.

²⁶⁶ *Shih* Deklaratën e Psojave, [REDAKTUAR]; Aktekspertiza e iMMO-së për V08/05-ën, [REDAKTUAR].

²⁶⁷ *Shih* Kërkesën e Mbrojtësës së Viktimave për Zhdëmtim, [REDAKTUAR]; Aktekspertiza *Lerc*, [REDAKTUAR]. *Shih* para. 95 më lart sa i përket shkakësisë faktike.

²⁶⁸ *Shih* Kërkesën e Mbrojtësës së Viktimave për Zhdëmtim, [REDAKTUAR]. *Shih* para. 96 më lart sa i përket shkakësisë juridike.

²⁶⁹ *Shih* para. 126 më lart.

158. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se V08/05 përjetoi: dëm fizik pa pasoja afatgjata, dëm mendor me pasoja afatgjata, dhe dëm material, si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

c)V10/05

159. Fillimisht, Trupi Gjykses bazohet në konstatimet e bëra në Aktgjykim, sipas të cilave është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se V10/05 u mbajt i ndaluar arbitrarisht dhe u torturua në kompleksin e ndalimit në Zllash nga z. Mustafa dhe vartësit e tij në BIA dhe si pasojë pësoi dëm fizik dhe mendor.²⁷⁰ Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se [REDAKTUAR].²⁷¹

160. Për dëmin fizik dhe mendor, Trupi Gjykses bazohet në konstatimet e bëra në Aktgjykim, [REDAKTUAR],²⁷² dhe dokumentacionin mbështetës të dorëzuar. Trupi Gjykses vë në dukje se [REDAKTUAR] V10/05-ës, ekzaminimi mjekësor [REDAKTUAR] nuk qe e mundur [REDAKTUAR].²⁷³ Trupi Gjykses merr parasysh gjithashtu parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave për vështirësitë e hasura prej saj në marrjen e të dhënave mjekësore.²⁷⁴ Në veçanti, ajo parashtrroi [REDAKTUAR].²⁷⁵

²⁷⁰ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁷¹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁷² Aktgjykimi, [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR].

²⁷³ [REDAKTUAR]; [Victims' Counsel 28 April 2022 Report](#) (Raporti i Mbrojtëses së Viktimave i 28 Prillit 2022), para. 11; dhe [Decision of 6 May 2022](#) (Vendimi i 6 Majit 2022), para. 11.

²⁷⁴ [Victims' Counsel Second Submissions on Reparations](#) (Parashtrimet e Dyta të Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 12. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

²⁷⁵ [Victims' Counsel Second Submissions on Reparations](#) (Parashtrimet e Dyta të Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 12.

161. **Dëmi fizik.** [REDAKTUAR], V10/05 [REDAKTUAR] u rrah nga disa anëtarë të BIA-s [REDAKTUAR].²⁷⁶ Atë e goditën me shkelma dhe [REDAKTUAR].²⁷⁷ Sikurse të ndaluarit e tjerë, edhe V10/05 u mbajt në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese.²⁷⁸ [REDAKTUAR].²⁷⁹ [REDAKTUAR].²⁸⁰ [REDAKTUAR].²⁸¹ [REDAKTUAR].²⁸²
162. V10/05-ës iu shkaktua [REDAKTUAR].²⁸³ [REDAKTUAR].²⁸⁴ [REDAKTUAR] sot e kësaj dite nuk është shëruar tërësisht [REDAKTUAR],²⁸⁵ [REDAKTUAR].²⁸⁶ [REDAKTUAR].²⁸⁷
163. **Dëmi mendor.** Sikurse të ndaluarit e tjerë, edhe V10/05 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë,²⁸⁸ nuk e dinte sa do të zgjaste ndalimi, dhe nuk kishte mundësi të kontaktonte ose të komunikonte me botën e jashtme, përfshirë familjen e tij.²⁸⁹
164. Gjatë kohës që ishte i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, V10/05 ishte objekt i [REDAKTUAR].²⁹⁰ [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].²⁹¹ [REDAKTUAR].²⁹²

²⁷⁶ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁷⁷ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁷⁸ *Shih* Aktgjykimin, para. 501-525. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁷⁹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁸⁰ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁸¹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁸² Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁸³ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁸⁴ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁸⁵ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁸⁶ Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁸⁷ Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁸⁸ Aktgjykimi, [REDAKTUAR], 532.

²⁸⁹ Aktgjykimi, para. [REDAKTUAR], 810.

²⁹⁰ Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁹¹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁹² Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

Gjatë tërë kohës që ishte i ndaluar, V10/05 [REDAKTUAR].²⁹³ Sikurse të ndaluarit e tjerë, ai nuk mund të flinte, sepse ishte i tmerruar nga britmat e të tjerëve që po i rrihnin, dhe për shkak të frikës së vazhdueshme se mund t'i vinte radha për keqtrajtim.²⁹⁴ [REDAKTUAR].²⁹⁵

165. V10/05 ka probleme me gjumin dhe ka makthe.²⁹⁶ Keqtrajtimi i përjetuar në kompleksin e ndalimit në Zllash [REDAKTUAR].²⁹⁷

166. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se, pas krimeve, V10/05 e kishte të vështirë t'u tregonte mjekëve shkakun e vërtetë të lëndimeve.²⁹⁸ Ashtu si në rastin e V09/05-ës, sipas mendimit të Trupit Gjykues, kjo tregon stigmatizimin shoqëror që i ka rrënjët në mënyrën se si z. Mustafa dhe vartësit e tij në BIA i trajtuan viktimat e drejtpërdrejta dhe të ndaluarit e tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash. [REDAKTUAR], ai u akuzua për bashkëpunim me serbët dhe se ishte spiun.²⁹⁹ Trupi Gjykues gjykon se, duke e ndaluar në mënyrë arbitrare dhe duke e etiketuar V10/05-ën si "bashkëpunëtor" gjatë kohës së ndalimit të tij në Zllash, z. Mustafa, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët me anëtarë të tjerë të BIA-s, e veçoi atë nga komuniteti i tij dhe me këtë kontribuoi në pamundësinë e V10/05-ës që të kërkonte ndihmë haptas për t'u trajtuar për traumën që iu shkaktua kur ishte i ndaluar në

²⁹³ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁹⁴ Aktgjykimi, para. 530. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁹⁵ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁹⁶ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

²⁹⁷ Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR].

²⁹⁸ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

²⁹⁹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

kompleksin e ndalimit në Zllash, që t'u tregonte të tjerëve se çfarë i kishte ndodhur në kompleksin e ndalimit në Zllash, ose që t'i njihej kjo vuajtje.

167. **Dëmi material.** V10/05 nuk mundi të kthehej në profesionin e mëparshëm³⁰⁰ për shkak të lëndimeve që pësoi gjatë mbajtjes në kompleksin e ndalimit në Zllash [REDAKTUAR].³⁰¹ [REDAKTUAR].³⁰² [REDAKTUAR].³⁰³

168. Trupi Gjykses konstaton se po të mos kishte ndodhur ndalimi arbitrar dhe tortura, dhe, si rezultat, po të mos kishte pësuar lëndimet fizike dhe mendore të përshkruara më lart,³⁰⁴ ka shumë të ngjarë që V10/05 do të kishte mundur të kthehej në profesionin e tij të mëparshëm [REDAKTUAR].³⁰⁵ Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se krimet për të cilat u shpall fajtor z. Mustafa, kontribuan në [REDAKTUAR] e V10/05-ës [REDAKTUAR].³⁰⁶

169. Rrjedhimisht, siç argumenton Mbrojtësja e Viktimave,³⁰⁷ Trupi Gjykses konstaton se, sa i përket dëmit material, V10/05 pësoi humbje të ardhurash dhe dëmtim të planeve për jetën, duke qenë se nuk mund të bëjë më [REDAKTUAR], siç kishte punuar më parë, [REDAKTUAR].

170. **Përfundim.** Sipas mendimit të Trupit Gjykses, V10/05 ka vërtetuar, në bazë të standardit të kërkuar, dëmet e përshkruara më lart si edhe lidhjen shkakësore midis këtyre dëmeve dhe krimeve për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

³⁰⁰ [REDAKTUAR].

³⁰¹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

³⁰² *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR].

³⁰³ *Shih* Deklaratën e Pasojave, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

³⁰⁴ *Shih gjithashtu* para. 141 më lart.

³⁰⁵ *Shih* para. 95 më lart sa i përket shkakësisë faktike.

³⁰⁶ *Shih* para. 96 më lart sa i përket shkakësisë juridike.

³⁰⁷ *Shih* para. 126 më lart.

171. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se V10/05 pësoi dëme fizike dhe mendore me pasoja afatgjata, dhe dëm material, si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

2. Dëmi i pësuar nga viktimat e tërthorta

172. Fillimisht, Trupi Gjykses u referohet fakteve lidhur me vrasjen e [REDAKTUAR], siç janë artikuluar në Aktgjykim, që vërtetojnë se ai u mbajt i ndaluar në mënyrë arbitrar dhe u torturua në kompleksin e ndalimit në Zllash, dhe më pas u vra si rezultat i kombinimit të keqtrajtimit të rëndë të shkaktuar nga vartësit e z. Mustafa në BIA të cilët e mbajtën të ndaluar për gati tri javë, duke i shkaktuar dëmtime të rënda fizike; refuzimit të ndihmës mjekësore nga ana e vartësve të z. Mustafa në BIA, dhe plagëve me armë zjarri të shkaktuara nga plumbat.³⁰⁸

173. Trupi Gjykses më tej i referohet [REDAKTUAR] në Aktgjykim. Trupi Gjykses i vlerësoi [REDAKTUAR].³⁰⁹

174. Trupi Gjykses rikujton se anëtarët e familjes së ngushtë (bashkëshortja, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat) prezumohen se kanë marrëdhënie të ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë, por edhe anëtarë të tjerë të familjes (ose persona që nuk janë anëtarë të familjes) që kanë marrëdhënie veçanërisht të afërt ose lidhje vartësie me viktimën e drejtpërdrejtë gjithashtu mund të konsiderohen se kanë marrëdhënie të ngushtë me të.³¹⁰ Për më tepër, sa i përket dëmit mendor, prezumohet edhe vuajtja shpirtërore (si dhimbja, hidhërimi, pikëllimi i thellë, ose shqetësimi) e viktimës së

³⁰⁸ Aktgjykimi, para. 639, 689-695, 758-758, 831.

³⁰⁹ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

³¹⁰ *Shih* Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Third Victims Participation Decision](#)), para. 18 dhe referencat aty.

tërthortë si rezultat i vdekjes ose lëndimit të rëndë të viktimës së drejtpërdrejtë, me kusht që të vërtetohet mjaftueshëm marrëdhënia e ngushtë midis tyre.³¹¹

175. Viktimat e tërthorta kanë paraqitur material që vërteton lidhjen familjare me viktimën e vrasjes së paligjshme.³¹² [REDAKTUAR].³¹³ [REDAKTUAR]³¹⁴ [REDAKTUAR],³¹⁵ [REDAKTUAR].

176. V06/05 [REDAKTUAR], V11/05 [REDAKTUAR], V12/05 ([REDAKTUAR]³¹⁶ – [REDAKTUAR]V05/05 [REDAKTUAR]³¹⁷ – [REDAKTUAR] arrestimi, ndalimi arbitrar i viktimës së vrasjes së paligjshme, dhe më vonë vrasja e tij dhe rrethanat e saj, patën pasoja shumë të rënda për tërë familjen,³¹⁸ [REDAKTUAR]³¹⁹

[REDAKTUAR]³²⁰

³¹¹ *Shih* Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Third Victims Participation Decision](#)), para. 21 dhe referencat aty.

³¹² *Shih* Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Second Victims Participation Decision](#)), para. 26; [Third Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 12. Trupi Gjykes vë në dukje se përcaktimi i lidhjes familjare u bë që në Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Second Victims Participation Decision](#)) dhe në Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Third Victims Participation Decision](#)), edhe pse bazuar në një standard më pak rigoroz (*Shih* rregullën 113(4) të Rregullores; [Third Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 12).

³¹³ *Shih* [REDAKTUAR].

³¹⁴ [REDAKTUAR].

³¹⁵ [REDAKTUAR].

³¹⁶ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

³¹⁷ [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

³¹⁸ *Shih* [REDAKTUAR].

³¹⁹ [REDAKTUAR].

³²⁰ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

177. [REDAKTUAR] pati pasoja të forta për V06/05-ën dhe e ndryshoi atë.³²¹ V06/05 vuan nga dhimbje koke, nga ankthi dhe stresi,³²² [REDAKTUAR].³²³

[REDAKTUAR].³²⁴

178. Siç përshkruhet më poshtë,³²⁵ disa nga viktimat e tërthorta [REDAKTUAR]. Ata përshkruan pikëllimin, dëshpërimin dhe tmerrin që ndjenë në atë moment dhe se si dhimbja dhe vuajtja i kanë shoqëruar tërë jetën.

179. V11/05 dëshmoi se [REDAKTUAR].³²⁶ Që nga ajo kohë, ai ka makthe dhe vuan nga pagjumësia,³²⁷ [REDAKTUAR]³²⁸ [REDAKTUAR].³²⁹ Vdekja e viktimës së vrasjes së paligjshme ka pasur pasoja të vazhdueshme në jetën e tij.³³⁰

180. Jeta e V12/05-ës, [REDAKTUAR],³³¹ ndryshoi tërësisht si pasojë e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR]; ai u ndikua thellësisht prej saj. ³³² V12/05 ka

³²¹ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³²² [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³²³ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³²⁴ [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

³²⁵ *Shih* para. 179-181 më poshtë.

³²⁶ [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³²⁷ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³²⁸ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³²⁹ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³³⁰ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³³¹ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³³² [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR],³³³ ka probleme me gjumin,³³⁴ [REDAKTUAR]³³⁵ dhe ndjehet i molisur tërë kohën.³³⁶

181. V13/05 e përshkroi [REDAKTUAR]³³⁷ si ditë shumë të rëndë për të.³³⁸ Sa i përket ndikimit të vrasjes së paligjshme të [REDAKTUAR], V13/05 u shpreh se çdo humbje është e dhimbshme dhe lë pas një boshllëk të jashtëzakonshëm.³³⁹

182. Trupi Gjykues konstaton se faktet e përshkruara më poshtë duhet të konsiderohen gjithashtu pjesë e dëmit mendor të pësuar nga viktimat e tërthorta dhe dëshmi e vuajtjeve të tyre që nga momenti kur ua morën të afërmin.

183. Pas heqjes së lirisë të viktimës së vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR].³⁴⁰ Sikurse u shpreh me të drejtë Mbrojtësja e Viktimave, “ndjenjat e pikëllimit dhe tmerrit u paraprinë nga frika dhe ankthi për zhdukjen [e viktimës së vrasjes së paligjshme] dhe mungesa e informacionit dhe hollësive të qarta për vuajtjet dhe fatin e tij”.³⁴¹

184. [REDAKTUAR].³⁴²

³³³ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³³⁴ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³³⁵ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³³⁶ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³³⁷ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³³⁸ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³³⁹ [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³⁴⁰ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

³⁴¹ [Impact Statement](#) (Deklarata e Pasojave), para. 66.

³⁴² [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR]. *Shih* [REDAKTUAR].

185. Për më tepër, viktimat e tërthorta nuk kanë mundur të mbajnë zi për humbjen e të afërmit të tyre [REDAKTUAR] gjë që ua ka bërë vuajtjen edhe më të rëndë³⁴³ dhe i ka penguar të bëjnë jetë normale.³⁴⁴ Për shembull, [REDAKTUAR],³⁴⁵ [REDAKTUAR].³⁴⁶

186. Gjithashtu, Trupi Gjykes vë në dukje se, [REDAKTUAR] përpjekjet [REDAKTUAR] për të kërkuar drejtësi [REDAKTUAR] është dëmtuar rëndë, [REDAKTUAR].³⁴⁷

187. Së fundi, dhimbja dhe vuajtjet e anëtarëve të familjes të viktimës së vrasjes së paligjshme patën pasoja edhe tek brezi i ardhshëm i kësaj familjeje.³⁴⁸

188. **Përfundim.** Trupi Gjykes konstaton se V05/05, V06/05, V11/05, V12/05, dhe V13/05 kanë vërtetuar, bazuar në tërësinë e gjasave, lidhjen e tyre familjare me viktimën e vrasjes së paligjshme. Për më tepër, [REDAKTUAR], V05/05, V06/05, V11/05, V12/05, dhe V13/05 kanë vërtetuar, sipas standardit të kërkuar, dëmin mendor të përshkruar më lart si edhe lidhjen shkakësore midis dëmit në fjalë dhe krimeve për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes nuk e sheh të nevojshme të bazohet në prezumime.

³⁴³ *Shih* [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu*, [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]. Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³⁴⁴ Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³⁴⁵ [REDAKTUAR].

³⁴⁶ [REDAKTUAR].

³⁴⁷ Aktgjykimi, [REDAKTUAR].

³⁴⁸ Aktgjykimi, [REDAKTUAR]. Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR]. *Shih* para. 92 më lart, në lidhje me konceptin e dëmit të shkaktuar disa brezave.

189. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se V05/05, V06/05, V11/05, V12/05 dhe V13/05 pësuan dëm mendor si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor në lidhje me viktimën e vrasjes së paligjshme.

VI. URDHËR PËR ZHDËMTIM KUNDËR Z. MUSTAFA

190. Ky urdhër lëshohet drejtpërdrejt kundër z. Mustafa në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.³⁴⁹

A. PËRFITUESIT E ZHDËMTIMEVE DHE DËMI I PËSUAR

191. Në pjesën pararendëse, Trupi Gjykses përcaktoi shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat në këtë çështje gjyqësore. Siç u konstatua më lart,³⁵⁰ V09/05, V08/05 dhe V10/05 kanë pësuar dëm fizik, mendor dhe material, ndërsa V05/05, V06/05, V11/05, V12/05 dhe V13/05 kanë pësuar dëm mendor, si pasojë e krimeve për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

³⁴⁹ *Shih* para. 113 më lart.

³⁵⁰ *Shih* para. 131 dhe në vijim më lart.

B. LLOJET DHE MODALITETET E ZHDËMTIMEVE

1. Parashtrimet

192. Mbrojtësja e Viktimave parashtron se ndjekja penale dhe dënimi i kryesve të krimeve ndaj viktimave, janë, në vetvete, pjesë e zhdëmtimit.³⁵¹ Ajo parashtron se në kuadër të së drejtës së tyre për zhdëmtim të plotë dhe të efektshëm, viktimat kërkojnë së pari njohjen e vuajtjes së tyre dhe sanksionin e duhur penal në këtë çështje gjyqësore.³⁵² Në lidhje me këtë, ajo argumenton se DHSK-ja është shpresa e fundit që kanë viktimat për vendosjen e drejtësisë për krimet e kryera ndaj tyre.³⁵³

193. Mbrojtësja e Viktimave gjithashtu parashtron se viktimat kërkojnë zhdëmtime individuale në formën e kompensimit pasi “format kolektive dhe [...] të karakterit jomonetar, si ngritja e përmendoreve apo programet edukative” nuk janë të përshtatshme në kontekstin e kësaj çështjeje gjyqësore.³⁵⁴

194. Mbrojtja nuk iu përgjigj parashtrimeve të Mbrojtëses së Viktimave.

³⁵¹ [Victims' Counsel First Submissions on Reparations](#) (Parashtrimet e Para të Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 32.

³⁵² [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 8; [T. 15 September 2022](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2022), publik, f. 4843, rreshtat 8-9.

³⁵³ [T. 15 September 2022](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2022), publik, f. 4843, rreshti 24 deri në f. 4844, rreshti 1.

³⁵⁴ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 8. [T. 15 September 2022](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2022), publik, f. 4844, rreshtat 2-9; [T. 15 September 2021](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2021), f. 370, publik, rreshtat 7-13.

2. Vendimi i Trupit Gjykses

195. Në përputhje me nenin 22(8) të Ligjit, Trupi Gjykses më poshtë do të specifikojë zhdëmtimet përkatëse.³⁵⁵

196. Para kësaj, Trupi Gjykses dëshiron të theksojë se shpallja fajtor dhe dënimi i dhënë në Aktgjykim përbëjnë një lloj mjeti juridik, që në nenin 22(3) të Ligjit përfshihet në kuadër të së drejtës së “pranimi”. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses rikujton se pranimi i shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare është një lloj i rëndësishëm mjeti juridik për viktimat.³⁵⁶

197. Konkretisht në këtë çështje gjyqësore, kjo e drejtë shërben për pranimin dhe përshkrimin me hollësi të krimeve që dëmtuan viktimat dhe për vënien e z. Mustafa para përgjegjësisë për krimet e rënda të kryera dhe dëmet që iu shkaktuan atyre.

198. Gjithashtu, ajo u ofroi mundësi viktimave, [REDAKTUAR] me gjithë atmosferën e frikës dhe frikësimit që mbizotëron në Kosovë, që të dëgjoen dhe të kërkojnë drejtësi dhe zhdëmtim për krimet e kryera më shumë se dy dekada më parë kundër tyre dhe familjarëve të tyre, që nuk janë më me ta.

199. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses rikujton konstatimet e bëra në Aktgjykim lidhur me atmosferën e përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të DHSK-së, familjeve të tyre dhe, më gjerësisht, kundër atyre që japin dëshmi në hetimet ose ndjekjet penale të krimeve që pretendohet se u kryen nga anëtarë të atëhershëm të UÇK-së, ndër të cilët dhe z.

³⁵⁵ *Shih* para. 104 dhe në vijim më lart.

³⁵⁶ *Shih* Vendimin mbi të Drejtat e Viktimave ([Decision on Victims' Rights](#)), para. 16-17.

Mustafa, kundër shqiptarëve kosovarë: dëshmitarët stigmatizohen si “tradhtarë” ose “bashkëpunëtorë”; nuk mund të flasin lirisht për ngjarjet që përjetuan; janë objekt i kërcënimeve dhe frikësimeve; dhe jetojnë me frikën e vazhdueshme se do t’u ndodhë diçka atyre vetë ose familjeve të tyre.³⁵⁷

200. Së fundi, vendimi i fajësisë dhe dënimi i dhënë në Aktgjykim kontribuojnë në realizimin e të drejtave të viktimave dhe më gjerësisht të drejtave të familjarëve dhe komuniteteve të tyre, për të mësuar të vërtetën për atë që ndodhi.³⁵⁸ Në këtë kontekst, viktimat kanë shprehur shpresën se ky proces do të hedhë dritë mbi faktin se krimet u kryen nga të gjitha palët, përfshirë edhe nga disa luftëtarë të UÇK-së, siç ndodhi në këtë rast në Zllash.³⁵⁹

201. Sa u përket zhdëmtimeve të përshtatshme sipas nenit 22(8) të Ligjit, Trupi Gjykses rikujton llojet e dëmeve të pësuar nga viktimat³⁶⁰ dhe kontekstin e çështjes, konkretisht: atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë; nevojën për të ruajtur anonimitetin e viktimave kundrejt publikut; dhe nevojën për të shmangur krijimin e tensioneve brenda komunitetit. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të parashtrimeve të Mbrojtëses së Viktimave,³⁶¹ Trupi Gjykses konstaton se kompensimet individuale janë lloji dhe modaliteti më i përshtatshëm i zhdëmtimit në këtë çështje gjyqësore. Ndonëse “asnjë shumë parash nuk mund të kthejë anëtarin e humbur të familjes [ose] të

³⁵⁷ Aktgjykimi, para. 50-57 dhe referencat aty.

³⁵⁸ [Decision on Victims' Rights](#) (Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave), para. 17. *Shih* Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet ([UN Basic Principles on Reparations](#)), para. 22(b), 24; [T. 15 September 2021](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2021), publik, f. 355, rreshti 13 deri në f. 356, rreshti 2. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para 775, në lidhje me qëllimet e dënimit.

³⁵⁹ [T. 15 September 2021](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2021), publik, f. 350, rreshti 11 deri f. 353, rreshti 10.

³⁶⁰ *Shih* para. 131-189 më lart.

³⁶¹ *Shih* para. 68, 192-193 më lart.

kompensojë për vite të tëra të kaluara në depresion, jetën e privuar nga mundësitë për të punuar si më parë dhe për të pasur një jetë që mundëson gëzim dhe lumturi”,³⁶² kompensimi do të ofrojë njëfarë ndihme financiare për viktimat.

C. SHKALLA E PËRGJEGJËSISË SË Z. MUSTAFA PËR ZHDËMTIMET

1. Parashtrimet

202. Mbrojtësja e Viktimave parashtron se kompensimi duhet të jetë proporcional me shkallën e dëmit të pësuar duke marrë parasysh rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore.³⁶³

Për të bërë vlerësim të drejtë të dëmit të pësuar, ajo sugjeron që metodologjia e Trupit Gjyqësor duhet të përmbajë tre elemente, konkretisht, që ai të orientohet nga jurisprudenca ndërkombëtare, të mbajë parasysh legjislacionin ekzistues të Kosovës, dhe t’i ndërthurë këto me informacionet individuale mbi dëmet e trajtuara në aktekspertizat e iMMO-së, llogaritjet e humbjeve ekonomike sipas Aktekspertizës *Lerc*, [REDAKTUAR].³⁶⁴

203. Ajo gjithashtu parashtron se ndonëse “një dëmshpërblim që pasqyron llogaritjet e bëra në [Aktekspertizën] *Lerc* do të ishte pa precedent në jurisprudencën ndërkombëtare [...], masa e dëmit që i është shkaktuar secilit individ duhet të njihet, pasi çdo individ do t’i duhet të jetojë me pasojat e tij gjithë jetën”.³⁶⁵

³⁶² [T. 15 September 2021](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2021), publik, f. 369, rreshtat 2-5.

³⁶³ [Victims’ Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 9.

³⁶⁴ [Victims’ Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 2, 10, 57.

³⁶⁵ [Victims’ Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 43.

204. Për V08/05-ën, Mbrojtësja e Viktimave kërkon: më së paku 20.000 euro për dëmin material; 4.000 euro për dëmin fizik; dhe 6.000 euro për dëmin mendor; me një shumë të gjithsejtë prej së paku 30.000 euro.³⁶⁶

205. Për V09/05-ën, Mbrojtësja e Viktimave kërkon: më së paku 50.000 euro për dëmin material; 20.000 euro për dëmin fizik; dhe 10.000 euro për dëmin mendor; me një shumë të gjithsejtë prej 80.000 euro.³⁶⁷

206. Për V10/05-ën, Mbrojtësja e Viktimave kërkon: më së paku 30.000 euro për dëmin material; 20.000 euro për dëmin fizik; dhe 10.000 euro për dëmin mendor; me një shumë të gjithsejtë prej së paku 60.000 euro.³⁶⁸

207. Për viktimat e tërthorta, Mbrojtësja e Viktimave sugjeron që vlerësimi i kompensimit financiar të bëhet mbi bazën e provave të ofruara nga viktimat lidhur me pasojat e krimeve, si dhe të standardeve të jurisprudencës ndërkombëtare dhe vendore, të cilat i ka shtjelluar në parashtrimet e saj.³⁶⁹ Ajo kërkon shumat e mëposhtme, të cilat i konsideron të drejta, duke marrë parasysh praktikën ndërkombëtare, pasojat e humbjes së anëtarit të familjes dhe [REDAKTUAR] me

³⁶⁶ [Victims' Counsel Further Information on Reparations](#) (Informacioni i Mëtejshëm i Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 6. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, [REDAKTUAR]; Deklarata e Pasojave, [REDAKTUAR].

³⁶⁷ [Victims' Counsel Further Information on Reparations](#) (Informacioni i Mëtejshëm i Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 6. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, [REDAKTUAR]; Deklarata e Pasojave [REDAKTUAR].

³⁶⁸ [Victims' Counsel Further Information on Reparations](#) (Informacioni i Mëtejshëm i Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 6. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtime, para. 44-48; Deklarata e Pasojave [REDAKTUAR].

³⁶⁹ [Victims' Counsel Second Submissions on Reparations](#) (Parashtrimet e Dyta të Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 17 dhe në vijim; [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 51-56.

personin e ndjerë, të përshkruara nga viktimat në dëshmitë e tyre: 10.000 euro për V05/05-ën, V06/05-ën dhe V12/05-ën, 5.000 euro për V11/05-ën dhe 2.000 euro për V13/05-ën.³⁷⁰

208. Mbrojtja nuk iu përgjigj parashtrimeve të Mbrojtëses së Viktimave, as Aktekspertizës *Lerc*.³⁷¹

2. Vendimi i Trupit Gjykses

a) Aspekte të përgjithshme

209. Fillimisht, Trupi Gjykses vlerëson se z. Mustafa ka detyrimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar të gjitha viktimave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të krimeve për të cilat u shpall fajtor, pavarësisht nga format e ndryshme të përgjegjësisë penale ku u bazua vendimi i fajësisë dhe pavarësisht nëse në shkaktimin e dëmit mund të kenë kontribuar edhe persona të tjerë.³⁷² Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se mungesa e mjeteve financiare të personit të shpallur fajtor në kohën e lëshimit të urdhrin për zhdëmtim nuk është pengesë që ai të ngarkohet me përgjegjësinë e zhdëmtimit dhe as i jep personit të shpallur fajtor të drejtën për zvogëlim të kësaj përgjegjësie.³⁷³

210. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton parimin se përgjegjësia për zhdëmtim nga ana e personit të shpallur fajtor duhet jetë proporcionale me dëmin e shkaktuar.³⁷⁴ Me

³⁷⁰ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 57.

³⁷¹ *Shih* para. 124 më lart.

³⁷² *Shih* para. 116 më lart.

³⁷³ *Shih* para. 117 më lart.

³⁷⁴ *Shih* para. 114 më lart.

fjalë të tjera, ajo duhet të pasqyrojë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat.³⁷⁵ Rrjedhimisht, për përcaktimin e shumës së përgjegjesisë financiare të z. Mustafa, Trupi Gjykses do të marrë parasysh shkallën dhe masën e dëmit të përcaktuar më lart.

211. Duke rikujtuar se procesi i zhdëmtimit në DHSK duhet të përqendrohet tek viktimat dhe interesat e tyre,³⁷⁶ Trupi Gjykses do të mbështetet kryesisht në Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim dhe veçanërisht në parashtrimet e saj lidhur me shumën e përgjegjesisë financiare të z. Mustafa (dhe shumat përkatëse të zhdëmtimeve).

212. Në këtë kontekst, për të vlerësuar shkallën dhe masën e dëmit në terma financiarë, Trupi Gjykses do të marrë parasysh të gjitha parashtrimet dhe materialet relevante të dorëzuara.³⁷⁷ Sidoqoftë, sipas Trupit Gjykses, nuk është kusht që të dorëzohen të dhëna lidhur me shpenzimet për trajtime mjekësore ose dëme të tjera të llojit financiar ose trashëgimor, duke marrë parasysh veçanërisht faktin se kanë kaluar më shumë se njëzet vjet nga kryerja e krimeve dhe se viktimat mund të mos kenë kërkuar trajtim mjekësor për dëmin mendor ose nuk kanë pasur mundësi të tregonin çfarë pësuan për shkak të atmosferës në Kosovë në lidhje me viktimat e krimeve që

³⁷⁵ *Shih* para. 115 më lart.

³⁷⁶ *Shih* para. 68 më lart.

³⁷⁷ Trupi Gjykses thekson se disa dëme fizike, mendore ose materiale mund të vlerësohen në terma financiarë (për shembull, shpenzimet për mjekim, pagat e humbura, shpenzimet për përkujdes në të ardhmen dhe dëmet e shkaktuara në pronë) ndërkohë që disa dëme të tjera nuk mund të përcaktohen qartë në terma monetarë ose nuk mund të llogariten saktë (si p.sh. *pretium doloris*, por edhe dëmi moral, për të cilin, sipas GJPN-së, “për nga vetë natyra e dëmit moral, trajtimi dhe matja e vlerave monetare të tij paraqet vështirësi,” *Shih* ICC, [Al Mahdi TC Reparations Order](#), para. 129).

pretendohet se u kryen nga ish-anëtarë të UÇK-së, ose për shkak të frikës nga hakmarrja.³⁷⁸

213. Gjithashtu, në përcaktimin e shumës së përgjegjësisë financiare të z. Mustafa dhe shumave përkatëse të zhdëmtimit, Trupi Gjykses nuk do të tejkalojë atë që kërkohet në Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme. Kjo rrjedh nga fakti se sipas nenit 22(7) të Ligjit, kompetenca e Trupit Gjykses që, me nismën e vet, të përfshijë në Aktgjykim një vendim lidhur me shkallën dhe masën e dëmit të shkaktuar viktimave kur nuk i është paraqitur një kërkesë e tillë, nënkupton ekzistencën e rrethanave të jashtëzakonshme.³⁷⁹ Sipas Trupit Gjykses, kjo do të thotë se një trup gjykses, para së gjithash, bazohet në parashtrimet e bëra në emër të viktimave dhe kërkesat e përfshira në to, me kusht që ato të jenë faktuar sipas standardit të duhur. Megjithatë, Trupi Gjykses është gjithashtu i mendimit se ai ka njëfarë diskrecioni, duke pasur parasysh parashtrimet e shumta që mund të shqyrtojë në kuadër të marrjes së vendimit mbi zhdëmtimet,³⁸⁰ si edhe duke pasur parasysh se mund të miratojë zhdëmtime për viktimat edhe pa iu paraqitur asnjë parashtrim.³⁸¹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se, në rrethana

³⁷⁸ *Shih* para. 199 më lart.

³⁷⁹ Neni 22(7) i Ligjit përcakton se: “Në aktgjykimin e tij, trupi gjykses mundet që, në bazë të ndonjë kërkesë apo me propozim të vetin në rrethana të jashtëzakonshme, të përfshijë një vendim lidhur me shkallën dhe përmasat e dëmit, humbjes dhe lëndimeve ndaj viktimave, ose në lidhje me to, dhe i deklaron parimet sipas të cilave vepron” [theksimi i shtuar].

³⁸⁰ Neni 22(11) i Ligjit përcakton se: “Para marrjes së vendimit sipas këtij neni, trupi gjykses mund të ftojë dhe merr parasysh përfaqësimet në emër të të akuzuarit, viktimave, personave të tjerë të interesuar, ose shteteve të interesuara” [theksimi i shtuar]. Rregulla 168 e Rregullores përcakton se: [...] trupi gjykses mund të emërojë ekspertë për ta ndihmuar në përcaktimin e masës së dëmit të shkaktuar viktimave, ose në lidhje me viktimat, dhe për sugjerime në lidhje me zhdëmtimin individual ose kolektiv prej personit të shpallur fajtor” [theksimi i shtuar].

³⁸¹ *Shih* nenin 22(7) dhe (8) të Ligjit dhe rregullën 168 të Rregullores.

të jashtëzakonshme, mund të devijojë nga parashtrimet e bëra në emër të viktimave dhe kërkesat e përfshira në to.

214. Si përfundim, duke zbatuar diskrecionin gjyqësor dhe në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit, Trupi Gjyqësor do të përcaktojë shumën për secilin lloj të dëmit – si edhe shumën e përgjithshme të përgjegjësisë financiare të z. Mustafa – që i gjykon të arsyeshme në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore dhe që pasqyrojnë siç duhet të drejtat dhe interesat e viktimave, duke mbajtur parasysh të drejtat e personit të shpallur fajtor.³⁸²

b) Jurisprudenca ndërkombëtare

215. Pasi ka shqyrtuar me kujdes përmbledhjen dhe diskutimin e Mbrojtëses së Viktimave lidhur me jurisprudencën ndërkombëtare,³⁸³ Trupi Gjyqësor vëren shumat mjaft të ndryshme të zhdëmtimit të akorduara, pjesërisht për shkak të konteksteve të ndryshme në të cilat veprojnë GJEDNJ-ja, GJNADNJ-ja dhe GJPN-ja, dhe rrethanave konkrete të atyre çështjeve. Për më tepër, sikurse vuri në dukje me të drejtë Mbrojtësja e Viktimave,³⁸⁴ ndonëse jurisprudenca ndërkombëtare mund të shërbejë si orientim në lidhje me llojet e dëmeve që shqyrtohen, ende nuk është përcaktuar metodologjia për vlerësimin e masës dhe shkallës së këtyre dëmeve. Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor nuk mund të orientohet prej jurisprudencës ndërkombëtare për të përcaktuar kuadrin e përgjegjësisë së z. Mustafa për zhdëmtimet.

³⁸² Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Judgment on Decision setting Liability](#), para. 108.

³⁸³ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 11-25.

³⁸⁴ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 24.

c)Legjislacioni i Kosovës

216. Mbrojtësja e Viktimave parashtron se, ndonëse legjislacioni i Kosovës që trajton dëmet dhe lëndimet e pësuar në kontekstin e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999 nuk njeh dëmin e pësuar nga viktimat në fjalë, ky legjislacion, sipas saj, ofron “një bazë të dobishme se çfarë është konstatuar si e realizueshme dhe e financueshme në Kosovë”.³⁸⁵

217. Trupi Gjykses pajtohet me Mbrojtësen e Viktimave se ky legjislacion përmban tregues të asaj që në Kosovë konsiderohet si zhdëmtim proporcional për dëmin e shkaktuar si rezultat i luftës në Kosovë në vitet 1998-1999,³⁸⁶ edhe pse në këto ligje nuk trajtohet dëmi konkret i pësuar nga viktimat në këtë çështje gjyqësore, pasi ato përqendrohen në dëmin e pësuar si pasojë e veprimeve të armikut, d.m.th. forcave serbe.³⁸⁷

218. Pasi ka shqyrtuar me kujdes përmbledhjen dhe diskutimin e këtij legjislacioni nga Mbrojtësja e Viktimave,³⁸⁸ Trupi Gjykses vendos që legjislacionin e Kosovës ta marrë parasysh si pikë referimi për përcaktimin e shumave të zhdëmtimit që gjykohen të arsyeshme në kontekstin e Kosovës.³⁸⁹

³⁸⁵ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 27.
³⁸⁶ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 27. Mbrojtësja e Viktimave gjithashtu parashtron se “masat e përcaktuara në legjislacion konceptohen si zhdëmtime nga organizatat e shoqërisë civile të Kosovës” ([Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), poshtëshënimi 41).

³⁸⁷ *Shih* poshtëshënimin 404 më poshtë.

³⁸⁸ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 27-33.

³⁸⁹ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 27.

219. Më konkretisht, Trupi Gjykses do të marrë parasysh ligjet në vijim: (i) Ligjin nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre, të 8 dhjetorit 2011³⁹⁰ ("Ligji nr. 04/L-054"), ndryshuar më pas me Ligjin nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, të 20 marsit 2014³⁹¹ ("Ligji nr. 04/L-172"), në të cilin u përfshinë edhe viktimat e dhunës seksuale; dhe (ii) Ligjin nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të 23 prillit 2014³⁹² ("Ligji nr. 04/L-261"), ndryshuar më pas me Ligjin nr. 05/L-141 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të 14 prillit 2017³⁹³ ("Ligji nr. 05/L-141").

³⁹⁰ [Law No. 04/L-054 on the Status and Rights of the Martyrs, Invalids, Veterans, Members of the Kosovo Army, Civilian Victims of War and their Families](#) (Ligji nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre), 8 dhjetor 2011.

³⁹¹ [Law No. 04/L-172 on Amending and Supplementing the Law No. 04/L-054 on the Status and the Rights of the Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army, Sexual Violence Victims of the War, Civilian Victims and their Families](#) (Ligji nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre), 20 mars 2014.

³⁹² [Law No. 04/L-261 on Kosovo Liberation Army War Veterans](#) (Ligji nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës), 23 prill 2014.

³⁹³ [Law No. 05/L-141 on Amending and Supplementing the Law No. 04/L-261 on Kosovo Liberation Army War Veterans](#) (Ligji nr. 05/L-141 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës), 14 prill 2017.

220. Trupi Gjykues vëren se këto ligje rregullojnë në mënyrë të veçantë të drejtat dhe përfitimet që akordohen për veteranët dhe civilët e dëmtuar në kontekstin e luftës në Kosovë të viteve 1998-1999, ose për ata që morën pjesë në luftë, si edhe për anëtarët e familjeve të anëtarëve të UÇK-së dhe të civilëve që humbën jetën ose u zhdukën. Përfitimet ekzistuese ndryshojnë në varësi të kategorisë së cilës i përket personi dhe janë nga më të ndryshmet: që nga pensionet mujore deri te përkujdesja dhe ndihma në institucione rezidenciale, rehabilitimi mjekësor dhe fizik, shërbime shëndetësore jashtë shtetit, riaftësimi profesional, përparësi në punësim, ndihma për sigurimin e strehimit, bursa për shkollim të mesëm dhe universitar dhe lirimi nga pagesa e tatimeve.³⁹⁴ Përfitimet e përcaktuara në këto ligje nuk zbatohen në mënyrë prapavepruese.³⁹⁵

221. Trupi Gjykues gjithashtu thekson se Ligji nr. 04/L-172, me të cilin u ndryshua Ligji nr. 04/L-054, për të përfshirë edhe viktimat e dhunës seksuale, përcakton se Kosova synon t'u ofrojë mbështetje të gjitha viktimave të dëmtuara gjatë luftës së viteve 1998-1999. Megjithatë, përdorimi i fjalës "armik" në të gjithë tekstin e ligjit duket se i përjashton viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore, pasi këto viktima e kanë pësuar dëmin nga anëtarë të UÇK-së.³⁹⁶

³⁹⁴ *Shih* nenet 5-15 të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) dhe nenet 6-7 të Ligjit nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)); nenet 23-33 të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)).

³⁹⁵ *Shih* nenin 22(2) të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) dhe nenin 39(2) të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)).

³⁹⁶ *Shih* nenin 3(1.7) dhe (1.12.) të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)). *Shih gjithashtu* poshtëshënimin 404 më poshtë. [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 27; [T. 15 September 2021](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2021), publik, f. 349, rreshtat 13-22.

222. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se, në thelb, ky legjislacion synon të ndreqë dëmin e pësuar nga personat gjatë luftës së viteve 1998-1999, ose të mbështesë ata që morën pjesë në luftë, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se shifrat e mëposhtme kanë rëndësi relative në përcaktimin e përgjegjësisë financiare të z. Mustafa për zhdëmtimet. Trupi Gjykses do të marrë gjithashtu parasysh faktin se, sipas këtyre ligjeve, krahas pensioneve, përfituesit kanë të drejtë edhe për ndihma të tjera (të konsiderueshme).³⁹⁷

223. Sipas Ligjit nr. 04/L-054, pensionet mujore për “invalidin e luftës së UÇK-së”³⁹⁸ shkojnë nga 255 euro (me dëmtim trupor mbi 31-40%) deri në 358,50 euro (me dëmtim trupor mbi 80%).³⁹⁹ Një mbledhje e thjeshtë e pagesave mujore të pensionit për “invalidin e luftës së UÇK-së” nga janari 2012 deri në janar 2023 jep një shumë prej së paku 33.660 euro.⁴⁰⁰

³⁹⁷ *Shih* nenet 9-11, 13-14 të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)), nenet 6-7 të Ligjit nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)), nenet 23-33 të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)).

³⁹⁸ Neni 3(1.7.1) i Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)), ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)), përcakton se “invalid i luftës së UÇK-së” është “luftëtari, pjesëtari dhe i internuari (i burgosuri) i UÇK-së, i cili ka pësuar plagë, lëndime (dëmtime) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut, gjatë periudhës së luftës, me shkallë të invaliditetit së paku dhjetë për qind (10%)”.

³⁹⁹ *Shih* Shtojcën e Ligjit nr. 04/L-054 ([Annex to Law No. 04/L-054](#)). Invalidi i UÇK-së me shkallë invaliditeti 10 deri 19% nuk e gëzon pensionin invalidor personal (neni 10(4) i Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#))).

⁴⁰⁰ (Llogaritja: 11 x 12 x 255). Kjo shifër nuk përfshin shtesat apo përshtatjet që mund t’u jenë bërë këtyre pagesave për shkak të inflacionit. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Mbrojtësës së Viktimave për Zhdëmtim ([Victims’ Counsel Reparations Request](#)), para. 56.

224. Pensionet mujore për “invalidin civil të luftës”⁴⁰¹ shkojnë nga 96 euro (me dëmtim trupor mbi 40-60%) deri në 122 euro (me dëmtim trupor mbi 80%).⁴⁰² Një mbledhje e thjeshtë e pagesave mujore të pensionit për “invalidin civil të luftës” nga janari 2012 deri në janar 2023 jep një shumë prej së paku 12.672 euro.⁴⁰³

225. Anëtarët e familjes së ngushtë të viktimës civile⁴⁰⁴ kanë të drejtën të përfitojnë pension mujor familjar në shumën 135 euro (si dhe përfitime të tjera).⁴⁰⁵ Kjo do të thotë se nga janari 2012 deri në janar 2023, anëtarët e familjeve të ngushta të viktimave kanë marrë së paku 17.820 euro si pension familjar.⁴⁰⁶

⁴⁰¹ Neni 3(1.8) i Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) përcakton se “Invalidi civil i luftës është personi, organizmi i të cilit është dëmtuar së paku 40% si pasojë e plagëve të marra nga armët, sëmundjes së fituar në burgjet apo kampet gjatë luftës së fundit në Kosovë, prej datës 27.02.1998 deri me datën 20.06.1999, si dhe personat e tjerë, organizmi i të cilëve është dëmtuar së paku 40% si pasojë e mjeteve shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës”.

⁴⁰² *Shih* Shtojcën e Ligjit nr. 04/L-054 ([Annex to Law No. 04/L-054](#)).

⁴⁰³ (Llogaritja: 11 x 12 x 96). Kjo shifër nuk përfshin shtesat apo përshtatjet që mund t’u jenë bërë këtyre pagesave për shkak të inflacionit.

⁴⁰⁴ Sipas nenit 3(1.10) të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)), “Viktima civile e luftës” përcaktohet si “person i cili është vrarë apo është plagosur, nga forcat e armikut brenda periudhës 27.02.1998 deri me 20.06.1999, si dhe personat që kanë pësuar si pasojë e luftës brenda tri (3) viteve që nga përfundimi i luftës nga mjetet shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës”. Neni 3(1.12) i Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) e përcakton “pengun civil të luftës” si “person civil, i cili gjatë luftës është arrestuar dhe internuar në kampet e armikut së paku tre (3) ditë, përkatësisht shtatëdhjetë e dy (72) orë”. Neni 3(1.14) i Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) e përcakton “personin civil të zhdukur” si “person vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët e tij/saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdukur në periudhën mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999”. Sipas nenit 3(1.15) të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)), me “anëtarë të familjes së ngushtë” nënkuptohen “bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesorë, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtira si dhe bashkëshorti/bashkëshortja jashtëmartesore”. Rrjedhimisht, përdorimi i termit “armik” dhe [REDAKTUAR] përjashtojnë viktimat e drejtpërdrejta dhe viktimat e tërthorta.

⁴⁰⁵ *Shih* nenin 13 të Ligjit nr. 04/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) dhe Shtojcën e Ligjit nr. 04/L-054 ([Annex to Law No. 04/L-054](#)).

⁴⁰⁶ (Llogaritja: 11x12x135). Kjo shifër nuk përfshin shtesat apo përshtatjet që mund t’u jenë bërë këtyre pagesave për shkak të inflacionit.

226. Sipas Ligjit nr. 04/L-261, veteranët e papunë⁴⁰⁷ që nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga ndonjë skemë tjetër pensioni, si p.sh. për lëndime të pësuar gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999,⁴⁰⁸ kanë të drejtën e një pensioni mujor në shumën 170 euro.⁴⁰⁹ Një mbledhje e thjeshtë e pagesave mujore të pensionit nga prilli 2014 deri në janar 2023 jep shumën 17.850 euro.⁴¹⁰

d) Aktekspertiza *Lerc*

227. Mbrojtësja e Viktimave parashtron se Aktekspertiza *Lerc* ofron një vlerësim të dobishëm të dëmit material të pësuar nga viktimat e drejtpërdrejta dhe të përmasave të ndryshme të tij, edhe pse deri në një farë mase ajo është hipotetike.⁴¹¹

⁴⁰⁷ Sipas nenit 3(1.3) të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)), veteran i UÇK-së është një “pjesëmarrës në luftën për çlirimin e Kosovës” dhe në këtë kategori përfshihen “invalidi i luftës së UÇK-së”, “veterani luftëtar i UÇK-së”, “i internuari i UÇK-së”, “pjesëtari i UÇK-së”, “pjesëmarrësi i luftës” dhe “ushtari i zhdukur (i pagjetur) i UÇK-së”. *Shih* nenet 16(4) dhe 18 të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)).

⁴⁰⁸ *Shih* nenin 2(2) të Ligjit nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)).

⁴⁰⁹ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 28. Siç u përmend më lart, Ligji nr. 04/L-261 ([Law No. 04/L-261](#)) u ndryshua më pas me Ligjin nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)). Neni 16A i Ligjit nr. 04/L-172 ([Law No. 04/L-172](#)) tani përcakton tri kategori të veteranëve:

- “1.1. Kategoria e parë: Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar nga viti 1991 deri më 5 mars 1998 dhe që ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës;
- 1.2. Kategoria e dytë: Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë pas datës 5 mars 1998 dhe që ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës;
- 1.3. Kategoria e tretë: Veterani luftëtar i UÇK-së, i mobilizuar në luftë pas datës 31 mars 1999 dhe që ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës, si dhe Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë nga viti 1991, përkatësisht pas 5 marsit 1998, por që nuk ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës”.

Veterani i kategorisë së parë përfiton 250 euro, veterani i kategorisë së dytë 170 euro dhe veterani i kategorisë së tretë 120 euro.

⁴¹⁰ (Llogaritja: 105 x 170). Kjo shifër nuk përfshin shtesat apo përshtatjet që mund t'u jenë bërë këtyre pagesave për shkak të inflacionit.

⁴¹¹ [Victims' Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 35.

228. Trupi Gjykues rikujton se Aktekspertiza *Lerc* u përgatit nga eksperti financiar i caktuar prej Trupit Gjykues për të llogaritur dëmin material dhe humbjet ekonomike të pësuar nga V08/05, V09/05 dhe V10/05.⁴¹² Trupi Gjykues vëren se llogaritja e humbjes në të ardhura që jepet në Aktekspertizën *Lerc* përkon “përafërsisht me situatat reale”.⁴¹³ Në mungesë të informacionit lidhur me, për shembull, fletëpagesat dhe kontratat e punës, analiza që bëhet në Aktekspertizën *Lerc* bazohet në të dhënat statistikore për pagat mesatare, tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributet në skemat e pensionit, pensionet e përfituara dhe sigurimet shoqërore në Kosovë, dhe mbështetet “në një masë të madhe në premisat e paraqitura nga Mbrojtësja e Viktimave [sic]”.⁴¹⁴ Sipas Aktekspertizës *Lerc*, humbja në të ardhura është e barabartë me shumën e humbjeve vjetore në të ardhura nga viti 2000 deri në vitin 2022, plus shumën e humbjeve të ardhshme në të ardhura, e kapitalizuar,⁴¹⁵ ndërsa humbja vjetore në të ardhura është e barabartë me diferencën midis të ardhurave të llogaritura “me dhe pa incidentin”.⁴¹⁶ Nëse të ardhurat nuk dihen, por pritet që të jenë shumë të ulëta, në Aktekspertizën *Lerc* supozohet se ato përkrijnë me përfitimin nga skemat e sigurimeve shoqërore që merr një person i cili jeton vetëm, që është 60 euro.⁴¹⁷

229. Ndonëse në Aktekspertizën *Lerc* bëhen vlerësime të përafërta të humbjeve ekonomike të pësuar nga viktimat e drejtpërdrejta, Trupi Gjykues vendos që

⁴¹² [Decision appointing a financial expert](#) (Vendimi i Caktimit të Ekspertit Financiar), para. 7, 13.

⁴¹³ [Lerz Report](#) (Aktekspertiza *Lerc*), f. 4-6.

⁴¹⁴ [Lerz Report](#) (Aktekspertiza *Lerc*), f. 4-12. *Shih gjithashtu* [Lerz Report](#) (Aktekspertiza *Lerc*), f. 22-48.

⁴¹⁵ Për përcaktimin e vlerës së humbjes së të ardhurave në të ardhmen përdoren tre faktorë: vlerësimi i përafërt i rritjes së të ardhurave në të ardhmen, norma e interesit, dhe shkalla e vdekshmërisë ([Lerz Report](#) (Aktekspertiza *Lerc*) f. 4-6, *Shih gjithashtu* [Lerz Report](#) (Aktekspertiza *Lerc*), f. 22-24.

⁴¹⁶ [Lerz Report](#) (Aktekspertiza *Lerc*), f. 5.

⁴¹⁷ [Lerz Report](#) (Aktekspertiza *Lerc*), f. 11.

Aktekspertizën ta marrë parasysh si pikë referimi, veçanërisht sa i takon dëmit material, për përcaktimin e një shume të arsyeshme⁴¹⁸ në kontekstin e Kosovës.

230. Në lidhje me V08/05-ën, Aktekspertiza *Lerc* niset nga premisa se [REDAKTUAR].⁴¹⁹ Metodologjia e përdorur konkretisht për llogaritjen e humbjes në të ardhura të V08/05-ës përfshin krahasimin e të ardhurave “pa incidentin”, [REDAKTUAR], me të ardhurat pas incidentit, [REDAKTUAR], duke marrë vitin e daljes në pension [REDAKTUAR] si vit i fundit i llogaritjes.⁴²⁰ Në Aktekspertizë theksohet se ndonëse viktimja merr rrogë, ai mund të ishte ngritur në detyrë për punë më të mirë se sa e ka të mundshme të kryejë pas pasojave të incidentit, dhe se kjo ngritje në detyrë do t’ia kishte rritur të ardhurat.⁴²¹ Rrjedhimisht, është supozuar se do të ishte përfituar një rritje me 20% të rrogës për faktin se do të punonte në një post më të lartë.⁴²² Në Aktekspertizë gjithashtu thuhet se llogaritja e humbjes në të ardhura të V08/05-ës është bërë më me përafërsi se sa për të tjerët, pasi rritja me 20% e të ardhurave në një post më të lartë mund të jetë vetëm vlerësim i përafërt dhe nuk dihet se në cilin vit do të ishte bërë kjo rritje e rrogës.⁴²³ Rrjedhimisht, në Aktekspertizë sugjerohet që si vit i rritjes së rrogës të merret viti 2011, d.m.th. mesi i periudhës ndërmjet vitit 2000 dhe 2022.⁴²⁴ Sipas këtij skenari, humbja në të ardhura e V08/05-ës do të ishte e barabartë me 31.779 euro.⁴²⁵ Në Aktekspertizën *Lerc* jepen edhe rezultatet

⁴¹⁸ Neni 22(3) i Ligjit.

⁴¹⁹ Aktekspertiza *Lerc*, f. 13.

⁴²⁰ Aktekspertiza *Lerc*, f. 13.

⁴²¹ Aktekspertiza *Lerc*, f. 13.

⁴²² Aktekspertiza *Lerc*, f. 14.

⁴²³ Aktekspertiza *Lerc*, f. 14.

⁴²⁴ Aktekspertiza *Lerc*, f. 14.

⁴²⁵ Aktekspertiza *Lerc*, f. 14.

për çdo vit tjetër përkatës (nga viti 2000 deri në vitin 2022). Humbja në të ardhura shkon nga 20.842 euro në 39.343 euro.⁴²⁶

231. Në lidhje me V09/05-ën, Aktekspertiza *Lerc* niset nga premisa se [REDAKTUAR] dhe se të ardhurat “me incidentin” janë [REDAKTUAR].⁴²⁷ Metodologjia e përdorur konkretisht për llogaritjen e humbjes në të ardhura të V09/05-ës përfshin krahasimin e të ardhurave “pa incidentin”, [REDAKTUAR], me të ardhurat pas incidentit, [REDAKTUAR], duke marrë vitin e daljes në pension [REDAKTUAR] si vit i fundit i llogaritjes.⁴²⁸ Në Aktekspertizën *Lerc* theksohet se, [REDAKTUAR], sugjerohet që për llogaritjen të merret si pikë referimi [REDAKTUAR].⁴²⁹ Sipas këtij skenari, humbja në të ardhura e V09/05-ës do të ishte 150.703 euro. Në Aktekspertizën *Lerc* jepen edhe rezultatet për çdo vit tjetër përkatës ([REDAKTUAR]). Humbja në të ardhura shkon nga 89.255 euro në 211.086 euro.⁴³⁰

232. Lidhur me V10/05-ën, Aktekspertiza *Lerc* niset nga premisa se [REDAKTUAR] dhe se të ardhurat “me incidentin” janë [REDAKTUAR].⁴³¹ Metodologjia e përdorur konkretisht për llogaritjen e humbjes në të ardhura të V10/05-ës përfshin krahasimin e të ardhurave “pa incidentin”, [REDAKTUAR], me të ardhurat pas incidentit, [REDAKTUAR], duke marrë vitin e daljes në pension [REDAKTUAR] si vit i fundit i llogaritjes.⁴³² Në Aktekspertizën *Lerc* theksohet se V10/05 ka informuar se

⁴²⁶ Aktekspertiza *Lerc*, f. 14-15.

⁴²⁷ Aktekspertiza *Lerc*, f. 16.

⁴²⁸ Aktekspertiza *Lerc*, f. 16.

⁴²⁹ Aktekspertiza *Lerc*, f. 16.

⁴³⁰ Aktekspertiza *Lerc*, f. 16-18.

⁴³¹ Aktekspertiza *Lerc*, f. 19.

⁴³² Aktekspertiza *Lerc*, f. 19.

[REDAKTUAR].⁴³³ Në Aktekspertizën *Lerc* parashtrohet se [REDAKTUAR]. Gjithashtu, në Aktekspertizë parashtrohet se [REDAKTUAR] nuk është relevant për këtë llogaritje, sepse nuk ka lidhje me incidentin [REDAKTUAR].⁴³⁴ Në Aktekspertizën *Lerc* arrihet në përfundimin se, bazuar në metodologjinë e mësipërme, humbja në të ardhura e V10/05-ës do të ishte e barabartë me 56.716 euro.⁴³⁵

e) Përfundim

233. Trupi Gjykues thekson se ndonëse Mbrojtësja e Viktimave parashton se “kompensimi duhet të jetë proporcional me peshën e dëmit të pësuar”,⁴³⁶ ajo propozon një listë të shumave “minimale” që duhet t’u akordohen viktimave si kompensim, sidomos në lidhje me dëmin material.⁴³⁷ Sipas mendimit të Trupit Gjykues, është e paqartë nëse qëndrimi i Mbrojtëses së Viktimave është që këto shuma “minimale” pasqyrojnë peshën e dëmit të pësuar⁴³⁸ dhe/ose shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat⁴³⁹ – që, në fund të fundit, përfaqëson shumën e përgjegjësisë financiare të z. Mustafa për zhdëmtimet.

⁴³³ Aktekspertiza *Lerc*, f. 19.

⁴³⁴ Aktekspertiza *Lerc*, f. 19.

⁴³⁵ Aktekspertiza *Lerc*, f. 20.

⁴³⁶ [Victims’ Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 9.

⁴³⁷ [Victims’ Counsel Further Information on Reparations](#) (Informacioni i Mëtejshëm i Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet), para. 6; *Shih gjithashtu* Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim ([Victims’ Counsel Reparations Request](#)), para. 38, 43, 48.

⁴³⁸ [Victims’ Counsel Reparations Request](#) (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 9.

⁴³⁹ Trupi Gjykues rikujton se për të ndihmuar në përcaktimin e shkallës dhe masës së dëmit, humbjeve dhe lëndimeve të pësuar nga viktimat, ai e udhëzoi Mbrojtësen e Viktimave të paraqiste shumat e të hollave që duhet t’u akordohen viktimave për kompensimin e secilit lloj dëmi të pësuar ([Closing Statements Hearings Agenda](#) (Rendi i Ditës i Seancave të Deklaratave Përmbyllëse), para. 18).

234. Pavarësisht nga kjo, Trupi Gjykses konstaton se shumata e kërkua nga Mbrojtësja e Viktimave për kompensimin e dëmit janë proporcionale me dëmin e pësuar nga viktimat, si edhe të arsyeshme, sikurse përcaktohet në nenin 22(3) të Ligjit.

235. Më konkretisht, në lidhje me V08/05-ën, Trupi Gjykses rikujton se ai nuk ka pësuar dëm fizik afatgjatë si pasojë e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.⁴⁴⁰ Megjithatë, ai ka përjetuar dëm të konsiderueshëm mendor,⁴⁴¹ edhe pse kohëzgjatja e ndalimit të V08/05-ës në kompleksin e ndalimit në Zllash ishte shumë më e shkurtër se ajo e V09/05-ës dhe V10/05-ës.⁴⁴² Trupi Gjykses gjithashtu rikujton konstatimin e tij në kuadër të dëmit mendor se V08/05 pësoi dëm edhe për sa u përket planeve të tij për jetën, pasi krimet për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor patën pasoja në zhvillimin e tij personal dhe familjar.⁴⁴³ Gjithashtu, ndonëse V08/05 arriti të punësohej, përparimi i tij në karrierë u ndikua negativisht si rezultat i kohës që kaloi në kompleksin e ndalimit në Zllash, gjë që ndikoi në nivelin e të ardhurave të tij.⁴⁴⁴ Në Aktekspertizën *Lerc*, vlerësohet se humbjet në të ardhura të V08/05-ës shkojnë nga 20.842 euro në 39.343 euro.⁴⁴⁵ Rikujtohet gjithashtu se, krahas humbjes në të ardhura, Trupi Gjykses ka njohur edhe dëmin që iu shkaktua planeve të tij për jetën si pjesë të dëmit material.⁴⁴⁶

⁴⁴⁰ *Shih* para. 148-150, 158 më lart.

⁴⁴¹ *Shih* para. 151-155, 158 më lart.

⁴⁴² *Shih* Aktgjykimin, [REDAKTUAR].

⁴⁴³ *Shih* para. 154 më lart.

⁴⁴⁴ *Shih* para. 156 më lart.

⁴⁴⁵ *Shih* para. 230 më lart.

⁴⁴⁶ *Shih* para. 156 më lart.

236. Në lidhje me V09/05-ën, Trupi Gjykses vlerëson se V09/05 ka pësuar dëm fizik dhe mendor të konsiderueshëm dhe afatgjatë si pasojë e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.⁴⁴⁷ Trupi Gjykses gjithashtu rikujton konstatimin e tij në kuadër të dëmit mendor se V09/05 pësoi dëm edhe për sa u përket planeve të tij për jetën, pasi krimet për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor patën pasoja në zhvillimin e tij personal dhe familjar.⁴⁴⁸ Gjithashtu, V09/05-ës, [REDAKTUAR], iu hoq mundësia të kishte një “karrierë normale”.⁴⁴⁹ Në Aktekspertizën *Lerc*, humbjet në të ardhura të V09/05-ës shkojnë nga 89.255 euro në 211.086 euro.⁴⁵⁰ Rikujtohet gjithashtu se, krahas humbjes në të ardhura, Trupi Gjykses ka njohur edhe dëmin që iu shkaktua planeve të tij për jetën si pjesë të dëmit material.⁴⁵¹

237. Në lidhje me V10/05-ën, Trupi Gjykses rikujton se ai ka pësuar dëm fizik dhe mendor të konsiderueshëm dhe afatgjatë si pasojë e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.⁴⁵² Gjithashtu, V10/05 nuk mundi të kthehej në profesionin e mëparshëm për shkak të lëndimeve që pësoi në kompleksin e ndalimit në Zllash [REDAKTUAR]. Në Aktekspertizën *Lerc* vlerësohet se humbja në të ardhura e V10/05-ës është 56.716 euro.⁴⁵³ Rikujtohet gjithashtu se, krahas humbjes në të ardhura, Trupi Gjykses ka njohur edhe dëmin që iu shkaktua planeve të tij për jetën si pjesë të dëmit material.

⁴⁴⁷ *Shih* para. 133-139, 145 më lart.

⁴⁴⁸ *Shih* para. 137 më lart.

⁴⁴⁹ *Shih* para. 140-145 më lart.

⁴⁵⁰ *Shih* para. 231 më lart.

⁴⁵¹ *Shih* para. 142-143 më lart.

⁴⁵² *Shih* para. 161-166, 171 më lart.

⁴⁵³ *Shih* para. 232 më lart.

238. Trupi Gjykues gjithashtu thekson se shumata e kompensimit të kërkuara nga Mbrojtësja e Viktimave për viktimat e drejtpërdrejta janë brenda kuadrit të konstatimeve në Aktekspertizën *Lerc* dhe janë vetëm llogaritje të përafërta të humbjeve në të ardhura.

239. Po kështu, Trupi Gjykues vlerëson se këto shuma nuk janë joproporcionale, kur krahasohen me përfitimet ekzistuese sipas legjislacionit të Kosovës. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues rikujton nivelet minimale të pensioneve të përcaktuara në legjislacionin e Kosovës, sikurse u evidentua më herët, që shkojnë nga 12.672 euro në 33.660 euro, për veteranët dhe civilët që pësuan dëme gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, ose që morën pjesë në luftë, dhe për anëtarët e familjes së ngushtë të tyre, si dhe ndihmat e tjera të konsiderueshme që kanë të drejtë të marrin.⁴⁵⁴

240. Sa u përket viktimave të tërthorta, Trupi Gjykues vlerëson se shumata e kërkuara nga Mbrojtësja e Viktimave për kompensimin e dëmit të pësuar nga këto viktima janë proporcionale me shumata e kërkuara për viktimat e drejtpërdrejta, edhe pse ato pasqyrojnë një lloj tjetër të dëmit mendor. Gjithashtu, siç u parashtrua nga Mbrojtësja e Viktimave,⁴⁵⁵ Trupi Gjykues e gjykon të përshtatshme të bëhet dallimi i viktimave të tërthorta sipas [REDAKTUAR] me viktimën e vrasjes së paligjshme.

241. Së fundi, Trupi Gjykues rikujton se Mbrojtja nuk paraqiti argumente konkrete për të kundërshtuar shumata e kompensimit të kërkuara nga Mbrojtësja e Viktimave në emër të tyre.⁴⁵⁶

⁴⁵⁴ *Shih* para. 223-225 më lart.

⁴⁵⁵ *Shih* para. 207 më lart.

⁴⁵⁶ *Shih* para. 124 më lart.

242. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se shumat 4.000 euro për dëmin fizik, 6.000 euro për dëmin mendor dhe 20.000 euro për dëmin material, gjithsej 30.000 euro, pasqyrojnë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga V08/05 dhe janë të arsyeshme sipas nenit 22(3) të Ligjit.

243. Po kështu, Trupi Gjykues konstaton se shumat 20.000 euro për dëmin fizik, 10.000 euro për dëmin mendor dhe 50.000 euro për dëmin material, gjithsej 80.000 euro, pasqyrojnë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga V09/05 dhe janë të arsyeshme sipas nenit 22(3) të Ligjit.

244. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstaton se shumat 20.000 euro për dëmin fizik, 10.000 euro për dëmin mendor dhe 30.000 euro për dëmin material, gjithsej 60.000 euro, pasqyrojnë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga V10/05 dhe janë të arsyeshme sipas nenit 22(3) të Ligjit.

245. Së fundi, Trupi Gjykues konstaton se shumat 10.000 euro, 5.000 euro dhe 2.000 euro, pasqyrojnë shkallën dhe masën e dëmit të pësuar përkatësisht nga V05/05, V06/05 dhe V12/05, dhe V11/05 dhe V13/05, dhe janë të arsyeshme sipas nenit 22(3) të Ligjit.

246. Trupi Gjykues gjithashtu rikujton se Mbrojtja nuk dorëzoi parashtrime në përgjigje të Kërkesës së Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim.

247. Duke marrë parasysh të gjitha aspektet e lartpërmendura, shkallën dhe masën e dëmit të pësuar nga viktimat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke vendosur për aspektet e paqarta në dobi të personit të shpallur fajtor dhe duke balancuar nevojën për saktësi në llogaritjen e shumave monetare me objektivin për akordimin pa vonesë të zhdëmtimeve, Trupi Gjykues përcakton se shuma e gjithsejtë e zhdëmtimit, që ka përgjegjësinë ta paguajë z. Mustafa, është 207.000 euro.

248. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron z. Mustafa që si kompensim për dëmin e shkaktuar, t'i paguajë:

- 30.000 euro V08/05-ës;
- 80.000 euro V09/05-ës;
- 60.000 euro V10/05-ës;
- nga 10.000 euro V05/05-ës, V06/05-ës dhe V12/05-ës;
- 5.000 euro V11/05-ës; dhe
- 2.000 euro V13/05-ës.

249. Së fundi, Trupi Gjykses thekson se Urdhri për Zhdëmtim nuk del jashtë kuadrin të krimeve për të cilat u shpall fajtor z. Mustafa. Gjithashtu, zotit Mustafa iu dha mundësia të bënte parashtrime në lidhje me shkallën dhe masën e viktimizimit, shkallën e zhdëmtimeve, dhe llojet e zhdëmtimeve që do të akordoheshin, por ai nuk pranoi ta bënte këtë.

VII. VËNIA NË JETË DHE ZBATIMI I URDHRI PËR ZHDËMTIM

A. MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA

250. Trupi Gjykses rikujton se juridiksioni i tij në këtë çështje gjyqësore përfundon me lëshimin e këtij Urdhri për Zhdëmtim, në pajtim me nenin 33(1)(b) të Ligjit.⁴⁵⁷

⁴⁵⁷ Në nenin 33(1)(b) të Ligjit përcaktohet se: "Caktimi i gjyqtarit (gjyqtarëve) të trupit gjykses përfundon në ditën kur formohet paneli i Gjykatës së Apelit për të dëgjuar ankesën kundër aktgjykimit të tij apo nëse periudha kohore për ankesë skadon pa u paraqitur asnjë ankesë, përveç nëse trupi gjykses është njëkohësisht i përfshirë në procedura të tjera, me ç'rast caktimet e gjyqtarëve përfundojnë në kohën e përmbylljes së atyre procedurave" [theksimi i shtuar].

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk ka kompetencë të monitorojë dhe mbikëqyrë vënien në jetë dhe zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se në Ligj dhe Rregullore nuk specifikohet autoriteti që duhet të monitorojë dhe mbikëqyrë vënien në jetë dhe zbatimin e urdhrit për zhdëmtim.

251. Trupi Gjykses është gjithashtu i mendimit se për të mundësuar një proces efikas dhe të shpejtë në dobi të viktimave, është i nevojshëm një autoritet gjyqësor për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim. Gjithashtu, Trupi Gjykses parashikon që gjatë zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, mund të lindin probleme të cilat do të duhet të zgjidhen nga një autoritet gjyqësor.

252. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses fton Kryetaren e DHSK-së, si personi përgjegjës për administrimin gjyqësor të DSK-së, të caktojë një autoritet gjyqësor për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim.

253. Zyra Administrative, si “përgjegjëse për administrimin dhe shërbimin e Dhomave të Specializuara, si dhe për të gjitha funksionet e nevojshme përkatëse” sipas nenit 34(1) të Ligjit, do të kryejë veprimet e nevojshme për vënien në jetë dhe zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim, sipas udhëzimeve që jepen në këtë Urdhër ose, pas lëshimit të Urdhrit për Zhdëmtim, nga autoriteti gjyqësor i caktuar për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim.⁴⁵⁸

⁴⁵⁸ Sipas Trupit Gjykses, kjo mund të bëhet në formën e marrjes dhe administrimit të të hollave për viktimat, siç parashikohet në nenet 44(6) dhe 53(4) dhe (5) të Ligjit (*Shih* para. 268 dhe poshtëshënimin 496 më poshtë).

B. FINANCIMI

1. Nga personi i shpallur fajtor

254. Siç u përcaktua më lart, z. Mustafa është përgjegjës për t'u paguar viktimave shumën 207.000 euro si kompensim për dëmin e shkaktuar.⁴⁵⁹

255. Trupi Gjykses thekson se [REDAKTUAR],⁴⁶⁰ nuk konstatohet se z. Mustafa aktualisht ka mjetet financiare për të përmbushur *plotësisht* Urdhrin për Zhdëmtim.⁴⁶¹ Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se [REDAKTUAR].⁴⁶² Trupi Gjykses gjithashtu vëren se [REDAKTUAR].⁴⁶³ Trupi Gjykses gjykon se të paktën një pjesë e kësaj pasurie mund të përdoret për zbatimin – ndonëse pjesërisht – të Urdhrit për Zhdëmtim, pasi [REDAKTUAR] nuk mjaftojnë për të paguar shumën e gjithsejtë të kompensimit.⁴⁶⁴

256. Rrjedhimisht, së bashku me Urdhrin për Zhdëmtim, Trupi Gjykses lëshon një vendim dhe urdhra të lidhur me të, me qëllim që autoriteti gjyqësor i caktuar për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim të marrë informacionin e nevojshëm për të vendosur mbi veprimet që duhen ndërmarrë në lidhje me këto pasuri. Administratorja duhet të marrë masat e nevojshme për zbatimin

⁴⁵⁹ *Shih* para. 248 më lart.

⁴⁶⁰ [REDAKTUAR].

⁴⁶¹ [REDAKTUAR]

⁴⁶² [REDAKTUAR].

⁴⁶³ [REDAKTUAR].

⁴⁶⁴ [REDAKTUAR]. Po kështu, Trupi Gjykses vlerëson se nuk është kusht që pasuria e z. Mustafa, e cila mund të përdoret për të paguar dëmshpërblimet e përcaktuara nga ky Trup Gjykses, të ketë lidhje me krimet për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor, duke qenë se nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit parashikojnë kryesisht dëmshpërblimin e viktimave pa i kufizuar pasuritë që mund të përdoren për zhdëmtime vetëm në ato që kanë lidhje me krimin. Ky interpretim është në përputhje me të drejtën e viktimave për mjet juridik efektiv.

e vendimit në fjalë dhe të urdhrave përkatës bashkëlidhur Urdhrit për Zhdëmtim.
[REDAKTUAR].

257. Mbi bazën e informacionit të marrë, dhe duke mbajtur parasysh të drejtat e z. Mustafa ose ato të palëve të treta *bona fide*,⁴⁶⁵ autoriteti gjyqësor i caktuar do të mund të vendosë nëse do të urdhërojë që nga [REDAKTUAR] t'u paguhet viktimave një shumë mbi bazë proporcionale⁴⁶⁶ dhe, në atë kontekst, nëse do të [REDAKTUAR].

258. Duke marrë parasysh se, pavarësisht nga sa më sipër, aktualisht z. Mustafa nuk mund ta përmbushë plotësisht Urdhrin për Zhdëmtim, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se zotit Mustafa i mungojnë pjesërisht mjetet financiare për të kryer zhdëmtimin.

259. Gjithashtu, duke pasur parasysh se aktualisht duket se z. Mustafa nuk është në gjendje të paguajë të gjithë shumën e zhdëmtimit, Trupi Gjykses është i mendimit se për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim duhet të përfshihen aktorë të tjerë. Këta do të trajtohen më poshtë.⁴⁶⁷ Pavarësisht nga kjo, z. Mustafa mbetet përgjegjës për pagimin e të gjithë shumës së zhdëmtimit.⁴⁶⁸ Rrjedhimisht, në rast se një shtet (si Kosova) ose një institucion (si p.sh. një fond që do të krijohet) japin shumat e nevojshme për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim në dobi të viktimave, kjo nuk do ta lirojë z. Mustafa nga përgjegjësia dhe ai do të vazhdojë të ketë detyrimin t'i kthejë ato shuma nëse

⁴⁶⁵ *Shih* nenin 53(4) të Ligjit.

⁴⁶⁶ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton parimin se mund të duhet t'u jepet përparësi disa viktimave që janë në një gjendje veçanërisht të cenueshme ose të cilëve u nevojitet ndihmë urgjente (*Shih* para. 71 më lart). Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vë në dukje parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave se [REDAKTUAR] (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, [REDAKTUAR]).

⁴⁶⁷ *Shih* para. 260 dhe në vijim më poshtë.

⁴⁶⁸ *Shih* para. 117 më lart.

monitorimi i gjendjes së tij financiare do të zbulojë se ai zotëron mjetet financiare për përmbushjen e Urdhrit për Zhdëmtim. Për këtë qëllim, autoriteti gjyqësor që do të caktohet për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim mund të [REDAKTUAR] dhe të monitorojë në vijimësi gjendjen e tij financiare, me qëllim zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim.⁴⁶⁹

2. Nga Kosova

260. Trupi Gjyqës rikujton se i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës që të dorëzonte informacione konkrete lidhur me mundësitë që viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së të përfitojnë: (i) nga fondet ekzistuese për kompensimin e viktimave; (ii) ose, nëse kjo nuk është e mundur, nga një fond i krijuar rishtas dhe i financuar nga buxheti i Kosovës.⁴⁷⁰

a) Financimi nga programi për kompensimin e viktimave të krimit

261. Ministria e Drejtësisë e Kosovës informoi Trupin Gjyqës se viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së mund t'u akordohet kompensim ose dëmshpërblim nga programi i kompensimit të viktimave, i krijuar në bazë të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit ("Ligji nr. 05/L-036") ("Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit"),⁴⁷¹ nëse vërtetohet se personi i shpallur fajtor nuk është në gjendje të paguajë tërësisht ose pjesërisht shumën e dëmshpërblimit të

⁴⁶⁹ Ngjashëm, ICC, [Lubanga AC Judgment on Principles of Reparations](#), para. 104 dhe 115.

⁴⁷⁰ [Article 22\(9\) Decision](#) (Vendimi sipas Nenit 22(9)), para. 50(f) dhe më pas, [Further Order to the Ministry of Justice of Kosovo](#) (Urdhri i Mëtejshëm drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës).

⁴⁷¹ [Ministry of Justice of Kosovo Second Response](#) (Përgjigjja e Dytë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), f. 1-2, 4. *Shih* nenet 19(1)(1.26) dhe 62(1)(1.5) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2012.

akorduar.⁴⁷² Viktima mund t'i kërkojë Trupit Gjykses që urdhrin për kompensim t'ia përcjellë organit vendimmarrës.⁴⁷³ Kërkesa e plotësuar duhet të dorëzohet brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të vendimit gjyqsor të formës së prerë.⁴⁷⁴

262. Ministria e Drejtësisë e Kosovës sqaroi më tej se viktimat që parashtrajnë kërkesa për kompensim mund të mbeten anonime por vetëm "përtej personave kompetentë që merren me administrimin dhe ekzekutimin e kërkesës për kompensim".⁴⁷⁵ Së fundi, Ministria e Drejtësisë argumentoi se "për të shmangur çfarëdolloj elementi të konfliktit të interesit", Administratorja nuk mund të jetë "i autorizuar i viktimës" dhe të paraqesë kërkesë për kompensim ose dëmshpërblim në emër të viktimës, por parashtrioi se viktima mund të kërkojë ndihmën e mbrojtësit të viktimave që e ka autorizuar me akt përfaqësimi për të vepruar në emër të tij ose të saj.⁴⁷⁶

263. Trupi Gjykses thekson se Ligji nr. 05/L-036 u shfuqizua dhe u zëvendësua me Ligjin nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të 2 nëntorit 2022 ("Ligji Nr. 08/L-109").⁴⁷⁷ Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se parashtrimet e lartpërmendura të

⁴⁷² [Ministry of Justice of Kosovo Second Response](#) (Përgjigja e Dytë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), f. 1-2.

⁴⁷³ [Ministry of Justice of Kosovo Second Response](#) (Përgjigja e Dytë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), f. 1-2.

⁴⁷⁴ [Ministry of Justice of Kosovo Second Response](#) (Përgjigja e Dytë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), f. 4.

⁴⁷⁵ [Ministry of Justice of Kosovo Second Response](#) (Përgjigja e Dytë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), f. 2.

⁴⁷⁶ [Ministry of Justice of Kosovo Second Response](#) (Përgjigja e Dytë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), f. 3; [Ministry of Justice of Kosovo First Response](#) (Përgjigja e Parë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), f. 5.

⁴⁷⁷ [Law No. 08/L-109 on Crime Victim Compensation](#) (Ligji Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin), 2 nëntor 2022.

Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës mbeten relevante në kontekstin e Ligjit nr. 08/L-109.

264. Fillimisht, Trupi Gjykses rithekson se, në bazë të nenit 23 të Ligjit, duhet të garantojë mbrojtjen e viktimave gjatë gjithë procesit gjyqësor, përfshirë gjatë procedurës së zhdëmtimit dhe zbatimit të çdo urdhri për zhdëmtim, pavarësisht nga forumi ku kryhet procedura e zhdëmtimit apo zbatimi i urdhrave për zhdëmtim.⁴⁷⁸

Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta në lidhje me atmosferën e përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të DHSK-së dhe familjeve të tyre.⁴⁷⁹ Ai gjithashtu rikujton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe ky Trup Gjykses urdhëruan masa mbrojtëse për viktimat, konkretisht që publikut të mos u bëhen të ditura emrat dhe të dhënat identifikuese të tyre.⁴⁸⁰ Së fundi, Trupi Gjykses nënvizon se viktimat morën pjesë në këtë çështje gjyqësore nën një trysni të jashtëzakonshme dhe shprehën frikë për çka mund t'u ndodhte atyre ose familjeve të tyre, nëse bëhej e njohur pjesëmarrja e tyre në proces.⁴⁸¹

265. Në këto rrethana, nxjerrja e identitetit të viktimave për një numër më të madh personash, si p.sh. për Komisionin për Kompensimin e Viktimave të Krimit⁴⁸² dhe punonjësit e tij, rrit rrezikun që identitetet e tyre t'i zbulohen - qëllimisht ose jo

⁴⁷⁸ [Article 22\(9\) Decision](#) (Vendimi sipas Nenit 22(9)), para. 38. *Shih* rregullën 81(1) të Rregullores.

⁴⁷⁹ *Shih* para. 199 më lart.

⁴⁸⁰ *Shih* Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ([Second Victims Participation Decision](#)), para. 54(e)-(f); [Third Victims Participation Decision](#) (Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 42(d)-(e).

⁴⁸¹ *Shih* para. 199 më lart.

⁴⁸² Trupi Gjykses vëren se në bazë të neneve 3(1.12), 21 dhe 23 të Ligjit nr. 08/L-109, autoriteti vendimmarrës në kuadër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

qëllimisht - publikut, përfshirë personave me synime të dëmshme. Sidoqoftë, Trupi Gjykses konstaton se këto rrethana, të cilat krijohen jo për faj të tyre, nuk mund të pengojnë zhdëmtimin e viktimave.

266. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses urdhëron Administratoren që, në bashkërendim me Mbrojtësen e Viktimave, të kërkojë në emër të viktimave kompensim nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në mënyrë që të ruhet anonimiteti i viktimave në fjalë dhe të garantohet mbrojtja e tyre. Trupi Gjykses dëshiron të theksojë se, në kundërshtim me argumentin e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, në këtë kontekst nuk lind asnjë konflikt interesi, pasi Zyra Administrative është organ asnjës i DHSK-së, mandati i së cilës është të administrojë dhe t'i shërbejë DHSK-së si dhe të kryejë të gjitha funksionet e tjera përkatëse në bazë të nenit 34(1) të Ligjit. Gjatë kryerjes së kësaj detyre, Administratorja dhe Mbrojtësja e Viktimave do t'i dorëzojnë Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit vetëm informacion publik në lidhje me viktimat.

267. Trupi Gjykses kërkon nga Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit që, në pajtim me nenin 53(2) të Ligjit - sipas të cilit çdo person fizik, korporatë, autoritet ose subjekt tjetër në Kosovë duhet të veprojë në përputhje me çdo urdhër të lëshuar nga DHSK-ja - t'u kushtojë vëmendjen e duhur kërkesave të viktimave për kompensim, mbi bazën e informacionit të dhënë nga Administratorja dhe Mbrojtësja e Viktimave, si dhe mbi bazën e versionit të redaktuar publik të Urdhrit për Zhdëmtim. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses nënvizon se versioni i redaktuar publik i Urdhrit për Zhdëmtim i ofron Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit informacionin e duhur në mbështetje të kërkesave të viktimave për kompensim, sikurse janë konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me: (i) dëmin e pësuar nga secila viktimitë si pasojë e krimeve të kryera nga z. Mustafa; (ii) kuadrin e përgjegjësisë së z. Mustafa për zhdëmtimet dhe kompensimin që duhet t'u jepet viktimave; dhe (iii)

mungesën e mjeteve financiare nga ana e z. Mustafa për përmbushjen e plotë të Urdhrit për Zhdëmtim, d.m.th. pamundësinë e tij për të paguar aktualisht shumën e plotë të zhdëmtimit.

268. Në rast se Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit do të miratojë fonde për kompensim, ato duhet t'i transferohen Administratores në pajtim me nenin 53(4) dhe (5) të Ligjit. Nga ana e saj, Administratorja duhet t'ua shpërndajë viktimave shumën e kompensimit në mënyrë proporcionale.

269. Për çdo veprim të ndërmarrë në lidhje me Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Administratorja duhet t'i raportojë autoritetit gjyqësor të caktuar për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, duke mbajtur parasysh afatin për parashtrimin e kërkesave për kompensim në kuadër të këtij Programi, dhe jo më vonë se dy (2) muaj pasi Urdhri për Zhdëmtim mund të vihet në jetë.

270. Pavarësisht nga sa më sipër, Trupi Gjykues është i vetëdijshëm se viktimat mund të mos marrin nga personi i shpallur fajtor shumën e plotë të kompensimit të akorduar nga Trupi Gjykues, duke pasur parasysh, siç shpjegohet më lart, [REDAKTUAR], apo nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit, duke pasur parasysh shumat maksimale që mund të akordohen në kuadër të këtij Programi.⁴⁸³ Rrjedhimisht, për

⁴⁸³ *Shih në lidhje me këtë* nenet 11-17 të Ligjit nr. 08/L-109 ([Law No. 08/L-109](#)), ku për çdo lloj dëmi përcaktohet shuma maksimale që mund të akordohet nga Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Në veçanti, Trupi Gjykues thekson se, sipas nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-109, shuma maksimale e kompensimit në rast të lëndimit fizik apo dëmtimit të shëndetit është 4.000 (katër mijë) euro për lëndime, dëmtime apo sëmundje të rënda, shumë e cila mund të rritet deri në 10.000 (dhjetë mijë) euro në rrethana të jashtëzakonshme, ndërsa shuma maksimale e kompensimit në rast të dëmtimit të shëndetit mendor shkaktuar nga një krim i dhunshëm dhe [në rast të] vuajtjes psikike – ndër të tjera edhe për shkak të humbjes së një anëtari të familjes – sipas neneve 12-14 të Ligjit nr. 08/L-109, është

vënien në jetë dhe zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim do të duhet të shqyrtohet mundësia e përdorimit të instrumenteve të tjera të zbatimit.

b) Krijimi i një mekanizmi të ri zhdëmtues në Kosovë

271. Ministria e Drejtësisë e Kosovës informoi Trupin Gjykses se për krijimin e një fondi ose programi të ri posaçërisht për kompensimin e viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së, do të duhej që organi legjislativ i Kosovës të miratonte një “ligj të posaçëm”, si p.sh. ai për financimin e mbrojtjes së personave të dyshuar dhe të akuzuar në proceset e DHSK-së.⁴⁸⁴

272. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vëren se, ndonëse Kosova parashikoi nevojën për të mbështetur financiarisht mbrojtjen e personave të dyshuar dhe të akuzuar në proceset e DHSK-së,⁴⁸⁵ ajo nuk mori masa paraprake për t’u përgatitur posaçërisht për

3.000 (tre mijë) euro për viktimat e drejtpërdrejta ose të tërthorta. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se sipas nenit 23(3.1) të Ligjit nr. 08/L-109 ([Law No. 08/L-109](#)): “Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimet, gjatë vendimmarrjes ka diskrecion [...] *tejkalimin e shumave maksimale të parashikuara për kategoritë e veçanta të kompensimit*, në rastet kur shpenzimet e dokumentuara janë të arsyeshme” [theksimi i shtuar].

⁴⁸⁴ [Ministry of Justice of Kosovo Second Response](#) (Përgjigja e Dytë e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës), f. 3-4, pjesa 4.

⁴⁸⁵ *Shih* Ligjin nr. 05/L-054 për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara ([Law No. 05/L-054 on legal protection and financial support for potential accused persons in trials before the Specialist Chambers](#)), 3 gusht 2015 (Ligji nr. 05/L-054); [Administrative Instruction MOJ - No. 08/2022 on the Legal Protection of Persons Potentially Accused of Alleged Crimes in Trials before the Specialist Chambers](#) (Udhëzimi Administrativ i MD-së Nr. 08/2022 për mbrojtjen juridike të personave të akuzuar potencial për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara), 29 dhjetor 2022 (“Udhëzimi Administrativ i MD-së së Kosovës në lidhje me Ligjin nr. 05/L-054”). Trupi Gjykses vëren se mbështetja financiare që ofron Kosova për personat e dyshuar ose të akuzuar në proceset e DHSK-së për mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes juridike të tyre, jepet me kërkesë të personit të dyshuar ose të akuzuar (*Shih* nenin 6 të Udhëzimit Administrativ të MD-së së Kosovës në lidhje me Ligjin nr. 05/L-054 ([Kosovo Administrative Instruction related to Law No. 05/L-054](#)) dhe nuk është objekt i vlerësimit dhe as nuk varet prej një vendimi që përcakton mungesën e mjeteve të personit të dyshuar ose të akuzuar që kërkon

mundësimin e zhdëmtimit të viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së, në rast se personi i shpallur fajtor nuk ka mjetet financiare për të përmbushur urdhrin për zhdëmtim.

273. Gjithashtu, Trupi Gjykues thekson se në legjislacionin e Kosovës që trajton dëmin dhe lëndimet e pësuar në kontekstin e luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, nuk njihen dëmet e pësuar nga të gjitha viktimat gjatë luftës në Kosovë, pasi ai u referohet vetëm viktimave të shkaktuara nga forcat e armikut, duke krijuar për rrjedhojë diskriminim midis viktimave të kësaj lufte.⁴⁸⁶

274. Ndonëse nuk ka kompetencë të urdhërojë Kosovën që të paguajë shumat e kompensimit të akorduara për viktimat, Trupi Gjykues e konsideron të rëndësishme t'i kujtojë Kosovës detyrimet e saj në lidhje me të drejtën e viktimave për mjete juridike efektive, të mishëruar në nenin 54 të Kushtetutës, nenet 6(1) dhe 13 të KEDNJ-së, nenet 2(3) dhe 14(1) të KNDCP-së dhe në nenin 14 të KKT-së.⁴⁸⁷ Kjo përfshin edhe detyrimin për të garantuar që këto mjete juridike të jenë të zbatueshme.⁴⁸⁸

mbështetje financiare. Neni 5 i Ligjit nr. 05/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)) gjithashtu përcakton se personat të cilët gjykohen në DHSK dhe më pas shpallen të pafajshëm me vendim të formës së prerë, mund të kërkojnë kompensim.

⁴⁸⁶ *Shih* para. 216 dhe në vijim më lart.

⁴⁸⁷ *Shih* nenin 14 të KKT-së; Committee against Torture, General Comment No. 3, Implementation of article 14 by States parties, CAT/C/GC/3 (2012), para. 5; [Declaration of Basic Principles of Justice](#) (Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve), para. 4-5, 12-13; [UN Basic Principles on Reparations](#) (Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet), para. 16.

⁴⁸⁸ GJEDNJ-ja është shprehur se detyrimi i shteteve sipas nenit 13 të KEDNJ-së përfshin edhe detyrimin për të garantuar që ky mjet juridik të jetë i zbatueshëm, pasi miratimi i mjetit juridik pa garantuar zbatimin e tij do të ishte i papajtueshëm me parimin e shtetit ligjor. (ECtHR, *Elvira Dmitriyeva v Russia*, nos. 60921/17 and 7202/18, [Judgment](#), 9 September 2019, para. 63; *VK v Croatia*, no. 38380/08, [Judgment](#), 29 April 2013, para. 114; *Kenedi v Hungary*, no. 31475/05, [Judgment](#), 26 August 2009, para. 47; *Kaić and Others v Croatia*, no. 22014/04, [Judgment](#), 17 October 2008, para. 40; *Z and Others v the United Kingdom*, no. 29392/95, [Judgment](#), 10 May 2001, para. 110-111). Gjithashtu, në Parimet Themelore të OKB-së mbi

275. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses kërkon që Kosova të miratojë ligjet e nevojshme dhe të krijojë një mekanizëm zhdëmtues për kompensimin e plotë të viktimave të krimeve që përfshihen në juridiksionin e DHSK-së.⁴⁸⁹ Kjo do të garantonte trajtim të barabartë⁴⁹⁰ midis viktimave dhe personave të dyshuar ose të akuzuar brenda sistemit ligjor të Kosovës, duke pasur parasysh se në legjislacionin e Kosovës tashmë parashihet mbështetje financiare për mbrojtjen ligjore të personave të dyshuar dhe të akuzuar në proceset e DHSK-së, pa u kërkuar personave të dyshuar ose të akuzuar prova për mungesën e mjeteve financiare, dhe madje parashihet kompensim në rast të shpalljes së tyre të pafajshëm, ndërkohë që nuk parashihet asgjë konkrete për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së.⁴⁹¹

276. Çka është më e rëndësishme, ky mekanizëm i ri zhdëmtues për këto viktima duhet të jetë i pavarur, asnjans dhe i çliruar nga aspektet politike. Gjithashtu, ai duhet të përfshijë një proces për paraqitjen e kërkesave që t'u përgjigjet vështirësive me të

Zhdëmtimet përcaktohet se, në rastet e shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare, e drejta e viktimave për mjete juridike përfshin, sipas të drejtës ndërkombëtare, qasje të barabartë dhe efektive në drejtësi dhe zhdëmtim të mjaftueshëm, efektiv dhe pa vonesë për dëmin e pësuar. Më konkretisht, sipas këtyre parimeve, shtetet duhet të përpiqen të krijojnë programe shtetërore për zhdëmtim dhe ndihmë tjetër për viktimat në rast se palët përgjegjëse për dëmin e pësuar nuk janë në gjendje ose nuk duan t'i përmbushin detyrimet e veta. Së fundi, në to përcaktohet se shtetet duhet të ofrojnë mekanizma efektive për zbatimin e aktvendimeve për zhdëmtim sipas ligjeve të tyre shtetërore. [UN Basic Principles on Reparations](#) (Parimet Themelore të OKB-së mbi Zhdëmtimet), para. 11(a)-(b), 16, 17).

⁴⁸⁹ Po kështu, në deklaratat e saj hyrëse dhe përmbyllëse, Mbrojtësja e Viktimave i bëri thirrje Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare që të krijojnë një mekanizëm i cili do të garantojë që viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së të realizojnë të drejtën e tyre për zhdëmtim (*Shih* [T. 15 September 2021](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2021), publik, f. 371, reshti 2 deri në f. 372, rreshti 15; [T. 15 September 2022](#) (Transkripti i 15 shtatorit 2022), publik, f. 4853, rreshti 11 deri në f. 4855, rreshti 19).

⁴⁹⁰ Në nenin 24 të Kushtetutës përcaktohet se: "Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim".

⁴⁹¹ *Shih* para. 272 më lart.

cilat përballet DHSK-ja dhe, në veçanti, masa për mbrojtjen e viktimave që bëjnë kërkesë në kuadër të këtij mekanizmi, mes të cilave edhe masat e urdhëruara në lidhje me viktimat pjesëmarrëse në proceset e DHSK-së.

277. Krahas kësaj, duhet të konsiderohet mundësia e financimit të mekanizmit zhdëmtues nga buxheti i Kosovës, duke qenë se edhe mbrojtja e personave të dyshuar dhe të akuzuar në proceset e DHSK-së financohet nga ky buxhet.⁴⁹² Përdorimi në mënyrë të barabartë i buxhetit të Kosovës do të ndihmonte zbatimin e mandatit të DHSK-së në pajtim me nenin 1(2) të Ligjit, mbështetur nga Kosova, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetet e tjera kontribuese (Kanadaja, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës), në kuadër të themelimit të DHSK-së dhe mbështetjes financiare të punës së saj.⁴⁹³

278. Konkretisht, mund të shqyrtohet mundësia që në këtë mekanizëm zhdëmtues të kenë qasje edhe viktimat të tjera të cilat provojnë në masë të mjaftueshme se kanë pësuar dëm brenda parametrave dhe kuadrit të çështjes gjyqësore të përcaktuar në Aktgjykim.⁴⁹⁴ Megjithatë kjo nuk ka ndikim mbi përgjegjësinë e personit të shpallur fajtor, përcaktuar në një urdhër për zhdëmtim të lëshuar nga Trupi Gjyqësor në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

⁴⁹² *Shih* nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-054 ([Law No. 04/L-054](#)).

⁴⁹³ *Shih* nenin 162 të Kushtetutës ([Constitution](#)) dhe Shkëmbimin e Letrave midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë të 14 prillit 2014 ([Law No. 04/L-274 on Ratification of the International Agreement between the Republic of Kosovo and the European Union on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo](#)) (Ligji nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë), 23 prill 2014).

⁴⁹⁴ Në lidhje me këtë, Trupi Gjyqësor rikujton se provat e paraqitura gjatë gjyqimit kanë vërtetuar se gjatë prillit 1999 në kompleksin e ndalimit në Zllash u mbajtën të ndaluar një numër i madh personash (*Shih* Aktgjykimin, para. 485-494).

279. Së fundi, Trupi Gjykses rikujton se, sipas nenit 22(2) të Ligjit, në rast se një viktimë nuk paraqet kërkesë për të marrë pjesë në proces në Dhomat e Specializuara, ose nuk është pranuar si pjesëmarrës apo nuk është përcaktuar të jetë viktimë sipas Ligjit, kjo nuk kufizon të drejtat e tij ose të saj të përcaktuara në ligje të tjera ose përmes mekanizmave të tjerë zhdëmtues në Kosovë.

3. Nga fondi i ri për viktimat që do të krijohet me nismën e DHSK-së

280. Trupi Gjykses dëshiron të theksojë se, nëse viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së nuk mund të realizojnë të drejtën e tyre për zhdëmtim,⁴⁹⁵ kjo e drejtë e mishëruar në nenin 22(3) të Ligjit bëhet e pakuptimtë.

281. Rrjedhimisht, meqenëse pasuria që zotëron aktualisht z. Mustafa dhe shumat maksimale të cilat mund të akordohen nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit sipas legjislacionit aktual, janë gjithsesi të pamjaftueshme për të mbuluar kompensimin e plotë të akorduar nga Trupi Gjykses, veçanërisht në lidhje me viktimat e drejtpërdrejta, Trupi Gjykses është i mendimit së zgjidhja përfundimtare duhet të bëhet nga Kosova, siç sugjerohet në Pjesën VII.B.2(b) të këtij Urdhri për Zhdëmtim. Sidoqoftë, Trupi Gjykses rekomandon gjithashtu që me nismën e DHSK-së të krijohet një fond për viktimat e krimeve që përfshihen në juridiksionin e DHSK-së, në rast se Kosova nuk i përmbush brenda një kohe të arsyeshme detyrimet që ka ndaj viktimave përmes krijimit të një mekanizmi zhdëmtues.

282. Trupi Gjykses është i mendimit se ky fond për viktimat që do të krijohet me nismën e DHSK-së, duhet të administrohet nga Administratorja e DHSK-së në

⁴⁹⁵ Në lidhje me të drejtën për mjet juridik efektiv, *shih* para. 274 më lart.

përputhje me rregullat që do të miratohen.⁴⁹⁶ Ai duhet të mbështetet financiarisht në radhë të parë nga Kosova,⁴⁹⁷ duke pasur parasysh detyrimet që ajo ka ndaj viktimave të përshkruara më lart,⁴⁹⁸ si edhe nga shtete dhe donatorë të tjerë që dëshirojnë të mbështesin viktimat.

VIII. VENDIM

283. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **LËSHON** këtë Urdhër për Zhdëmtim kundër z. Mustafa;
- b) **KONSTATON** se V08/05, V09/05, V10/05, V05/05, V06/05, V12/05, V11/05 dhe V13/05 kanë vërtetuar, në bazë të standardit të vërtetimit të tërësisë së gjasave, se janë viktima të krimeve për të cilat z. Mustafa është shpallur fajtor;
- c) **VENDOS** mbi këtë bazë zhdëmtimin e V08/05-ës, V09/05-ës, V10/05-ës, V05/05-ës, V06/05-ës, V12/05-ës, V11/05-ës dhe V13/05-ës;
- d) **AKORDON** zhdëmtim individual në formë kompensimi;

⁴⁹⁶ Trupi Gjykues thekson se në bazë të nenit 34(1) të Ligjit, Administratorja është përgjegjëse për administrimin dhe shërbimin e Dhomave të Specializuara, si dhe për të gjitha funksionet e nevojshme përkatëse. Gjithashtu, në bazë të nenit 44(6) të Ligjit, Trupi Gjykues mund të urdhërojë personin e shpallur fajtor që të dëmshpërblejë ose kompensojë viktimat, dhe, sipas nenit 53(4) dhe (5), të gjitha pronat, ose të ardhurat nga shitja e pasurisë së patundshme ose nga shitja e pronave të tjera, transferohen në kujdestarinë dhe kontrollin e DHSK-së. Rrjedhimisht, në Ligj është përcaktuar tashmë se Administratorja e DHSK-së mund të marrë dhe të administrojë të holla në dobi të viktimave.

⁴⁹⁷ *Shih* para. 277 më lart.

⁴⁹⁸ *Shih* para. 274 më lart.

- e) **PËRCAKTON** shumën e gjithsejtë të zhdëmtimit që z. Mustafa ka përgjegjësi të paguajë në vlerën 207.000 euro;
- f) **URDHËRON** z. Mustafa, që brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti gjyqësor përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, t'i paguajë si kompensim për dëmin e shkaktuar:
- 30.000 euro V08/05-ës;
 - 80.000 euro V09/05-ës;
 - 60.000 euro V10/05-ës;
 - nga 10.000 euro V05/05-ës, V06/05-ës dhe V12/05-ës;
 - 5.000 euro V11/05-ës; dhe
 - 2.000 euro V13/05-ës;
- g) **KONSTATON** se zotit Mustafa i mungojnë pjesërisht mjetet financiare për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim;
- h) **LËSHON** Vendimin për Dorëzimin e të Dhënave dhe Dokumenteve në Kuadër të Zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim dhe urdhra përkatës, bashkëlidhur Urdhrit për Zhdëmtim;
- i) **URDHËRON** Administratoren të marrë masat e nevojshme për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim, siç përcaktohet në paragrafët 253, 256, 266 dhe 268-269 më sipër;
- j) **FTON** Kryetaren e DHSK-së të caktojë një autoritet gjyqësor që do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim;

- k) **FTON** Kosovën të krijojë një mekanizëm të ri zhdëmtues për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së, për të garantuar që viktimat në proceset e DHSK-së të trajtohen në mënyrë të barabartë si të dyshuarit ose të akuzuarit;
- l) **URDHËRON** Administratoren që t'ia përcjellë Qeverisë së Kosovës versionin e redaktuar publik të Urdhrit për Zhdëmtim; dhe
- m) **REKOMANDON** krijimin, me nismën e DHSK-së, të një fondi për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 6 prill 2023

Në Hagë, Holandë.